

VENDIM
Nr. 541, datë 9.7.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KUSHTET, KRITERET DHE
PROCEDURAT E VERIFIKIMIT TË SHKARKIMEVE TË GAZEVE ME EFEKT
SERRË TË OPERATORIT TË INSTALIMIT, TË OPERATORIT TË AVIONIT E TË
SUBJEKTIT TË RREGULLUAR DHE KUSHTET, KRITERET E PROCEDURAT E
AKREDITIMIT TË VERIFIKUESVE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 6, shkronjat “c”, “ç” dhe “dh”, 11, pika 6, shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, e 12/1, pika 4, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Mbi kushtet, kriteret dhe procedurat e verifikimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të operatorit të instalimit, të operatorit të avionit e të subjektit të rregulluar dhe kushtet, kriteret e procedurat e akreditimit të verifikuesve”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE

**MBI KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E VERIFIKIMIT TË
SHKARKIMEVE TË GAZEVE ME EFEKT SERRË TË OPERATORIT TË INSTALIMIT,
TË OPERATORIT TË AVIONIT E TË SUBJEKTIT TË RREGULLUAR DHE KUSHTET,
KRITERET E PROCEDURAT E AKREDITIMIT TË VERIFIKUESVE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

a) kushtet, kriteret dhe procedurat për verifikimin e raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES) nga verifikuesi i akredituar;

b) kushtet, kriteret dhe procedurat për hartimin e raportit të verifikimit nga verifikuesi i akredituar;

c) kushtet, kriteret dhe procedurat e akreditimit dhe mbikëqyrjes të verifikuesit të akredituar;

ç) rregullat për njohjen e ndërsjellë të verifikuesve dhe për vlerësimin e ndërsjellë të organizmit kombëtar të akreditimit, në përputhje me legjislacionin shqiptar për akreditimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me rregulloren zbatuese të Komisionit të (BE) 2018/2067, e datës 19 dhjetor 2018 për verifikimin e të dhënave dhe për akreditimin e verifikuesve në zbatim të direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Numri CELEX 32018R2067 *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 334, datë 31.12.2018, f. 94–134.*

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për verifikimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të raportuara nga operatori i instalimit, operatori i avionit dhe subjekti i rregulluar gjatë kryerjes së aktiviteteve të përcaktuara në shtojcën II, pjesët A, B dhe D, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

2. Kjo rregullore zbatohet, gjithashtu, për verifikimin e efekteve në aviacion, të palidhura me shkarkimin e CO₂ nga operatori i avionit për aktivitetet e kryera prej tij, të përcaktuara në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

Neni 3

Përkufizime

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Akreditim”**, në kuptim të kësaj rregulloreje, është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit që një verifikues përmbush kriteret e përcaktuara nga standardet e harmonizuara, sipas kuptimit në ligjin në fuqi për akreditimin, si dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore për të kryer verifikimin e raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit, ose të subjektit të rregulluar, në përputhje me këtë rregullore.

2. **“Dokumentacion i brendshëm verifikimi”** është i gjithë dokumentacioni i brendshëm që ka përpiluar një verifikues për të regjistruar të gjitha provat shkresore dhe për të arsyetuar të gjitha veprimtaritë që ka kryer për verifikimin e raportit të operatorit të instalimit apo operatorit të avionit, ose të raportit të një subjekti të rregulluar.

3. **“Ekspert teknik”** është një person që ofron njohuri dhe ekspertizë të detajuar për një çështje specifike, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të verifikimit për qëllime të kreut III të kësaj rregulloreje, si dhe për kryerjen e veprimtarive të akreditimit për qëllimet e kreut V të kësaj rregulloreje.

4. **“Fusha e akreditimit”** janë aktivitetet e përcaktuara në shtojcën I të kësaj rregulloreje për të cilat kërkohet ose jepet akreditimi.

5. **“Kompetencë”** është kapaciteti për të vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë për kryerjen e një veprimtarie.

6. **“Kryevlerësues”** është vlerësuesi të cilit i është dhënë përgjegjësia e përgjithshme për vlerësimin e një verifikuesi, sipas kësaj rregulloreje.

7. **“Kryeauditues MRVA”** është një auditues i sistemit MRVA, sipas përkufizimit të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, i cili është përgjegjës për të drejtuar dhe për të mbikëqyrur ekipin e verifikimit, si dhe për të kryer verifikimin e për të raportuar verifikimin e raportit të një operatori instalimi apo operatori avioni ose të raportit të një subjekti të rregulluar.

8. **“Auditues MRVA”** është një anëtar individual i një ekipi verifikimi, i ndryshëm nga kryeaudituesi i MRVA-së, i cili është përgjegjës për kryerjen e verifikimit të raportit të një operatori instalimi apo operatori avioni ose të raportit të një subjekti të rregulluar.

9. **“Mospërputhshmëri”** ka kuptimin e njërit prej rasteve të mëposhtme:

a) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose subjektit të rregulluar, çdo veprim ose mosveprim i operatorit të instalimit ose subjektit të rregulluar që është në kundërshtim me autorizimin për shkarkimin e gazeve me efekt serrë dhe me kërkesat e përcaktuara në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

b) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionit ose të raportit për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit, çdo veprim ose mosveprim i operatorit të avionit që është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) Për qëllime të akreditimit, sipas kreut V të kësaj rregulloreje, çdo veprim ose mosveprim i verifikuesit që është në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje.

10. **“Mjedisi i kontrollit”** është mjedisi brenda të cilit funksionon sistemi i kontrollit të

brendshëm dhe tërësia e veprimeve të ndërmarra nga niveli drejtues i një operatori instalimi, operatori avioni apo subjekti të rregulluar për të garantuar njohjen e këtij sistemi të brendshëm kontrolli.

11. **“Në terren”** ka kuptimin e mëposhtëm:

a) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve ose të raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit: vendndodhjet ku është vendosur dhe administrohet procesi i monitorimit, duke përfshirë vendndodhjet ku mbliidhen, kontrollohen dhe ruhen të dhënat dhe informacionet përkatëse;

b) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar: vendndodhjet ku është vendosur dhe administrohet procesi i monitorimit, duke përfshirë vendndodhjet ku përcaktohen, kontrollohen dhe ruhen nga subjekti i rregulluar të dhënat dhe informacionet përkatëse për sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum nga subjekti i rregulluar gjatë kryerjes së aktiviteteve të renditura në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

12. **“Niveli i sigurisë”** është shkalla e sigurisë që jep verifikuesi në lidhje me raportin e verifikimit të hartuar prej tij, bazuar në objektivin për të ulur rrezikun e verifikimit në përputhje me kushtet dhe rrethanat e detyrës së verifikimit të marrë përsipër prej tij.

13 **“Pasaktësi”** është një mungesë deklarimi, shtrembërim ose gabim në të dhënat e raportuara nga operatori i instalimit, operatori i avionit apo subjekti i rregulluar, pa marrë në konsideratë prapjet e pasigurisë së lejuar sipas nenit 12, paragrafi 3, shkronja “a” të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

14. **“Pasaktësi domethënëse”** është një pasaktësi që, sipas gjykimit të verifikuesit, veçmas ose bashkë me pasaktësi të tjera, tejkalon prapjen e rëndësisë, ose mund të ndikojë në mënyrën se si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vlerëson raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit apo raportin e subjektit të rregulluar.

15. **“Procedurat analitike”** janë analizat e luhatjeve dhe tendencave të të dhënave, përfshirë analizën e lidhjeve jokoherente me informacionet e tjera të vlefshme ose që devijojnë nga vlerat e parashikuara.

16. **“Pragu i rëndësisë”** është pragu ose kufiri sasior, tejkalimi i të cilit nënkupton se pasaktësitë, veçmas ose bashkë me pasaktësi të tjera, konsiderohen pasaktësi domethënëse nga verifikuesi.

17. **“Raporti i subjektit të rregulluar”** është raporti i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të vitit paraardhës, që dorëzohet nga subjekti i rregulluar në përputhje me nenin 125 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

18. **“Raport i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit”** është raporti vjetor i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të vitit paraardhës që dorëzohet nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, në përputhje me nenin 8, pikat 2 dhe 4, dhe nenin 11, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, si dhe raporti për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂,

që dorëzohet nga operatori i avionit, në përputhje me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

19. **“Raporti për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”** është raporti i posaçëm që duhet dorëzuar nga operatori i avionit, në përputhje me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe që duhet dorëzuar si shtojcë e raportit vjetor të shkarkimeve të operatorit të avionit, në përputhje me pikën të nenit 75, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

20. **“Rrezik moszbulimi”** është rreziku që verifikuesi të mos zbulojë një pasaktësi domethënëse.

21. **“Rrezik i brendshëm”** është probabiliteti që një parametër në raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit të rezultojë në pasaktësi, të cilat, kur konsiderohen veçmas ose bashkë me pasaktësi të tjera, mund të jenë domethënëse, pa marrë parasysh efektin e veprimtarive të kontrollit të lidhura me to.

22. **“Rreziku i kontrollit”** është probabiliteti që një parametër në raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar të rezultojë në pasaktësi, të cilat, kur konsiderohen veçmas ose bashkë me pasaktësitë e tjera, mund të jenë domethënëse dhe të cilat nuk do të parandalohen ose zbulohen dhe korrigjohen në kohë nga sistemi i kontrollit.

23. **“Rreziku i verifikimit”** është rreziku, që rrjedh nga rreziku i brendshëm, rreziku i kontrollit dhe rreziku i zbulimit, që verifikuesi të japë një opinion verifikimi të papërshtatshëm në rastet kur raporti i operatorit të instalimit apo operatorit të avionit ose raporti i subjektit të rregulluar përmban pasaktësi domethënëse.

24. **“Sistem kontrolli”** është vlerësimi i rrezikut nga operatori i instalimit, operatori i avionit ose subjekti i rregulluar, si dhe tërësia e veprimtarive të kontrollit, duke përfshirë administrimin e vazhdueshëm të tyre, që një operator instalimi, operator avioni ose subjekt i rregulluar ka krijuar, dokumentuar, zbatuar dhe mbajtur sipas neneve 66, 115 dhe 116 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

25. **“Siguri e arsyeshme”** është një nivel i lartë, por jo absolut sigurie, që shfaqet nëpërmjet pohimit në opinionin e verifikimit se raporti i operatorit të instalimit apo operatorit të avionit ose raporti i subjektit të rregulluar, që i nënshtrohet verifikimit, nuk përmban pasaktësi domethënëse.

26. **“Veprimtari kontrolli”** janë veprimet e kryera ose masat e zbatuara nga operatori i instalimit, operatori i avionit ose subjekti i rregulluar për të zbutur rreziqet e brendshme.

27. **“Vlerësues”** është një person i caktuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për të kryer, në mënyrë individuale ose si pjesë e një ekipi vlerësimi, vlerësimin e një verifikuesi, sipas kësaj rregulloreje.

28. **“Verifikues”** është një person juridik që kryen veprimtari verifikimi, sipas kësaj

rregulloreje, dhe që është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit sipas ligjit në fuqi për akreditimin.

29. **“Verifikim”** është tërësia e veprimtarive të kryera nga verifikuesi për të hartuar raportin e verifikimit, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 4

Prezumimi i përputhshmërisë

Kur një verifikues provon përputhshmërinë e tij me kriteret e specifikuar në standardet e harmonizuara kombëtare ose standardet e harmonizuara të organizmave evropianë të standardizimit që janë: Komiteti Evropian i Standardizimit (CEN); Komiteti Evropian i Standardizimit Elektroteknik (CENELEC) dhe Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) apo me pjesë të këtyre të fundit, referencat e të cilave janë botuar në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, atëherë, me përjashtim të nenit 7, pikat 1 dhe 4, nenit 22, nenit 27, pika 1, neneve 28, 31 dhe 32, si dhe neneve 48, pikat 1 e 4, neneve 68 e 69, të kësaj rregulloreje, verifikuesi prezumohet se është në përputhje me kërkesat e parashtruara në kërret II, III dhe IV të kësaj rregulloreje, për sa kohë që këto kërkesa mbulohen nga standardet e harmonizuara të zbatueshme, të përmendura më sipër.

Neni 5

Kuadri i përgjithshëm për akreditimin

Nëse kjo rregullore nuk përcakton dispozita specifike në lidhje me përbërjen e organizmit kombëtar të akreditimit apo me veprimtaritë dhe kriteret e lidhura me akreditimin, atëherë zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi për akreditimin.

KREU II

VERIFIKIMI I RAPORTEVE TË OPERATORIT TË INSTALIMIT OSE OPERATORIT TË AVIONIT

Neni 6

Besueshmëria e verifikimit

1. Raporti i verifikuar i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të operatorit të instalimit, raporti i verifikuar i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES të operatorit të avionit dhe raporti i verifikuar i efekteve në aviacion të palidhura me CO₂, janë të besueshme për përdoruesit. Raportet e verifikuara pasqyrojnë në mënyrë besnike atë që pretendojnë të përfaqësojnë ose që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të përfaqësojnë.

2. Procesi i verifikimit të raportit të një operatori instalimi ose operatori të avionit është një mjet efektiv dhe i besueshëm që mbështet sigurimin e cilësisë dhe procedurat e kontrollit të cilësisë, si dhe ofron informacion që mund të shfrytëzohet nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për të përmirësuar performancën e tij lidhur me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve dhe të efekteve në aviacion të palidhura me CO₂.

Neni 7

Detyrimet e përgjithshme të verifikuesit

1. Verifikuesi realizon verifikimin dhe veprimtaritë e parashikuara në këtë kre me qëllim hartimin e një raporti verifikimi që del në përfundimin, me një nivel sigurie të arsyeshme, se raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk përmban pasaktësi domethënëse.

2. Verifikuesi planifikon dhe realizon verifikimin, duke mbajtur një qëndrim skepticizmi profesional duke pranuar se mund të ekzistojnë rrethana që shkaktojnë përmbajtjen e pasaktësive domethënëse në raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit.

3. Verifikuesi duhet ta realizojë verifikimin në interes të publikut dhe të jetë i pavarur nga

operatori i instalimit ose operatori i avionit dhe nga AKM-ja.

4. Gjatë verifikimit, verifikuesi vlerëson nëse:

a) raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit është i plotë dhe përmbush kërkesat e parashikuara në shtojcën X, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”,

b) informacioni që përmban raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit i parashikuar në shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në atë shtojcë;

c) operatori ose operatori i avionëve ka vepruar në përputhje me kërkesat e autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë dhe planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, kur bëhet fjalë për verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, dhe me kërkesat e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja, kur bëhet fjalë për verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve ose të raportit për efektet në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂ të operatorit të avionit;

ç) të dhënat në raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit nuk përmbajnë pasaktësi domethënëse;

d) mund të ofrohen informacione mbështetëse të veprimtarive të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit në lidhje me aktivitetet e fluksit të të dhënave, sistemin e kontrollit dhe procedurat e lidhura, me qëllim përmirësimin e rezultateve të monitorimit dhe raportimit nga operatorët.

5. Në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 4, të këtij neni, verifikuesi mbledh prova të qarta dhe objektive nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për të mbështetur të dhënat e raportuara në lidhje me shkarkimet e agreguara dhe efektet në aviacion të palidhura me CO₂, duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e paraqitur në raportin e operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit.

6. Nëse verifikuesi zbulon se një operator instalimi ose operator avioni nuk po respekton parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në lidhje me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve GES, kjo parregullsi duhet të përfshihet në raportin e verifikimit edhe në rast se plani i monitorimit është miratuar nga AKM-ja.

7. Nëse plani i monitorimit nuk është miratuar nga AKM-ja sipas nenit 12, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ose nuk është i plotë apo nëse gjatë periudhës së raportimit të përcaktuar në këtë VKM janë bërë ndryshime të rëndësishme, të përcaktuara në nenin 15, pikat 3 ose 4 të vendimit të sipërpërmendur të cilat nuk janë miratuar përkatësisht nga AKM-ja, atëherë verifikuesi këshillon operatorin e instalimit ose operatorin avionit që të marrë miratimin e nevojshëm nga AKM-ja.

8. Pas miratimit nga AKM-ja, verifikuesi vazhdon, përsërit ose përshtat veprimtaritë e tij të verifikimit sipas nevojës. Në rast se miratimi nga AKM-ja nuk është marrë para nxjerrjes së raportit të verifikimit, verifikuesi e raporton këtë fakt në raportin e verifikimit.

Neni 8

Detyrimet para lidhjes së kontratës

1. Përpara se të pranojë një detyrë verifikimi, verifikuesi merr informacione të mjaftueshme rreth operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe vlerëson nëse mund ta kryejë detyrën e verifikimit. Për këtë qëllim verifikuesi duhet që të paktën:

a) të vlerësojë rreziqet e përfshira në kryerjen e verifikimit të raportit të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit, në përputhje me këtë rregullore;

b) të shqyrtojë informacionin e dhënë nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për të përcaktuar objektin dhe shtrirjen e verifikimit;

c) të vlerësojë nëse kjo detyrë është pjesë e fushës së tij të akreditimit;

ç) të vlerësojë nëse ka kompetencën, personelin dhe burimet e nevojshme për të përzgjedhur një grup verifikimi të aftë për të trajtuar kompleksitetin e instalimit ose të veprimtarive dhe flotës së operatorit të avionit, si dhe nëse është i aftë të përfundojë me sukses veprimtaritë e verifikimit brenda afatit kohor të kërkuar;

d) të vlerësojë nëse është në gjendje të garantojë se grupi i mundshëm i verifikimit, që është në dispozicion të tij, zotëron të gjitha kompetencat dhe personat e nevojshëm për të kryer veprimtaritë e verifikimit për operatorin e instalimit ose operatorin e avionit në fjalë;

dh) të përcaktojë, për çdo detyrë verifikimi të kërkuar, kohën e nevojshme të kryerjes së detyrës për të kryer siç duhet verifikimin.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet t'i sigurojë verifikuesit të gjithë informacionin përkatës që i mundëson verifikuesit të kryejë veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Përcaktimi i kohëzgjatjes së nevojshme të kryerjes së detyrës

1. Kur përcakton kohëzgjatjen e nevojshme për kryerjen e detyrës për një detyrë verifikimi të përmendur në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 8, verifikuesi merr parasysh të paktën:

a) kompleksitetin e instalimit ose të veprimtarive e të flotës së operatorit të avionit;

b) nivelin e informacionit dhe kompleksitetin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) pragun e kërkuar të rëndësisë për verifikimin;

ç) kompleksitetin dhe tërësinë e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe sistemin e kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit;

d) vendndodhjen e informacionit dhe të të dhënave mbi shkarkimet e gazeve me efekt serrë dhe mbi efektet në aviacion, të palidhura me CO₂.

2. Verifikuesi sigurohet që kontrata e verifikimit të parashikojë mundësinë e zgjatjes së kohës së nevojshme për kryerjen e detyrës, krahas kohëzgjatjes së rënë dakord në kontratë, kur një kohë e tillë shtesë është e nevojshme për analizën strategjike, analizën e rrezikut ose veprimtari të tjera verifikimi. Situatat në të cilat mund të nevojitet kohë shtesë përfshijnë të paktën rastet e mëposhtme:

a) Rastet kur, gjatë verifikimit, aktivitetet e fluksit të të dhënave, veprimtaritë e kontrollit apo logjistika e operatorit të instalimit ose e operatorit të avionit duken më komplekse sesa ishte parashikuar fillimisht;

b) Rastet kur, gjatë verifikimit, verifikuesi identifikon pasaktësi, mospërputhshmëri, të dhëna të pamjaftueshme ose gabime në grupet e të dhënave.

3. Verifikuesi e dokumenton kohëzgjatjen e përcaktuar të punës në dokumentacion e brendshëm të verifikimit.

Informacion nga operatori i instalimit ose operatori i avionit

1. Para kryerjes së analizës strategjike dhe gjatë fazave të tjera të procesit të verifikimit, operatori i instalimit ose operatori i avionit i siguron verifikuesit të gjitha elementet në vijim:

a) Kopjen e autorizimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, në rast se nevojitet për të verifikuar raportin e të dhënave të shkarkimeve të një operatori të instalimit;

b) Versionin e fundit të planit të monitorimit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, si dhe të gjitha versionet e tjera përkatëse të planit të monitorimit, të miratuara nga AKM-ja, duke përfshirë provën e miratimit;

c) Një përshkrim të aktivitetëve të fluksit të të dhënave të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit;

ç) Vlerësimin e rrezikut të kryer nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, të parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 66, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe një përshkrim të sistemit të kontrollit në tërësinë e tij;

d) Procedurat e përmendura në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë procedurat për aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe veprimtaritë e kontrollit;

dh) Raportin vjetor të të dhënave të shkarkimeve GES të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe raportin për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit;

e) Kur është e zbatueshme, planin e marrjes së mostrave të operatorit të instalimit, sipas parashikimeve të nenit 33 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, të miratuar nga AKM-ja;

ë) Nëse plani i monitorimit është ndryshuar gjatë periudhës së raportimit, një listë të plotë të ndryshimeve përkatëse, në përputhje me pikën 4, të nenit 16, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

f) Kur është e zbatueshme raportet e përmendura në pikat 2 e 7, të nenit 76, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

g) Raportin e verifikimit të vitit të mëparshëm, nëse verifikuesi nuk e ka kryer vetë verifikimin për atë operator të instalimit ose operator avioni gjatë vitit të mëparshëm;

gj) Të gjithë korrespondencën përkatëse me AKM-në, në veçanti informacionin lidhur me njoftimin e ndryshimeve në planin e monitorimit si dhe lidhur me korrigjimet në të dhënat e raportuara, sipas rastit;

h) Informacionet për bazat e të dhënave dhe burimet e të dhënave të përdorura për qëllime monitorimi dhe raportimi, duke përfshirë ato nga Eurokontrolli ose organizata të tjera përkatëse, sistemi i gjurmimit të efekteve në aviacion, të palidhura me CO₂ (“NEATS”), ose mjetet e

teknologjisë së informacionit (TIK) të palëve të treta, sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””.

i) Informacionet dhe të dhënat bazë që janë përdorur nga operatori i avionit për të përpiluar informacionin e fluturimit, informacionin mbi karakteristikat e avionit dhe lloje të tjera të informacioneve të monitoruara, në mënyrë që të llogaritet CO₂, ekuivalent për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ për çdo fluturim, në rastet kur NEATS është vënë në dispozicion më vonë nga Komisioni Evropian, në përputhje me parashikimet e pikës 6, të nenit 64, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””;

j) Në rastet kur verifikimi ka të bëjë me raportin e shkarkimeve të një instalimi që kryen depozitimin gjeologjik të gazeve me efekt serrë në një vend depozitimi të lejuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, planin e monitorimit dhe raportet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë veprimtari, të cilat mbulojnë të paktën periudhën e raportimit të raportit të shkarkimeve që do të verifikohet;

k) Sipas rastit, miratimin e AKM-së për moskryerjen e vizitave në terren për instalimet, sipas pikës 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje;

l) Provat e operatorit që tregojnë përputhshmërinë me pragjet e pasigurisë të shkallëve metodologjike, të parashikuara në planin e monitorimit;

ll) Çdo informacion tjetër të nevojshëm dhe të vlefshëm për planifikimin dhe kryerjen e verifikimit.

2. Para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, operatori i instalimit ose operatori i avionit duhet t’i japë verifikuesit raportin e të dhënave të shkarkimeve në variantin përfundimtar të autorizuar dhe të miratuar në nivel të brendshëm nga operatori i instalimit ose operatori i avionit.

Neni 11

Analiza strategjike

1. Në fillim të verifikimit, verifikuesi vlerëson natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e mundshëm të detyrave të verifikimit, duke kryer një analizë strategjike të të gjitha veprimtarive të lidhura me instalimin ose operatorin e avionit.

2. Për të kuptuar veprimtaritë e kryera nga instalimi ose operatori ajror, verifikuesi mbledh dhe shqyrton informacionin e nevojshëm për të vlerësuar se grupi i verifikimit është mjaftueshëm kompetent për të kryer verifikimin, për të përcaktuar nëse kohëzgjatja e caktuar në kontratë është ajo e duhura, si dhe për të garantuar se është në gjendje të kryejë analizën e nevojshme të rrezikut. Informacioni përfshin, të paktën:

- a) informacionin e përmendur në pikën 1, të nenit 10, të kësaj rregulloreje;
- b) pragun e rëndësisë të përcaktuar;
- c) informacionin e marrë nga verifikimet e viteve të mëparshme, nëse verifikuesi po kryen verifikimin për të njëjtin operator instalimi ose operator avioni.

3. Kur shqyrton informacionin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, verifikuesi vlerëson të paktën sa më poshtë:

- a) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, kategorinë e instalimit të përmendur në nenin 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme

të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe veprimtaritë e kryera në atë instalim;

b) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve ose të raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit, madhësinë dhe natyrën e operatorit të avionit, shpërndarjen e informacionit në vendndodhje të ndryshme, si dhe numrin e llojin e fluturimeve;

c) Planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, si dhe specifikat e metodologjisë së monitorimit, të përcaktuara në atë plan monitorimi;

ç) Natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e burimeve të shkarkimeve dhe rrymave të shkarkimeve, si dhe pajisjet e proceset e përdorura për të përfutur të dhënat për shkarkimet, përfshirë të dhënat për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, duke përfshirë pajisjet matëse të përshtatshme në planin e monitorimit, origjinën dhe zbatimin e faktorëve të llogaritjes, si dhe burime të tjera parësore të të dhënave;

d) Aktivitetet e fluksit të të dhënave, sistemin e kontrollit dhe mjedisin e kontrollit;

dh) Për qëllime të verifikimit të raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, masën në të cilën operatorët e avionëve përdorin të dhënat në sistemin NEATS ose mjetet e teknologjisë së informacionit (TIK) të palëve të treta, të miratuara nga Komisioni Evropian, në përputhje me pikën 8, të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

4. Kur kryen analizën strategjike, verifikuesi kontrollon sa më poshtë:

a) Nëse plani i monitorimit që i është dorëzuar nga operatori i instalimit ose operatori i avionit është versioni më i fundit dhe është miratuar nga AKM-ja;

b) Nëse janë bërë ndryshime në planin e monitorimit gjatë periudhës së raportimit;

c) Sipas rastit, nëse ndryshimet e përmendura në shkronjën “b”, të kësaj pike, i janë njoftuar AKM-së sipas nenit 15 ose nenit 23, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, apo nëse janë miratuar nga AKM-ja në përputhje me nenin 15 të atij vendimi.

Neni 12

Analiza e riskut

1. Për të projektuar, planifikuar dhe zbatuar një verifikim efektiv, verifikuesi identifikon dhe analizon elementet e mëposhtme:

a) Rreziqet e brendshme;

b) Veprimtaritë e kontrollit;

c) Kur janë zbatuar veprimtaritë e kontrollit të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, rreziqet e kontrollit lidhur me efektivitetin e këtyre veprimtarive të kontrollit.

2. Kur identifikon dhe analizon elementet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, verifikuesi merr në konsideratë të paktën:

a) gjetjet nga analiza strategjike e përmendur në pikën 1, të nenit 11, të kësaj rregulloreje;

b) informacionin e përmendur në pikën 1, të nenit 10, dhe shkronjën “c” të pikës 2, të nenit 11, të kësaj rregulloreje;

c) prapën e rëndësisë të përmendur në shkronjën “b” të pikës 2, të nenit 11, të kësaj

rregulloreje.

3. Nëse verifikuesi përcakton se operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk ka identifikuar rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit përkatëse në vlerësimin e tij të rrezikut, atëherë verifikuesi informon operatorin e instalimit ose operatorin e avionit rreth këtij fakti.

4. Nëse e gjykon të përshtatshme, bazuar në informacionin e marrë gjatë verifikimit, verifikuesi rishikon analizën e riskut dhe ndryshon ose përsërit veprimtaritë e verifikimit që duhen kryer.

Neni 13

Plani i verifikimit

1. Verifikuesi harton një plan verifikimi në përputhje me informacionin e marrë dhe rreziqet e identikuara gjatë analizës strategjike dhe analizës së riskut, duke përfshirë të paktën:

a) një program verifikimi që përshkruan natyrën dhe shtrirjen e veprimtarive të verifikimit, si dhe kohën e mënyrën në të cilën duhet të kryhen këto veprimtari;

b) një plan testimi që përcakton objektin dhe metodat e testimit të veprimtarive të kontrollit, si dhe procedurat për kryerjen e këtyre veprimtarive të kontrollit;

c) një plan për kampionimin e të dhënave që përcakton shtirjen dhe metodat e kampionimit të të dhënave në pikat e mbledhjes së të dhënave të cilat bazohen shkarkimet e konsoliduara (agreguara) të raportuara në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit si dhe efektet e konsoliduara (agreguara) në aviacion të palidhura me shkarkimet e CO₂ të konsoliduara (agreguara), të raportuara në raportin për efektet në aviacion të palidhura me CO₂.

2. Verifikuesi e harton planin e testimit, të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, në një mënyrë të tillë që e lejon atë të përcaktojë masën në të cilën veprimtaritë përkatëse të kontrollit mund të përdoren për të vlerësuar pajtueshmërinë me kërkesat e përmendura në shkronjat “c” e “ç”, të pikës 4, të nenit 7, ose në pikën të nenit 7, të kësaj rregulloreje. Kur përcakton madhësinë e kampionimit dhe veprimtaritë e kampionimit për testimin e veprimtarive të kontrollit, verifikuesi merr në konsideratë elementet e mëposhtme:

a) rreziqet e brendshme;

b) mjedisin e kontrollit;

c) veprimtaritë përkatëse të kontrollit;

ç) kërkesën për dorëzimin e një opinioni verifikimi që ofron një nivel besueshmërie të arsyeshme.

3. Kur përcakton madhësinë e kampionimit dhe veprimtaritë e kampionimit për kampionimin e të dhënave të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, verifikuesi merr në konsideratë elementet e mëposhtme:

a) rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit;

b) rezultatet e procedurave analitike;

c) kërkesën e dorëzimit të një opinioni verifikimi me një nivel besueshmërie të arsyeshme;

ç) pragu e rëndësisë;

d) rëndësinë e kontributit që sjell një element specifik i të dhënave në kuadrin e të gjithë grupit të të dhënave.

4. Verifikuesi harton dhe zbaton planin e verifikimit në mënyrë të tillë që rreziku i verifikimit të ulët në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk ka pasaktësi domethënëse.

5. Verifikuesi përditëson analizën e riskut dhe planin e verifikimit, si dhe përshtat veprimtaritë e verifikimit gjatë verifikimit, kur konstaton rreziqe të tjera që duhen zvogëluar ose kur ka rrezik më të ulët nga sa ishte parashikuar fillimisht.

Neni 14

Veprimtaritë e verifikimit

1. Verifikuesi zbaton planin e verifikimit dhe, në bazë të analizës së riskut, kontrollon zbatimin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

2. Për këtë qëllim, verifikuesi kryen të paktën testime thelbësore që përbëhen nga procedura analitike, verifikimi i të dhënave dhe kontrolli i metodologjisë së monitorimit, si dhe kontrollon:

a) aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe sistemet e përdorura në fluksin e të dhënave, duke përfshirë sistemet e teknologjisë së informacionit;

b) nëse veprimtaritë e kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit janë dokumentuar, zbatuar dhe ruajtur siç duhet, si dhe nëse janë efektive për të zbutur rreziqet e brendshme;

c) nëse procedurat e renditura në planin e monitorimit janë efektive për të zbutur rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit dhe nëse procedurat janë zbatuar, janë dokumentuar dhe ruajtur siç duhet.

3. Për qëllime të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, verifikuesi gjurmon fluksin e të dhënave, duke ndjekur rendin dhe ndërveprimin e aktiviteteve të fluksit të të dhënave që nga burimi fillestar i të dhënave deri në hartimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit.

Neni 15

Procedurat analitike

1. Verifikuesi përdor procedura analitike për të vlerësuar besueshmërinë dhe plotësinë e të dhënave kur rreziku i brendshëm, rreziku i kontrollit dhe përshtatshmëria e veprimtarive të kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit tregojnë nevojën për përdorimin e procedurave të tilla analitike.

2. Gjatë kryerjes së procedurave analitike, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi vlerëson të dhënat e raportuara për të identifikuar zonat e mundshme të rrezikut dhe, rrjedhimisht, për të validuar dhe përshtatur veprimtaritë e planifikuara të verifikimit. Verifikuesi duhet që të paktën:

a) të vlerësojë besueshmërinë e luhatjeve dhe të tendencave të shfaqura me kalimin e kohës, ose midis zërave të ngjashëm;

b) të identifikojë vlerat që janë qartësisht jonormale, të dhënat e paparashikuara dhe mangësitë në të dhëna.

3. Gjatë zbatimit të procedurave analitike, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi zbaton procedurat e mëposhtme:

a) Procedurat paraprake analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara), përpara se të kryejë veprimtaritë e përmendura në nenin 14 të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të kuptohet natyra, kompleksiteti dhe rëndësia e të dhënave të raportuara;

b) Procedurat thelbësore analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara) dhe pikat e mbledhjes së të dhënave ku bazohen këto të dhëna, me qëllim identifikimin e gabimeve të mundshme strukturore dhe të vlerave që janë qartësisht jonormale;

c) Procedurat përfundimtare analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara) për të garantuar zgjidhjen në mënyrë të saktë të të gjitha gabimeve të identifikuara gjatë procesit të verifikimit.

4. Kur verifikuesi identifikon vlera që janë qartësisht jonormale, luhatje, tendenca, mangësi në të dhëna ose të dhëna që nuk janë në përputhje me informacionet e tjera të mbledhura apo që ndryshojnë ndjeshëm nga shumat ose proporcionet numerike (*ratio*) të parashikuara, verifikuesi merr shpjegime nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, të mbështetura nga provat përkatëse shtesë. Në bazë të shpjegimeve dhe provave shtesë të dorëzuara, verifikuesi vlerëson ndikimin e tyre në planin e verifikimit dhe në veprimtaritë e verifikimit që duhen kryer.

Neni 16

Verifikimi i të dhënave

1. Verifikuesi verifikon të dhënat në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit, duke zbatuar testimin e detajuar të të dhënave, përfshirë gjurmimin e të dhënave deri në burimin fillestar të tyre, duke kryqëzuar të dhënat me burimet e jashtme të të dhënave, duke rakorduar të dhënat, duke kontrolluar kufijtë lidhur me të dhënat e përshtatshme dhe duke kryer rillogaritje.

2. Në kuadër të verifikimit të të dhënave të përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe duke marrë parasysh planin e miratuar të monitorimit, duke përfshirë procedurat e përshkruara në atë plan, verifikuesi kontrollon:

a) kufijtë e instalimit, për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit;

b) për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit, përshkrimin në mënyrë të plotë të rrymave të shkarkimeve dhe burimeve të shkarkimeve të renditura në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja;

c) për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve ose të raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ të një operatori të avionëve, plotësinë e të dhënave të fluturimeve të mbuluara nga një aktivitet aviacioni, i renditur në shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, për të cilën operatori i avionit është përgjegjës, si dhe plotësinë e të dhënave për shkarkimet ose efektet në aviacion të palidhura me CO₂;

ç) për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të një operatori avioni, përputhshmërinë midis të dhënave të raportuara dhe dokumentacionit të masës e të balancës;

d) për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionit, përputhshmërinë midis të dhënave të konsoliduara (agreguara) mbi konsumin e lëndës djegëse dhe të dhënave mbi lëndën djegëse të blerë ose të furnizuar për avionin që realizon veprimtarinë e aviacionit;

dh) përputhshmërinë midis të dhënave të konsoliduara (agreguara), të raportuara në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe të dhënave të marra nga burimi fillestar;

e) kur operatori zbaton një metodologji të bazuar në matje, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të nenit 21, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, vlerat e matura, duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të kryera nga operatori, në përputhje me nenin 47 të po atij vendimi;

ë) për qëllimin e vlerësimit të informacionit në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, në përputhje me shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, përputhshmërinë ndërmjet atij informacioni dhe provave të paraqitura nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, duke përfshirë faturat e lëndës djegëse, fletëdorëzimet dhe kontratat me furnizuesit e lëndëve djegëse;

f) besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave.

3. Kur operatori i avionit paraqet të dhëna mbi trajektoret e fluturimit në raportin për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, verifikuesi kontrollon nëse informacioni mbi trajektoren e fluturimit është i plotë, në kuadër të verifikimit të të dhënave, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, dhe duke marrë në konsideratë planin e miratuar të monitorimit.

4. Kur operatori i avionit paraqet të dhëna mbi karakteristikat e avionit në raportin për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, verifikuesi, në kuadër të verifikimit të të dhënave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe duke marrë në konsideratë planin e miratuar të monitorimit, kontrollon, të paktën:

a) përputhshmërinë ndërmjet llojeve të avionëve të renditur në planin e miratuar të monitorimit dhe të dhënave të raportuara mbi llojet e avionëve dhe ato të regjistruara në regjistrat e brendshëm;

b) përputhshmërinë ndërmjet burimeve të të dhënave të operatorit të avionit dhe procedurave për motorët e avionëve me numrin unik të identifikimit të motorit të avionit që renditet në bazën e të dhënave për shkarkimet e motorëve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), apo me një burim të barasvlershëm të të dhënave që përdoret për të identifikuar motorët e avionit;

c) përputhshmërinë ndërmjet masës së avionit, masës së ngritjes së avionit në fluturim apo faktorit të ngarkesës në regjistrat e brendshëm të operatorit të avionit dhe në dokumentacionin për masën e balancën dhe të dhënave të raportuara nga operatori i avionit.

5. Verifikuesi përdor gjithashtu bazën e të dhënave të simulimit të performancës së avionëve për të vlerësuar masën e avionit, masën e ngritjes së avionit në fluturim apo faktorin e ngarkesës, për ta krahasuar me të dhënat e paraqitura nga operatori i avionit.

6. Kur operatori i avionit paraqet të dhëna mbi performancën e avionit në raportin për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, verifikuesi, në kuadër të verifikimit të të dhënave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe duke marrë në konsideratë planin e miratuar të monitorimit, kontrollon aspektet në vijim:

a) Përputhshmërinë ndërmjet të dhënave të trajektores së fluturimit dhe të dhënave të performancës së avionit përgjatë trajektores së tij, duke përfshirë kontrollin e kryqëzuar të etiketave kohore, të përdorura për të dhënat e trajektores së fluturimit dhe të dhënat e performancës së avionit;

b) përputhshmërinë ndërmjet konsumit total (të agreguar) të lëndëve djegëse, të dhënave për lëndët djegëse të blera ose të furnizuara në çfarëdo mënyrë tjetër për avionin që kryen aktivitetin e aviacionit në fjalë dhe matjeve të serbatorit të lëndës djegëse;

c) përputhshmërinë ndërmjet të dhënave të raportuara nga operatori i avionit dhe specifikimeve të prodhuesit, regjistrave të brendshëm dhe procedurave të lidhura me lëndën djegëse të furnizuar, shpejtësinë e konsumit të lëndës djegëse dhe eficiencën e motorit të avionit, duke përfshirë forcën shtytëse të motorit të avionit;

d) çdo informacion që verifikuesi e konsideron të nevojshëm për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ nuk përmban pasaktësi domethënëse.

7. Kur kontrollon përputhshmërinë e të dhënave të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni, verifikuesi përdor gjithashtu bazën e të dhënave të simulimit të performancës së avionëve për të vlerësuar matjet e fluksit të konsumit të lëndës djegëse dhe eficiencën e motorit, me qëllimin për ta krahasuar me të dhënat e paraqitura nga operatori i avionit.

8. Kur operatori i avionit përdor metodën e tij për të përcaktuar karakteristikat e lëndës djegëse ose të dhënat meteorologjike në raportin për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ apo përdor modulën e tij për konsumin e lëndës djegëse ose modulën e tij të vlerësimit të shkarkimeve, të përmendur në pikat 4 e 5, të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi, në kuadër të verifikimit të të dhënave të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kontrollon vlefshmërinë e informacionit hyrës të përdorur për të përcaktuar të dhënat dhe zbaton metodat e miratuara nga AKM-ja në planin e monitorimit.

9. Për qëllime të kontrollit të plotësisë së fluturimeve të përmendur në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij neni, verifikuesi përdor të dhënat e trafikut ajror të operatorit të avionit, duke

përfshirë të dhënat e mbledhura nga Eurocontroli ose organizata të tjera përkatëse të cilat mund të përpunojnë informacionin rreth trafikut ajror, të ngjashëm me atë që është i disponueshëm për Eurocontrolin.

10. Për të kontrolluar plotësinë e informacionit mbi trajektorët e fluturimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni, verifikuesi përdor modelin e fluturimit taktik Aktual të Eurocontrolit, modelin e fluturimit taktik të rregulluar të Eurocontrolit ose modelin e fluturimit taktik të planifikuar të Eurocontrolit apo një model të barasvlershëm për sa i përket saktësisë së të dhënave, sipas rastit, si dhe të dhënat e mbikëqyrjes automatike të ndërruar – me transmetim (ADS-B).

Neni 17

Verifikimi i zbatimit të duhur të metodologjisë së monitorimit

1. Verifikuesi kontrollon zbatimin e duhur të metodologjisë së monitorimit, të miratuar nga AKM-ja në planin e monitorimit, përfshirë detajet specifike të kësaj metodologjie monitorimi.

2. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit, verifikuesi kontrollon zbatimin e duhur të planit të marrjes së mostrave, të parashikuar në nenin 33, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe të miratuar nga AKM-ja.

3. Kur CO₂ e transferuar zbritet në përputhje me nenin 50, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe CO₂ i transferuar matet si nga instalimi transferues ashtu edhe nga ai pritës, ose nga infrastruktura e transportit të CO₂, verifikuesi kontrollon nëse diferencat mes vlerave të matura në të dyja instalimet ose në infrastrukturën e transportit të CO₂ mund të shpjegohen nga pasiguria e sistemeve të matjes, si dhe nëse është përdorur mesatarja e saktë aritmetike e vlerave të matura në raportet e të dhënave të shkarkimeve të të dyja instalimeve apo të infrastrukturës së transportit të CO₂. Kur diferencat mes vlerave të matura në të dyja instalimet ose në infrastrukturën e transportit të CO₂ nuk mund të shpjegohen nga pasiguria e sistemeve të matjes, verifikuesi kontrollon nëse janë bërë rregullime për të përafruar vlerat e matura, nëse rregullimet e kryera janë konservatore dhe nëse AKM-ja ka dhënë miratimin për këto rregullime.

4. Kur CO₂ në tranzit është raportuar në përputhje me pikën 8, të nenit 50, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi kontrollon nëse CO₂ në tranzit është transferuar në një instalim tjetër ose në infrastrukturën e transportit të CO₂, brenda datës 31 janar të vitit pasues.

5. Kur N₂O i transferuar nuk llogaritet si pjesë e shkarkimeve, në përputhje me parashikimet e nenit 52, të të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe N₂O i transferuar matet si nga instalimi

transferues ashtu edhe ai pritës, verifikuesi kontrollon nëse diferenat mes vlerave të matura në të dyja instalimet mund të shpjegohen nga pasiguria e sistemeve të matjes dhe nëse është përdorur mesatarja e saktë aritmetike e vlerave të matura në raportet për të dhënat e shkarkimeve të të dyja instalimeve. Kur diferenat mes vlerave të matura në të dyja instalimet nuk mund të shpjegohen nga pasiguria e sistemeve të matjes, verifikuesi kontrollon nëse janë bërë rregullime për të përafruar vlerat e matura, nëse këto rregullime janë kryer në mënyrë konservatore dhe nëse AKM-ja ka dhënë miratimin për këto rregullime.

6. Kur CO₂ i transferuar në përputhje me parashikimet e pikave 6 e 7, të nenit 50, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, rezultojnë nga materiale apo lëndë djegëse që përmbajnë karbon me normë zero, verifikuesi kontrollon të gjitha aspektet në vijim:

a) Nëse CO₂ i transferuar buron nga materiale apo lëndë djegëse që përmbajnë karbon me normë zero;

b) Nëse instalimi transferues ose infrastruktura e transportit të CO₂ ka zbritur në mënyrë të saktë CO₂ e transferuar, në proporcion me fraksionin e karbonit që nuk buron nga karboni me normë zero;

c) Nëse operatori i instalimit ose i infrastrukturës së transportit të CO₂ ka monitoruar shkarkimet e shkaktuara nga rrjedhjet, shkarkimet e pakapshme ose shkarkimet e përqendruara, nëse ka pasur të tilla;

ç) Çdo informacion që verifikuesi e konsideron të nevojshëm për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti për shkarkimet nuk përmban pasaktësi domethënëse.

7. Kur CO₂ ka krijuar lidhje kimike të përhershme në një produkt në përputhje me nenin 51, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi kontrollon të gjitha aspektet në vijim:

a) Nëse produkti është i renditur në pikën 1, të nenit 51, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) Nëse operatori ka zbritur në mënyrë të saktë CO₂ që buron nga karboni me normë jo-zero që ka krijuar lidhje kimike të përhershme në përputhje me nenin 51, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

c) Sasinë e CO₂ që ka krijuar lidhje kimike të përhershme në një produkt të renditur në pikën 1, të nenit 51, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

c) Në rastet kur CO₂ buron nga materiale apo lëndë djegëse që përmbajnë një fraksion të karbonit me normë zero:

- i. nëse CO₂ buron nga këto materiale apo lëndë djegëse;
- ii. nëse operatori e ka zbritur në mënyrë të saktë CO₂ që ka krijuar lidhje kimike të përhershme, në proporcion me fraksionin e karbonit që nuk rezulton nga karboni me normë zero;

d) Çdo informacion që verifikuesi e konsideron të nevojshëm për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti për të dhënat e shkarkimeve nuk përmban pasaktësi domethënëse.

8. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, verifikuesi, në kuadër të kontrollit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kontrollon provat vijuese:

a) Provat e operatorit të instalimit që dëshmojnë se lëndët djegëse të biomasës me normë zero janë në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

b) Provat e operatorit të instalimit që dëshmojnë se lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike ("RFNBO") apo lëndët djegëse të ricikluara me bazë karboni ("RCF"), me normë zero, janë në përputhje me kriteret e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe lëndët djegëse me bazë karboni të ricikluara të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

c) Provat e operatorit të instalimit që dëshmojnë të gjitha aspektet në vijim:

i. Pajtueshmërinë e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, me normë zero, me pragun e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;

ii. Nëse përmbajtja e karbonit e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët ka qenë subjekt i kryerjes paraprakisht të pagesës së detyrimeve të karbonit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ose, sipas rastit, i kryerjes paraprakisht të detyrimeve të raportimit të shkarkimeve kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi.

9. Kur operatori i instalimit ka përcaktuar fraksionin e biomasës dhe fraksionin identik të biomasës me normë zero të biogazit duke përdorur regjistrat e shitjeve, në përputhje me pikat 6 e t, të nenit 39, të vendimit nr. 4 86, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", verifikuesi kontrollon të gjitha aspektet në vijim:

a) se askush tjetër nuk pretendon se po përdor sasinë e biogazit të blerë nga operatori i instalimit;

b) nëse operatori i instalimit dhe prodhuesi i fraksionit të biogazit janë të lidhur në të njëjtin rrjet;

c) çdo informacion që verifikuesi e konsideron të nevojshëm për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i të dhënave të shkarkimeve nuk përmban pasaktësi domethënëse.

10. Kur fraksioni i RFNBO-së ose RCF-së, si dhe fraksioni identik me normë zero i RFNBO-së ose RCF-së së gazit natyror, përcaktohen në përputhje me nenin 40, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", verifikuesi kontrollon të gjitha aspektet në vijim:

a) se askush tjetër nuk pretendon se po përdor sasinë e RFNBO-së ose RCF-së të blerë nga operatori i instalimit;

b) nëse operatori i instalimit dhe prodhuesi i RFNBO-së ose RCF-së janë të lidhur në të njëjtin rrjet;

c) çdo informacion që verifikuesi e konsideron të nevojshëm për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti për shkarkimet nuk përmban pasaktësi domethënëse.

11. Kur lënda djegëse alternative për aviacionin ose lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin furnizohet në avion në ngarkesa fizikisht të identifikueshme dhe mund t'i caktohet fizikisht një fluturimi të raportuar, verifikuesi kontrollon nëse sasia e lëndës djegëse alternative të aviacionit ose e lëndës djegëse të kualifikuar të aviacionit i është caktuar në mënyrë të saktë fluturimit menjëherë pas furnizimit me lëndë djegëse. Nëse janë realizuar disa fluturime të njëpasnjëshme pa furnizime të ndërmjetme, verifikuesi kontrollon nëse sasia e lëndës djegëse alternative për aviacionin ose e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin u është caktuar këtyre fluturimeve në mënyrë proporcionale me shkarkimet që burojnë nga këto fluturime, të llogaritura duke përdorur koeficientin paraprak të shkarkimit.

12. Kur lënda djegëse alternative për aviacionin nuk mund të përcaktohet se i përket fizikisht një aerodromi për një fluturim specifik, verifikuesi kontrollon nëse lënda djegëse alternative për aviacionin u është caktuar fluturimeve për të cilat duhen raportuar shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 55/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në proporcion me shkarkimet nga këto fluturime që nisen nga aerodromi në fjalë, të llogaritura duke përdorur faktorin paraprak të shkarkimit.

13. Kur nuk është e mundur të identifikohet fizikisht se cilit fluturim specifik të një aerodromi i takon lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin, verifikuesi kontrollon nëse lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin i është caktuar fluturimeve të kryera prej tij, për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, në mënyrë proporcionale me shkarkimet që krijohen nga ato fluturime, të llogaritura duke përdorur faktorin paraprak të shkarkimit.

14. Për qëllim të zbatimit të pikave 12 dhe 13, të këtij neni, verifikuesi kontrollon nëse lënda djegëse alternative për aviacionin ose lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin është dorëzuar te sistemi i furnizimit me lëndë djegëse të aerodromit të nisjes gjatë periudhës së raportimit, 3 muaj përpara fillimit ose 3 muaj pas përfundimit të periudhës së raportimit, siç specifikohet në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja.

15. Për qëllim të zbatimit të pikave 11, 12, 13 dhe 14, të këtij neni, verifikuesi kontrollon nëse:

a) operatori i avionit ka përcaktuar në mënyrë të saktë në raportin e të dhënave të shkarkimeve se cilit çift aerodromesh (nisje-mbërritje) i takon lënda djegëse alternative për aviacionin ose lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin;

b) sasia totale e lëndës djegëse alternative për aviacionin nuk e tejkalon sasinë totale të lëndës djegëse të raportuar nga operatori i avionit në fjalë për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me parashikimet e nenit 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, dhe të cilat nisen nga aerodromi ku furnizohet lënda djegëse alternative për aviacionin;

c) sasia totale e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin nuk e tejkalon sasinë totale të lëndës djegëse të raportuar nga operatori i avionit për fluturimet, për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, të cilat nisen nga aerodromi ku furnizohet lënda djegëse e kualifikuar për aviacionin;

ç) sasia totale e lëndës djegëse alternative për aviacionin, për të cilën duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, nuk e tejkalon sasinë totale të lëndës djegëse alternative për aviacionin, të blerë nga e cila zbritet sasia totale e lëndës djegëse alternative për aviacionin të shitur palëve të treta;

d) sasia totale e lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin për fluturimet për të cilat duhet të raportohen shkarkimet në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", të ndryshuar, nuk e tejkalon sasinë totale të lëndës djegëse të kualifikuar për

aviacionin të blerë, nga e cila zbritet sasia totale e lëndëve djegëse të kualifikuara për aviacionin, të shitur palëve të treta;

dh) raporti ndërmjet lëndës djegëse alternative për aviacionin ose lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin dhe lëndëve djegëse fosile që janë caktuar se u përkasin fluturimeve të bashkuara (agreguara) për çift aerodromesh (nisje-mbërritje) nuk e tejkalon kufirin maksimal të përzierjes së përcaktuar për atë lëndë djegëse alternative për aviacionin ose për atë lëndë djegëse të kualifikuar për aviacionin, të certifikuar sipas një standardi të njohur ndërkombëtar;

e) fraksioni i konsoliduar (agreguar) me normë zero në lëndën djegëse alternative të aviacionit nuk e tejkalon sasinë e lëndës djegëse alternative të aviacionit për të cilën paraqiten provat në vijim:

i. Kur fraksioni me normë zero i referohet pjesës së biomasës të një lënde djegëse alternative të aviacionit të përzier, prova për përmbushjen e kriterëve të qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse me bazë biomasën, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;

ii. Kur fraksioni me normë zero i referohet pjesës së RFNBO-së ose RCF-së së një lënde djegëse alternative të përzier, prova për përmbushjen e kriterëve të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe lëndët djegëse me bazë karboni të ricikluara, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

iii. Kur fraksioni me normë zero i referohet fraksionit të lëndës djegëse sintetike me karbon të ulët të një lënde djegëse alternative të përzier, prova për përmbushjen e kriterëve të reduktimit të shkarkimit të gazeve me efekt serrë, të përmendura në legjislacionin në fuqi dhe prova se përmbajtja e karbonit të lëndës djegëse sintetike me nivele të ulëta karboni ka qenë subjekt i një raportimi të mëparshëm të shkarkimeve, në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar;

ë) nuk ka pretendime se të njëjtat sasi të lëndës djegëse alternative të aviacionit ose të lëndës djegëse të kualifikuar për aviacionin janë llogaritur dhe përdorur në një raport të mëparshëm ose se janë përdorur nga një tjetër operator i avionëve, ose në një tjetër sistem i përcaktimit të çmimit të karbonit.

16. Për qëllimet e vlerësimit të informacionit në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, në përputhje me shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi vlerëson dhe konfirmon:

a) nëse është zbatuar saktë metodologjia mbi mënyrën e ndarjes së sasive të lëndëve djegëse ndërmjet furnizuesve të ndryshëm, e parashikuar në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, kur lëndët djegëse nuk përdoren gjatë të njëjtit viti raportimi;

b) nëse sasitë e lëndës djegëse, të përdorura nga operatori i instalimit ose operatori i avionit që janë furnizuar nga një furnizues, nuk tejkalojnë sasitë e blera nga ai furnizues, duke marrë parasysh sasitë e ruajtura në magazinë, të llogaritura në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja.

Neni 18

Verifikimi i metodave të zbatuara për mangësitë e të dhënave

1. Kur metodat e përcaktuara në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, janë përdorur për të plotësuar të dhënat që mungojnë në përputhje me nenin 73 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin

e CO₂”, verifikuesi kontrollon nëse metodat e përdorura janë të përshtatshme për situatën specifike dhe nëse janë zbatuar siç duhet. Nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit ka marrë miratimin nga AKM-ja për të përdorur metoda të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 73 të vendimit të sipërpërmendur, verifikuesi kontrollon nëse qasja e miratuar është zbatuar siç duhet dhe dokumentuar në mënyrë të përshtatshme. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk ka mundur ta marrë në kohë miratimin nga AKM-ja, verifikuesi kontrollon nëse qasja e përdorur nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për të plotësuar të dhënat që mungojnë garanton që shkarkimet të mos nënvlerësohen dhe që kjo qasje të mos rezultojë në pasaktësi domethënëse.

2. Kur mungojnë të dhënat e nevojshme për llogaritjen e efekteve në aviacion të palidhura me CO₂, verifikuesi kontrollon nëse të dhënat që mungojnë mund të llogariten duke përdorur NEATS ose një mjet TIK të një pale të tretë, të miratuar nga Komisioni Evropian. Kur të dhënat që mungojnë nuk mund të llogariten në përputhje me sa më sipër, verifikuesi kontrollon nëse të dhënat zëvendësuese, të miratuara nga AKM-ja, janë aplikuar në mënyrë të saktë. Kur operatori i avionit nuk është në gjendje të marrë në kohë miratimin nga AKM-ja për të dhënat zëvendësuese, verifikuesi kontrollon nëse qasja e përdorur nga operatori i avionit për të plotësuar të dhënat që mungojnë garanton që efektet në aviacion, të palidhura me CO₂, të mos nënvlerësohen dhe që kjo qasje nuk rezulton në pasaktësi domethënëse.

3. Verifikuesi kontrollon efektivitetin e veprimtarive të kontrollit të zbatuara nga operatori i instalimit ose operatori i avionit për të parandaluar mungesën e të dhënave të përmendura në nenin 73, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”.

Neni 19

Vlerësimi i pasigurisë

1. Kur vendimi nr. 486, datë 26.6.2026, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, kërkon që operatori i instalimit të provojë përputhshmërinë me pragjet e pasigurisë për të dhënat e veprimtarisë dhe faktorët e llogaritjes, verifikuesi konfirmon vlefshmërinë e informacionit të përdorur për të llogaritur nivelet e pasigurisë, siç përcaktohet në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja.

2. Kur operatori i instalimit zbaton një metodologji monitorimi që nuk bazohet në shkallën metodologjike, siç përcaktohet në nenin 22, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, verifikuesi kontrollon sa më poshtë:

a) Nëse operatori i instalimit ka kryer një vlerësim dhe një matje sasiore të pasigurisë që dëshmon se është arritur pragu i përgjithshëm i pasigurisë, i përcaktuar për nivelin vjetor të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të nenit 22, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit,

nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”;

b) vlefshmërinë e informacionit të përdorur për vlerësimin dhe matjen sasiore të pasigurisë;

c) nëse qasja e përgjithshme e përdorur për vlerësimin dhe matjen sasiore të pasigurisë është në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 22, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”;

ç) nëse janë paraqitur prova që tregojnë se janë përmbushur kushtet për metodologjinë e monitorimit të përmendur në shkronjën “a”, të nenit 22, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”.

Neni 20

Marrja e mostrave

1. Kur kontrollon përputhshmërinë e veprimtarive dhe procedurave të kontrollit të përmendura në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 14, të kësaj rregulloreje, ose kur kryen kontrollet e përmendura në nenet 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje, verifikuesi mund të përdorë metoda për marrjen e mostrave që janë specifike për një instalim ose operator avioni, me kusht që marrja e mostrave të jetë e justifikuar, në bazë të analizës së rrezikut.

2. Kur gjatë marrjes së mostrave verifikuesi identifikon një mospërputhje ose një pasaktësi, ai i kërkon operatorit të instalimit ose operatorit të avionit të shpjegojë shkaqet kryesore të mospërputhjes ose pasaktësisë për të vlerësuar ndikimin e mospërputhjes ose pasaktësisë në të dhënat e raportuara. Bazuar në rezultatin e këtij vlerësimi, verifikuesi përcakton nëse nevojiten veprimtari shtesë verifikimi, nëse madhësia e marrjes së mostrave duhet të rritet, si dhe pjesën e të dhënave që duhet të korrigjohet nga operatori i instalimit ose operatori i avionit.

3. Verifikuesi dokumenton në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit rezultatin e kontrolleve të përmendura në nenet 14 deri në 17 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë detajet e marrjes së mostrave shtesë.

Neni 21

Vizitat në terren

1. Në momente të caktuara gjatë procesit të verifikimit, verifikuesi kryen një vizitë në terren për të vlerësuar funksionimin e pajisjeve matëse dhe sistemeve të monitorimit, për të kryer intervista, për të kryer veprimtaritë e kërkuara nga ky kre, si dhe për të mbledhur informacione e prova të mjaftueshme që i mundësojnë atij të dalë në përfundimin nëse raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk ka pasaktësi domethënëse.

2. Operatori i instalimit ose operatori i avionit i japin verifikuesit akses në ambientet e tij.

3. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, verifikuesi kryen gjithashtu një vizitë në terren për të vlerësuar kufijtë e instalimit, si dhe nëse rrymat e shkarkimeve dhe burimet e shkarkimeve janë paraqitur në mënyrë të plotë nga operatori i instalimit.

4. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimit të operatorit, verifikuesi, në bazë të analizës së rrezikut, vendos nëse nevojiten vizita në vendndodhje të tjera, duke përfshirë rastet kur pjesë përkatëse të aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe veprimtarive të kontrollit kryhen në vendndodhje të tjera, siç janë selia e shoqërisë dhe zyra të tjera jashtë vendndodhjes së instalimit.

Trajtimi i pasaktësive, mospërputhjeve dhe papajtueshmërive

1. Nëse gjatë verifikimit, verifikuesi identifikon pasaktësi, mospërputhje ose papajtueshmëri me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ai informon në kohë operatorin e instalimit ose operatorin e avionit rreth këtij fakti dhe kërkon korrigjimet përkatëse. Operatori i instalimit ose operatori i avionit korrigjon çdo pasaktësi ose mospërputhje të njoftuar. Në këtë rast operatori i instalimit ose operatori i avionit njofton AKM-në për mospërputhjen e konstatuar dhe korrigjon mospërputhjen pa vonesë.

2. Verifikuesi dokumenton dhe shënon si të zgjidhura në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit të gjitha pasaktësitë, mospërputhjet ose papajtueshmëritë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, të cilat janë korrigjuar nga operatori i instalimit ose operatori i avionit gjatë verifikimit.

3. Nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk korrigjon pasaktësitë ose mospërputhjet e njoftuara nga verifikuesi në përputhje me pikën 1 të këtij neni, para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, verifikuesi i kërkon operatorit të instalimit ose operatorit të avionit të shpjegojë shkaqet kryesore të mospërputhjes ose pasaktësisë për të vlerësuar ndikimin e mospërputhjeve ose pasaktësive të dhënat e raportuara.

4. Verifikuesi përcakton nëse pasaktësitë e pakorrigjuara, të konsideruara veçmas ose së bashku me pasaktësitë e tjera, kanë një ndikim domethënës të shkarkimet totale të raportuara ose tek efektet në aviacion të palidhura me CO₂. Gjatë vlerësimit të nivelit të rëndësisë së pasaktësisë, verifikuesi merr parasysh masën dhe natyrën e pasaktësive, si dhe rrethanat e veçanta në të cilat ndodhin pasaktësitë. Verifikuesi vlerëson gjithashtu nëse mospërputhjet e pakorrigjuara, të konsideruara veçmas ose bashkë me mospërputhje të tjera, ka ndikim të dhënat e raportuara dhe nëse kjo çon në pasaktësi domethënëse.

5. Nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk korrigjon mospërputhjen me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, atëherë verifikuesi vlerëson nëse mospërputhja e pakorrigjuar ka ndikim të dhënat e raportuara dhe nëse kjo çon në pasaktësi domethënëse.

6. Verifikuesi mund të konsiderojë se pasaktësitë janë domethënëse edhe nëse ato pasaktësi, veçmas ose së bashku me pasaktësitë e tjera, janë nën pragun e rëndësisë së përcaktuar në nenin 23 të kësaj rregulloreje, kur një konsideratë e tillë justifikohet nga masa dhe natyra e pasaktësive dhe nga rrethanat e veçanta gjatë të cilave ndodhin këto pasaktësi.

Pragu i rëndësisë

1. Për qëllime të verifikimit të raporteve të të dhënave të shkarkimeve, pragu i rëndësisë është 5% e shkarkimeve totale të raportuara në periudhën e raportimit për subjektet e

mëposhtme që i nënshtrohen verifikimit:

a) Instalimet e kategorisë A, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 19, dhe instalimet e kategorisë B, të përmendura shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) Operatorët e avionit me shkarkime vjetore të barabarta me ose më pak se 500 kilotonë nga CO₂ fosile.

2. Për qëllime të verifikimit të raporteve të të dhënave të shkarkimeve, pragu i rëndësisë është 2% i shkarkimeve totale të raportuara në periudhën e raportimit për subjektet e mëposhtme që i nënshtrohen verifikimit:

a) Instalimet e kategorisë C, të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”;

b) Operatorët e avionit me shkarkime vjetore më shumë se 500 kilotonë CO₂ fosile.

3. Për qëllime të verifikimit të raporteve për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, pragu i rëndësisë është 5% e totalit të shkarkimeve të konsoliduara (agreguara) të CO₂(e), të raportuara në raportin për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂.

Neni 24

Përfundimet bazuar në gjetjet e verifikimit

Në periudhën e përfundimit të verifikimit dhe duke marrë në konsideratë informacionin e përftuar gjatë verifikimit, verifikuesi:

a) kontrollon të dhënat përfundimtare të marra nga operatori i instalimit ose operatori i avionit, duke përfshirë të dhënat që janë korrigjuar në bazë të informacionit të marrë gjatë verifikimit;

b) shqyrton arsyet e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit për çdo ndryshim që ekziston ndërmjet të dhënave përfundimtare dhe të dhënave të dorëzuara më parë;

c) shqyrton rezultatin e vlerësimit për të përcaktuar nëse plani i monitorimit, i miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë procedurat e përshkruara brenda planit, është zbatuar siç duhet;

ç) vlerëson nëse rreziku i verifikimit është brenda një niveli të ulët të pranueshëm për të arritur një siguri të arsyeshme;

d) siguron që janë mbledhur prova të mjaftueshme për të dhënë një opinion verifikimi me një nivel sigurie të arsyeshme se raporti nuk ka pasaktësi domethënëse;

dh) siguron që procesi i verifikimit është dokumentuar plotësisht në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit dhe që është e mundur të jepet një gjykim përfundimtar në raportin e verifikimit.

Neni 25

Shqyrtimi i pavarur

1. Para nxjerrjes së raportit të verifikimit, verifikuesi ia dorëzon dokumentacionin e brendshëm të verifikimit dhe raportin e verifikimit një shqyrtuesi të pavarur.

2. Shqyrtuesi i pavarur nuk duhet të ketë kryer asnjë veprimtari verifikimi nga ato që do t'i nënshtrohen shqyrtimit të tij.

3. Objekti i shqyrtimit të pavarur përfshin procesin e plotë të verifikimit, të përshkruar në

këtë kre dhe të regjistruar në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit.

4. Shqyrtuesi i pavarur e kryen shqyrtimin për të garantuar që procesi i verifikimit është kryer në përputhje me këtë rregullore, që janë kryer siç duhet procedurat për veprimtaritë e verifikimit të përmendura në nenin 41 të kësaj rregulloreje, si dhe që është treguar kujdesi i duhur profesional. Shqyrtuesi i pavarur vlerëson gjithashtu nëse provat e mbledhura janë të mjaftueshme për t'i mundësuar verifikuesit të nxjerrë një raport verifikimi që jep siguri të arsyeshme.

5. Kur verifikohen rrethana që mund të sjellin si pasojë kryerjen e ndryshimeve të raportit të verifikimit pasi është kryer shqyrtimi i pavarur, shqyrtuesi i pavarur shqyrton gjithashtu këto ndryshime dhe provat mbështetëse të tyre.

6. Verifikuesi autorizon një person për të autentikuar raportin e verifikimit në bazë të përfundimeve të shqyrtuesit të pavarur dhe provave në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit.

Neni 26

Dokumentacioni i brendshëm i verifikimit

1. Verifikuesi përgatit dhe përpilon dokumentacionin e brendshëm të verifikimit, që përmban të paktën:

- a) rezultatet e veprimtarive të kryera të verifikimit;
- b) analizën strategjike, analizën e riskut dhe planin e verifikimit;
- c) për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimet të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit dhe të raportit për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit, informacion të mjaftueshëm për të mbështetur opinionin e verifikimit, duke përfshirë arsyetimet për gjykimet e bëra mbi faktin nëse pasaktësitë e identifikuara kanë ose jo një ndikim domethënës në shkarkimet e raportuara ose në efektet në aviacion, të palidhura me CO₂.

2. Dokumentacioni i brendshëm i verifikimit, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, hartohet në mënyrë të tillë që shqyrtuesi i pavarur, i parashikuar në nenin 25 të kësaj rregulloreje, dhe organizmi kombëtar i akreditimit të mund të vlerësojnë nëse verifikimi është kryer në përputhje me këtë rregullore.

3. Pas autentikimit të raportit të verifikimit sipas pikës 6, të nenit 25, të kësaj rregulloreje, verifikuesi përfshin rezultatet e shqyrtimit të pavarur në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit.

4. Verifikuesi duhet t'i sigurojë AKM-së, pas kërkesës së saj, qasje në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit dhe në informacionet e tjera përkatëse, për të lehtësuar vlerësimin e verifikimit nga ana e AKM-së. AKM-ja mund të përcaktojë një afat brenda të cilit verifikuesi duhet të sigurojë qasjen në atë dokumentacion.

Neni 27

Raporti i verifikimit

1. Në bazë të informacionit të mbledhur gjatë verifikimit, verifikuesi i dorëzon operatorit të instalimit ose operatorit të avionit një raport verifikimi për çdo raport të të dhënave të shkarkimeve, të hartuar nga operatori i instalimit ose operatori i avionit ose për çdo raport për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂, të hartuar nga operatori i avionit, që ka qenë subjekt verifikimi dhe që përmban një nga opinionet e mëposhtme:

- a) Raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit verifikohet si i kënaqshëm;
- b) Raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit përmban pasaktësi domethënëse të cilat nuk janë korrigjuar para nxjerrjes së raportit të verifikimit;
- c) Objekti i verifikimit është shumë i kufizuar, sipas parashikimeve të nenit 28 të kësaj rregulloreje dhe verifikuesi e kishte të pamundur të merrte prova të mjaftueshme për të nxjerrë një opinion verifikimi me një nivel sigurie të arsyeshme se raporti nuk ka pasaktësi domethënëse;

ç) Mospërputhjet, të konsideruara veçmas ose bashkë me mospërputhje të tjera, nuk ofrojnë qartësi të mjaftueshme dhe pengojnë verifikuesin të deklarojë me siguri të arsyeshme se raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk përmban pasaktësi domethënëse.

2. Për qëllimet e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit verifikohet se është në përputhje me kriteret vetëm nëse nuk përmban pasaktësi domethënëse.

3. Operatori i instalimit ose operatori i avionit ia dorëzon raportin e verifikimit AKM-së së bashku me raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit në fjalë.

4. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit vë në dispozicion të subjektit të rregulluar informacionin përkatës të listuar në shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatorit i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatorit i instalimit, nga operatorit i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në përputhje me pikën 2, të nenit 132, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatorit i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatorit i instalimit, nga operatorit i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, operatorit i instalimit ose operatorit i avionit gjithashtu duhet t’i vërë në dispozicion subjektit të rregulluar informacionin përkatës të përmendur në shkronjat “h”, “l”, “o” dhe “q”, të pikës 3, të këtij neni.

5. Raporti i verifikimit përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) emrin e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit që i është nënshtruar verifikimit;
b) objektivat e verifikimit;
c) shtrirjen e verifikimit;
ç) referencën e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit që është verifikuar;

d) kriteret e përdorura për të verifikuar raportin e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, duke përfshirë autorizimin për shkarkimet GES, sipas rastit, dhe versionet e planit të monitorimit, të miratuara nga AKM-ja, si dhe periudhën e vlefshmërisë për secilin version të planit;

dh) në rastet e verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, shkarkimet e konsoliduara (agreguara) për çdo veprimtari të përcaktuar në shtojcën II, pjesët A dhe B, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, si dhe shkarkimet e konsoliduara (agreguara) sipas instalimit ose operatorit të avionit;

e) në rastet e verifikimit të raportit për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit, shkarkimet e konsoliduara (agreguara) të CO_{2(e)} të efekteve në aviacion të palidhura me CO₂, për çdo operator avioni;

ë) në rastet e verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionit, konfirmimin se është realizuar një kontroll mbi plotësinë dhe saktësinë e sasisë së deklaruar të lëndëve djegëse të pastra alternative të aviacionit me normë zero dhe të sasisë së deklaruar të lëndëve djegëse të pastra të kualifikuara për aviacionin, sipas kategorive të lëndëve djegëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë një konfirmim se nuk janë konstatuar mospërputhje dhe se është përcaktuar në mënyrë të saktë se cilave fluturime u përkasin në mënyrë proporcionale lëndët djegëse, sipas rastit;

f) periudhën e raportimit, objekt verifikimi;

g) përgjegjësitë e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, të AKM-së dhe të verifikuesit;

gj) deklaratën e opinionit të verifikimit;

h) një përshkrim të pasaktësive dhe mospërputhjeve të identifikuara që nuk janë korrigjuar

para nxjerrjes së raportit të verifikimit;

i) datat në të cilat janë kryer vizitat në terren dhe nga kush, si dhe datat e vizitave virtuale dhe, kur zbatohen nenet 36 dhe 37 të kësaj rregulloreje, datën e vizitës së fundit fizike në terren;

j) informacion nëse nuk janë kryer vizita në terren dhe arsyet për moskryerjen e këtyre vizitave;

k) informacion nëse është kryer një vizitë virtuale, si dhe arsyet për kryerjen e vizitave virtuale dhe, sipas rastit, datën e miratimit të AKM-së;

l) çdo problem lidhur me mungesën e përputhshmërisë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, që është konstatuar gjatë verifikimit;

ll) nëse nuk mund të merret në kohë miratimi nga AKM-ja për të zbatuar metodën e përdorur për plotësimin e mangësisë së të dhënave sipas pikës 1, të nenit 18, të kësaj rregulloreje, një konfirmim nëse metoda e përdorur është konservative dhe nëse ajo çon ose jo në pasaktësi domethënëse;

m) një deklaratë mbi faktin nëse metoda e përdorur për të plotësuar mangësitë e të dhënave sipas pikës 4, të nenit 18, të kësaj rregulloreje, rezulton në pasaktësi domethënëse;

n) kur operatori i avionit nuk ka marrë në kohë miratim për të dhënat zëvendësuese, sipas pikës 2, të nenit 18, të kësaj rregulloreje, një deklaratë mbi faktin nëse metoda e përdorur për të plotësuar mangësitë e të dhënave rezulton në pasaktësi domethënëse;

nj) konfirmim se verifikuesi ka kryer kontrollin e përmendura në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 16, të kësaj rregulloreje dhe në pikën 16 të nenit 17 të kësaj rregulloreje, dhe se sasitë e lëndëve djegëse të përdorura nga një furnizues nuk tejkalojnë sasinë që operatori i instalimit ose operatori i avionit ka marrë nga ai furnizues, duke marrë parasysh sasitë e ruajtura në stok, të llogaritura në përputhje me metodologjinë në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, përfshirë një përshkrim të çdo gjetjeje ose vëzhgimi tjetër;

o) kur verifikuesi, që kryen verifikimin e një raporti të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionëve, ka realizuar kontrollin sipas pikës 2, të nenit 34, të kësaj rregulloreje, konfirmimin se të dhënat për fluturimet në NEATS ose në mjetin TIK të palës të tretë, siç parashikohet në pikën 7, të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, janë në përputhje me të dhënat për fluturimet të përfshira në raportin e të dhënave të shkarkimeve, duke marrë në konsideratë objektin e fluturimeve të mbuluara nga neni 11, pika 1, dhe shtojcën II, pjesa B, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, dhe fluturimet e raportuara nga operatori i avionëve, duke përfshirë, sipas rastit, një përshkrim të gjetjeve dhe konstatimeve lidhur me përputhshmërinë dhe plotësinë e fluturimeve;

p) rekomandime për përmirësime, kur janë të zbatueshme;

q) emrat e kryeaudituesit të MRVA-së, e shqyrtuesit të pavarur dhe, sipas rastit, të audituesit të MRVA-së dhe ekspertit teknik, të përfshirë në verifikimin e raportit të operatorit të instalimit dhe të operatorit të avionit;

r) datën dhe nënshkrimin nga një person i autorizuar në emër të verifikuesit, duke përfshirë emrin e tij.

6. Verifikuesi përshkruan pasaktësitë, mospërputhshmëritë dhe papajtueshmëritë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit,

nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, duke dhënë detaje të mjaftueshme në raportin e verifikimit për t’u mundësuar operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, si dhe AKM-së, që të kuptojnë sa më poshtë:

a) Shkallën dhe natyrën e pasaktësisë, mospërputhshmërisë ose papajtueshmërisë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) Arsyen pse pasaktësia ka apo nuk ka ndikim domethënës;

c) Cilit element të raportit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit i referohet pasaktësia ose cilit element të planit të monitorimit i referohet mospërputhja;

ç) me cilin nen në vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, lidhet papajtueshmëria.

7. Për qëllim të verifikimit të raporteve të shkarkimeve, nëse AKM-ja i kërkon verifikuesit të paraqesë informacion mbi procesin e verifikimit, përveç elementeve të renditura në pikën 5, të këtij neni, dhe ai informacion nuk është i nevojshëm për të kuptuar opinionin e verifikimit, operatori i instalimit ose operatori ajror, për arsye efikasiteti, mund t’ia paraqesë AKM-së informacionin shtesë veçmas nga raporti i verifikimit në një datë alternative, por jo më vonë se data 15 maj e të njëjtit vit.

Neni 28

Kufizimi i shtrirjes së verifikimit

Verifikuesi mund të dalë në përfundimin se shtrirja e verifikimit e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, është e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme kur verifikohet një nga situatat e mëposhtme:

a) Kur mungojnë të dhëna që pengojnë verifikuesin të mbledhë provat e nevojshme për të ulur rrezikun e verifikimit në nivelin e duhur për të arritur një shkallë të arsyeshëm sigurie;

b) Kur plani i monitorimit nuk është miratuar nga AKM-ja;

c) Kur plani i monitorimit nuk ka një shtrirje ose qartësi të mjaftueshme për të mundësuar arritjen e përfundimeve mbi verifikimin;

ç) Operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk ka vënë në dispozicion informacion të mjaftueshëm për t’i mundësuar verifikuesit të kryejë verifikimin.

Neni 29

Trajtimi i mospërputhjeve jodomethënëse të pazgjidhura

1. Verifikuesi vlerëson nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit ka korrigjuar mospërputhjet e identifikuar në raportin e verifikimit në lidhje me periudhën e mëparshme të monitorimit, sipas kërkesave për operatorin, të përcaktuara në pikat 7, 8 e 9, të nenit 76, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, sipas rastit. Nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk i ka korrigjuar këto mospërputhje sipas nenit 76, pikat 7, 8 dhe 9, të të njëjtit vendim, verifikuesi

shqyrton nëse mosveprimi rrit ose mund të rrisë rrezikun e pasaktësive.

2. Verifikuesi raporton në raportin e verifikimit nëse këto mospërputhje janë zgjidhur nga operatori i instalimit ose operatori i avionit.

3. Verifikuesi regjistron në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit detaje mbi kohën se kur dhe mënyrën se si operatori i instalimit ose operatori i avionit kanë zgjidhur mospërputhjet e identifikuara gjatë verifikimit.

Neni 30

Përmirësimi i procesit të monitorimit dhe raportimit

1. Kur verifikuesi ka identifikuar fusha për përmirësim në performancën e operatorit të instalimit ose operatorit të avionit në lidhje me elementet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “d” të kësaj pike, ai përfshin në raportin e verifikimit rekomandime për përmirësimin e performancës së operatorit të instalimit ose operatorit të avionit në aspektet e mëposhtme:

a) Vlerësimin e rrezikut të kryer nga operatori i instalimit ose operatori i avionit;

b) Zhvillimin, dokumentimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe veprimtarive të kontrollit, si dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit;

c) Zhvillimin, dokumentimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e procedurave për veprimtaritë e qarkullimit të të dhënave dhe veprimtaritë e kontrollit, si dhe e procedurave të tjera që një operator instalimi ose operator ajror duhet të përcaktojë në përputhje me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””;

ç) monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, duke përfshirë aspektet në lidhje me arritjen e shkallëve metodologjike më të larta, reduktimin e rreziqeve dhe rritjen e efikasitetit në monitorim dhe raportim;

d) monitorimin dhe raportimin e efekteve në aviacion të palidhura me CO₂.

2. Gjatë verifikimit, verifikuesi kontrollon nëse operatori i instalimit ose operatori i avionit ka zbatuar rekomandimet për përmirësimet e nevojshme që janë dhënë në raportin e verifikimit të vitit të mëparshëm si dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit nuk i ka zbatuar këto rekomandime ose nuk i ka zbatuar ato siç duhet, verifikuesi vlerëson ndikimin që kjo ka në lidhje me rrezikun e pasaktësive dhe mospërputhjeve.

Neni 31

Verifikimi i thjeshtuar për instalimet

1. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, verifikuesi mund të vendosë, në varësi të miratimit nga AKM-ja, të dhënë në përputhje me parashikimet e pikës 2 të këtij neni, të mos kryejë vizita në terren për instalimet. Ky vendim merret duke u bazuar në rezultatet e analizës së riskut dhe pasi të përcaktohet se të gjitha të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë nga verifikuesi dhe se plotësohen kushtet për moskryerjen e vizitave në terren. Verifikuesi informon për këtë operatorin e instalimit pa vonesa të paarsyeshme.

2. Operatori i i instalimit paraqet pranë AKM-së një kërkesë që të miratojë vendimin e verifikuesit për të mos kryer vizitën në terren. Pas marrjes së kërkesës nga operatori përkatës, AKM-ja vendos nëse do të miratojë vendimin e verifikuesit për të mos kryer vizitën në terren, duke marrë parasysh të gjitha elementet e mëposhtme:

a) Informacionin e dhënë nga verifikuesi mbi rezultatin e analizës së riskut;

b) Informacionin se të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë;

c) Provat se kërkesat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni nuk zbatohen për instalimin;

ç) Provat se plotësohen kushtet për moskryerjen e vizitave në terren.

3. Nuk kërkohet miratimi i AKM-së, i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni për moskryerjen e vizitave në terren për instalimet me nivele të ulëta shkarkimi, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 48, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””.

4. Verifikuesi kryen gjithmonë vizita në terren në situatat e mëposhtme:

a) Kur verifikuesi po verifikon për herë të parë raportin e të dhënave të shkarkimeve të një operatori instalimi;

b) Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, nëse në dy periudhat e raportimit menjëherë pararendëse të periudhës aktuale të raportimit asnjë verifikues nuk ka kryer një vizitë në terren;

c) Nëse, gjatë periudhës së raportimit, janë bërë ndryshime të konsiderueshme në planin e monitorimit, duke përfshirë ato të parashikuara në pikën 3 të nenit 15, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””. Kjo pikë nuk zbatohet në rast se gjatë periudhës së raportimit ndryshimet e bëra lidhen vetëm me vlerat standarde, siç parashikohet në shkronjën “e”, të pikës 3, të nenit 15, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””.

Neni 32

Kushtet për moskryerjen e vizitave në terren

1. Kushtet për moskryerjen e vizitave në terren të përmendura në pikën 1, të nenit 31, të kësaj rregulloreje, parashikohen në pikat e mëposhtme të këtij neni.

2. Kur verifikimi i raportit të shkarkimeve të një operatori instalimi ka të bëjë me një instalim të kategorisë A, të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 19, ose një instalim të kategorisë B, të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””, në rastet se:

a) instalimi ka vetëm një rrymë shkarkimi, siç përmendet në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂””, që është gazi natyror, ose një apo disa rryma shkarkimi minimale (*de minimis*) të cilat së bashku nuk tejkalojnë prapun për flukset minimale (*de minimis*) të përcaktuara në nenin 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit

për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'";

b) gazi natyror monitorohet përmes sistemit të matjes fiskale, që i nënshtrohet një regjimi të përshtatshëm ligjor për kontrollin e matësve fiskalë dhe plotëson nivelet e kërkuara të pasigurisë në lidhje me shkallën metodologjike të zbatueshme;

c) zbatohen vlerat standarde për faktorët e llogaritjes së gazit natyror ose ku faktorët e llogaritjes së gazit natyror përcaktohen drejtpërdrejt nga një transportues i jashtëm i gazit pa asnjë përpunim nga operatori i instalimit, duke përdorur analizues *online* që i nënshtrohen një regjimi të përshtatshëm ligjor për kontrollin e analizuesve fiskalë.

3. Kur verifikimi i raportit të shkarkimeve të një operatori instalimi ka të bëjë me një instalim të kategorisë A, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 19, ose një instalim të kategorisë B, të përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", në rast se:

a) instalimi ka vetëm një rrymë shkarkimi që përbëhet nga lëndë djegëse pa shkarkime të procesit dhe kjo lëndë djegëse është ose një lëndë djegëse e ngurtë që digjet drejtpërdrejt në instalim pa depozitë të përkohshme, ose një lëndë djegëse e lëngshme ose e gaztë që mund të depozitohet përkohësisht;

b) të dhënat e veprimtarisë të lidhura me rrymën e shkarkimit monitorohen duke përdorur një nga metodat e mëposhtme:

i. Metodën e matjes fiskale, e cila i nënshtrohet një regjimi të përshtatshëm ligjor për kontrollin e matësve fiskalë dhe plotëson nivelet e kërkuara të pasigurisë në lidhje me shkallën metodologjike të zbatueshme;

ii. Metodën e bazuar vetëm në të dhënat e faturës duke marrë parasysh ndryshimet në rezerva, sipas rastit;

c) zbatohen vetëm vlerat e standarde për faktorët e llogaritjes;

ç) AKM-ja ka lejuar instalimin të përdorë një plan të thjeshtuar monitorimi, në përputhje me nenin 13, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'".

4. Kur verifikimi i raportit të shkarkimeve të një operatori instalimi ka të bëjë me një instalim me nivele të ulëta shkarkimi, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 48, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", dhe zbatohen shkronjat "a" deri në "c" të pikës 3, të këtij neni.

5. Kur verifikimi i raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ka të bëjë me një instalim që ndodhet në njësi që operohet pa personel, në rast se:

a) të dhënat telemetrike nga njësia e instalimit pa personel dërgohen drejtpërdrejt në një vend tjetër ku të gjitha të dhënat përpunohen, menaxhohen dhe ruhen;

b) i njëjti person është përgjegjës për menaxhimin dhe regjistrimin e të dhënave të asaj njësie;

c) matësit janë inspektuar në vend nga operatori i instalimit ose nga një laborator, në

përputhje me nenin 67, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe një dokument i nënshkruar ose dëshmi fotografike e stampuar me datë, të siguruara nga operatori i instalimit, tregojnë se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në matje ose në operimin e instalimit që nga inspektimi i kryer.

6. Kur verifikimi i raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ka të bëjë me një instalim të vendosur në një vend të largët ose të paarrtshëm, në veçanti një instalim të vendosur në det të hapur, në rast se:

a) ka një nivel të lartë të centralizimit të të dhënave të mbledhura nga ajo njësi e instalimit dhe të transmetuara drejtpërdrejt në një vend tjetër ku të gjitha të dhënat përpunohen, menaxhohen dhe ruhen me cilësi të lartë;

b) matësit janë inspektuar në vend nga operatori i instalimit ose nga një laborator, në përputhje me nenin 67, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe një dokument i nënshkruar ose dëshmi fotografike e stampuar me datë, të siguruara nga operatori i instalimit, tregojnë se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në matje ose në operimin e instalimit që nga inspektimi i kryer.

7. Pika 3 e këtij neni mund të zbatohet gjithashtu në rastet kur, krahas rrymës së shkarkimit të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, instalimi përdor një ose disa rryma shkarkimi minimale (*de minimis*) të cilat së bashku nuk tejkalojnë pragu për flukset minimale (*de minimis*) të përcaktuara në nenin 19, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

Neni 33

Verifikimi i thjeshtuar i raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionëve

1. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, një verifikues mund të vendosë të mos kryejë një vizitë në terren për një operator avioni, duke përdorur mjetet e thjeshtuara të përmendura në pikën 2, të nenit 61, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, për të përcaktuar shkarkimet e CO₂, nëse verifikuesi ka arritur në përfundimin se, në bazë të analizës së tij të riskut, të gjitha të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë nga verifikuesi.

2. Kur një operator avioni përdor mjetet e thjeshtuara të përmendura në pikën 2, të nenit 61, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, për të përcaktuar konsumin e lëndës djegëse dhe kur të dhënat e raportuara

të shkarkimeve të CO₂ janë gjeneruar, duke përdorur këto mjete në mënyrë të pavarur nga çdo kontribut nga operatori i avionit, verifikuesi, në bazë të analizës së tij të riskut, mund të vendosë të mos kryejë kontrollin e përmendur në nenin 14 dhe 16, nenin 17, pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 18 të kësaj rregulloreje.

Neni 34

Verifikimi i thjeshtuar i raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit

1. Në përjashtim nga parashikimet e neneve 7 deri në 27 të kësaj rregulloreje, raporti për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të operatorit të avionit konsiderohet i verifikuar nëse është mbushur me të dhëna nga sistemi NEATS ose nga një mjet TIK i një pale të tretë, siç parashikohet në pikën 7, të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në mënyrë të pavarur nga çdo kontribut i dhënë nga operatori i avionit dhe pa ndryshime të kryera nga ky operator, dhe nëse operatori i avionit është një shkarkues i vogël sipas kuptimit të pikës 1, të nenit 61, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

2. Kur raporti për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të një operatori avioni, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 1, është mbushur me të dhëna nga sistemi NEATS ose nga një mjet TIK i një pale të tretë, siç parashikohet në pikën 7, të nenit 63, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në mënyrë të pavarur nga çdo kontribut i dhënë nga operatori i avionit dhe pa ndryshime të kryera nga ky operator, atëherë raporti për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ konsiderohet i verifikuar. Megjithatë, verifikuesi, që kryen verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionit në fjalë, kontrollon, në kuadër të këtij verifikimi, përputhshmërinë ndërmjet informacionit të fluturimit, të paraqitur në raportin e operatorit të avionit dhe informacionit të fluturimit në sistemin NEATS ose në mjetin TIK të palës së tretë, duke pasur parasysh objektin e fluturimeve të mbuluara nga neni 11 dhe shtojca II, pjesa B, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, dhe të raportuara nga operatori i avionit.

Neni 35

Planet e verifikimit të thjeshtuar

Kur verifikuesi përdor një plan verifikimi të thjeshtuar, ai dokumenton arsyetimin për përdorimin e këtij plani në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit, duke përfshirë provat se janë plotësuar kushtet për përdorimin e planeve të verifikimit të thjeshtuar.

Neni 36

Vizitat virtuale për verifikimin e raportit të operatorit ose të operatorit ajror

1. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, kur rrethanat e rënda, të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, jashtë kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, pengojnë verifikuesin të kryejë një vizitë fizike në terren dhe kur këto rrethana nuk mund të tejkalohen edhe pas të gjitha përpjekjeve të arsyeshme, verifikuesi mund të vendosë, në varësi të miratimit të AKM-së në përputhje me pikën 4 të këtij neni, të kryejë një vizitë virtuale. Verifikuesi merr masa për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk ka pasaktësi domethënëse. Vizita fizike në vendin e instalimit ose operatorit të avionit kryhet pa vonesa të paarsyeshme.

2. Vendimi për të kryer një vizitë virtuale bazohet në rezultatin e analizës së rrezikut dhe pasi të përcaktohet se plotësohen kushtet për kryerjen e një vizite virtuale. Verifikuesi informon për këtë operatorin e instalimit ose operatorin e avionit pa vonesa të paarsyeshme.

3. Operatori i instalimit ose operatorin e avionit dorëzon pranë AKM-së kërkesën për të miratuar vendimin e verifikuesit për të kryer një vizitë virtuale. Kërkesa përfshin elementet e mëposhtme:

a) provat se nuk është e mundur që të kryhet një vizitë fizike në terren për shkak të rrethanave të rënda, të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, jashtë kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit;

b) informacion mbi mënyrën se si do të kryhet vizita virtuale;

c) informacion mbi rezultatin e analizës së rrezikut nga verifikuesi;

ç) provat e masave të marra nga verifikuesi për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i operatorit të instalimit ose operatorit të avionit nuk ka pasaktësi domethënëse.

4. Pas marrjes së kërkesës nga operatorin e instalimit ose operatorin e avionit në fjalë, AKM-ja vendos nëse do të miratojë vendimin e verifikuesit për të kryer një vizitë virtuale, duke marrë parasysh të gjitha elementet e specifikuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 4 të këtij neni, kur një numër i madh instalimesh ose operatorësh avioni preken nga rrethanat e ngjashme të rënda, të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, jashtë kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit, dhe nevojitet veprim i menjëhershëm për shkak të masave shëndetësore kombëtare të vendosura nga legjislacioni shqiptar, AKM-ja mund të autorizojë verifikuesin të kryejë vizita virtuale pa marrjen e miratimit të posaçëm të përmendur në pikën 4 të këtij neni nëse:

a) AKM-ja ka vërtetuar se ka rrethanat e rënda, të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme, jashtë kontrollit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe nevojitet veprim i menjëhershëm për shkak të masave shëndetësore kombëtare të vendosura nga legjislacioni shqiptar;

b) operatorin e instalimit ose operatorin e avionit informon AKM-në lidhur me vendimin e verifikuesit për të kryer një vizitë virtuale, duke përfshirë elementet e specifikuar në pikën 3 të këtij neni.

6. AKM-ja shqyrton informacionin e dhënë nga operatorin e instalimit ose operatorin e avionit sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të këtij neni, gjatë vlerësimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe informon organizmin kombëtar të akreditimit lidhur me rezultatin e vlerësimit.

Neni 37

Vizitat virtuale për verifikimin e raporteve të operatorit të avionëve

1. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, verifikuesi mund të vendosë të kryejë një vizitë virtuale me qëllim verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve ose të raportit për efektet në aviacion të palidhura me CO₂, të një operatorit avioni, në raste të ndryshme nga ato të mbuluara nga neni 36 i kësaj rregulloreje. Vendimi i verifikuesit për të kryer një vizitë virtuale bazohet në rezultatin e analizës së riskut dhe pasi të përcaktohet se të gjitha të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë nga verifikuesi, verifikuesi

informon operatorin e avionit lidhur me vendimin e tij për të kryer një vizitë virtuale pa vonesa të panevojshme.

2. Verifikuesi merr masa për të ulur rrezikun e verifikimit në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i operatorit të avionit nuk përmban pasaktësi domethënëse.

3. Në raste të ndryshme nga ato të mbuluara nga neni 36 i kësaj rregulloreje, verifikuesi kryen gjithmonë një vizitë fizike në terren në një nga situatat e mëposhtme:

a) Kur raporti për të dhënat e shkarkimeve ose raporti për efektet në aviacion të palidhura me CO₂ të një operatori avioni verifikohet për herë të parë nga verifikuesi;

b) Nëse një verifikues nuk ka kryer një vizitë fizike në terren në dy periudha të raportimit menjëherë pararendëse ndaj periudhës aktuale të raportimit;

c) Nëse gjatë periudhës së raportimit janë bërë ndryshime të konsiderueshme në planin e monitorimit, duke përfshirë ndryshimet e përmendura në pikën 4, të nenit 15, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

KREU III KRITERET PËR VERIFIKUESIT

Neni 38 **Fushëveprimi sektorial i akreditimit**

Verifikuesi lëshon raportin e verifikimit vetëm për një operator instalimi ose operator avioni që kryen një veprimtari që mbulohet nga fusha e veprimtarisë së përmendur në shtojcën I të kësaj rregulloreje, për të cilën verifikuesit i është dhënë akreditimi në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për akreditimin dhe të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me kriteret, udhëzimet dhe vlerësimet e miratuara nga organizmi kombëtar i akreditimit në zbatim të ligjit.

Neni 39 **Procesi i garantimit të vazhdueshëm të kompetencave**

1. Verifikuesi krijon, dokumenton, zbaton dhe mban një proces për ekzistencën e vazhdueshme të kompetencave që garanton se i gjithë personeli i ngarkuar me veprimtaritë e verifikimit është kompetent për detyrat që i janë caktuar.

2. Si pjesë e procesit të garantimit të kompetencave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan të paktën sa më poshtë:

a) kriteret e përgjithshme të kompetencave për të gjithë personelin që kryen veprimtaritë e verifikimit;

b) kriteret specifike të kompetencave për çdo funksion të kryer në strukturën e verifikuesit që kryen veprimtaritë e verifikimit, në veçanti për audituesin e MRVA-së, kryeaudituesin e MRVA-së, shqyrtuesin e pavarur dhe ekspertin teknik;

c) një metodë për të siguruar ekzistencën e vazhdueshëm të kompetencave dhe vlerësimin e rregullt të performancës së të gjithë personelit që kryen veprimtaritë e verifikimit;

ç) një proces për të siguruar trajnimin e vazhdueshëm të personelit që kryen veprimtaritë e verifikimit;

d) një proces për të vlerësuar nëse detyra e verifikimit është pjesë e objektit të akreditimit të verifikuesit dhe nëse verifikuesi ka kompetencën, personelin dhe burimet e nevojshme për të përzgjedhur grupin e verifikimit dhe për të përfunduar me sukses veprimtaritë e verifikimit brenda afatit kohor të kërkuar.

3. Kriteret e kompetencave të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, janë

specifike për çdo fushë akreditimi në të cilin këta persona kryejnë veprimtaritë e verifikimit. Gjatë vlerësimit të kompetencave të personelit sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij neni, verifikuesi vlerëson këto kompetenca kundrejt kriterëve të kompetencave, të përmendura në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni. Procesi i përmendur në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij neni, përfshin gjithashtu një proces për të vlerësuar nëse grupi i verifikimit zotëron të gjitha kompetencat dhe personat e nevojshëm për të kryer veprimtaritë e verifikimit për operatorin e instalimit ose operatorin e avionit në fjalë. Verifikuesi zhvillon kriterë të përgjithshme dhe specifike të kompetencave, të cilat janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 40, pikën 4, dhe nenet 41, 42 dhe 43 të kësaj rregulloreje.

4. Verifikuesi monitoron rregullisht performancën e të gjithë personelit dhe kryen veprimtari verifikimi për të konfirmuar kompetencat e personelit në fjalë.

5. Verifikuesi rishikon rregullisht procesin e verifikimit të kompetencave të përmendura në pikën 1 të këtij neni për të siguruar që:

a) kriteret e kompetencave, të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, zhvillohen në përputhje me kriteret e kompetencave sipas kësaj rregulloreje;

b) trajtohen të gjitha problematikat që mund të identifikohen në lidhje me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të kompetencave sipas kërkesave në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni;

c) të gjitha kërkesat në procesin e verifikimit të kompetencave përditësohen dhe ruhen sipas rastit.

6. Verifikuesi ka një sistem për regjistrimin e rezultateve të veprimtarive të kryera në procesin e verifikimit të kompetencave të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

7. Kompetencat dhe performanca e audituesit të MRVA-së dhe kryeaudituesit të MRVA-së vlerësohen nga një vlerësues që ka kompetencën e mjaftueshme. Vlerësuesi kompetent i monitoron këta auditues gjatë verifikimit të raportit të operatorit të instalimit ose të operatorit të avionit ose të subjektit të rregulluar në vendndodhjen e instalimit ose të operatorit të avionit ose të subjektit të rregulluar, sipas rastit, për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kriteret e kompetencave.

8. Nëse një anëtar i personelit nuk arrin të demonstrojë se janë përmbushur plotësisht kriteret e kompetencave për një detyrë specifike të caktuar për atë anëtar, verifikuesi identifikon dhe organizon trajnime shtesë ose përvojë pune të mbikëqyrur. Verifikuesi e monitoron anëtarin në fjalë derisa anëtari t’i provojë verifikuesit se ai i përmbush kriteret e kompetencave.

Neni 40

Grupet e verifikimit

1. Për çdo detyrë të veçantë verifikimi, verifikuesi mbledh një grup verifikimi të aftë për të kryer veprimtaritë e verifikimit të përmendura në kreun II të kësaj rregulloreje.

2. Grupi i verifikimit përbëhet të paktën nga një kryeauditues i MRVA-së dhe kur përfundimet e verifikuesit gjatë vlerësimit të përmendur në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 8, të kësaj rregulloreje, dhe analiza strategjike e kërkojnë një gjë të tillë, një numër të përshtatshëm audituesish të MRVA-së dhe ekspertësh teknikë.

3. Për shqyrtimin e pavarur të veprimtarive të verifikimit në lidhje me një detyrë të veçantë verifikimi, verifikuesi cakton një shqyrtues të pavarur, i cili nuk është pjesë e grupit të verifikimit.

4. Çdo anëtar i grupit të verifikimit:

a) e kupton qartë rolin e tij individual në procesin e verifikimit;

b) është në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive në gjuhën e nevojshme për të kryer detyrat e tij specifike.

5. Grupi i verifikimit përfshin të paktën një person me kompetencat dhe njohuritë teknike të nevojshme për të vlerësuar aspektet specifike teknike të monitorimit dhe raportimit në lidhje me veprimtaritë e përmendura në shtojcën I të kësaj rregulloreje që kryhen nga instalimi, ose operatori i avionit, ose subjekti i rregulluar. Grupi i verifikimit përfshin gjithashtu një person i cili mund të komunikojë në gjuhën e kërkuar për verifikimin e raportit të të dhënave të

shkarkimeve të një operatori instalimi ose operatori avioni në shtetet ku verifikuesi po kryen verifikimin në fjalë.

6. Kur grupi i verifikimit përbëhet nga një person, ky person plotëson të gjitha kriteret e kompetencave për audituesin e MRVA-së dhe kryeaudituesin e MRVA-së, si dhe kërkesat e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni.

Neni 41

Kriteret e kompetencave për audituesit e MRVA-së dhe kryeaudituesit të MRVA-së

1. Një auditues i MRVA-së duhet të ketë kompetencën e duhur për të kryer verifikimin. Për këtë qëllim, audituesi i MRVA-së duhet të ketë të paktën kompetencën e mëposhtme:

a) Njohuri mbi ligjin nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, mbi vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, dhe aktet e bashkimit evropian të cilat ky vendim bazohet, që janë direktiva 2003/87/KE dhe rregullorja zbatuese (BE) 2018/2066, si dhe njohuri mbi këtë rregullore, standardet përkatëse, legjislacionet e tjera përkatëse, udhëzimet e zbatueshme, si dhe udhëzimet dhe legjislacionin përkatës të shtetit në të cilin verifikuesi po kryen verifikimin; duke përfshirë kriteret dhe udhëzimet e organizmit kombëtar të akreditimit.

b) Njohuri dhe përvojë në auditimin e të dhënave dhe informacionit, duke përfshirë:

i. metodologjitë e auditimit të të dhënave dhe informacionit në përputhje me standardet ISO/IEC 17025 dhe udhëzimet e organizmit kombëtar të akreditimit, duke përfshirë zbatimin e pragut të rëndësisë dhe vlerësimin e rëndësisë të pasaktësive;

ii. analizimin e rreziqeve të brendshme dhe rreziqeve të kontrollit;

iii. teknikat e marrjes së mostrave në lidhje me marrjen e mostrave të të dhënave dhe kontrollin e veprimtarive të kontrollit;

iv. vlerësimin e sistemeve të të dhënave dhe informacionit, sistemeve të TIK-ut, aktiviteteve të fluksit të të dhënave, veprimtarive të kontrollit, sistemeve dhe procedurave të kontrollit për veprimtaritë e kontrollit.

c) Aftësinë për të kryer veprimtaritë që lidhen me verifikimin e raportit të një operatori instalimi, ose operatori avioni, ose subjekti të rregulluar siç kërkohet nga kreu II i kësaj rregulloreje;

ç) Njohuri dhe përvojë në aspektet specifike teknike të monitorimit dhe raportimit që janë me rëndësi për fushën e veprimtarive të përmendur në shtojcën I të kësaj rregulloreje në të cilën audituesi i MRVA-së po kryen verifikimin.

2. Kryeaudituesi i MRVA-së plotëson kriteret e kompetencave për audituesin e MRVA-së dhe duhet të ketë prova se ka kompetencë për të udhëhequr një grup verifikimi dhe për të qenë përgjegjës për kryerjen e veprimtarive të verifikimit në përputhje me këtë rregullore.

Neni 42

Kriteret e kompetencave për shqyrtuesit e pavarur

1. Shqyrtuesi i pavarur ka autoritetin e duhur për të shqyrtuar draftaportin e verifikimit dhe dokumentacionin e brendshëm të verifikimit sipas nenit 25 të kësaj rregulloreje.

2. Shqyrtuesi i pavarur plotëson kriteret e kompetencave të kryeaudituesit të MRVA-së të përmendura në nenin 41, pika 2, të kësaj rregulloreje.

3. Shqyrtuesi i pavarur ka kompetencën e nevojshme për të analizuar informacionin e dhënë për të konfirmuar plotësinë dhe integritetin e informacionit, për të adresuar informacionin që mungon ose është kontradiktor, si dhe për të kontrolluar gjurmët e të dhënave me qëllim vlerësimin nëse dokumentacioni i brendshëm i verifikimit është i plotë dhe ofron informacion të mjaftueshëm për të mbështetur draftaportin e verifikimit.

Neni 43

Përdorimi i ekspertëve teknikë

1. Gjatë kryerjes së veprimtarive të verifikimit, një verifikues mund të përdorë ekspertë teknikë për të ofruar njohuri dhe ekspertizë të detajuar për një çështje specifike, që është e nevojshme për të mbështetur audituesin e MRVA-së dhe kryeaudituesin e MRVA-së në kryerjen e veprimtarive të tyre të verifikimit.

2. Kur shqyrtuesi i pavarur nuk ka kompetencën për të vlerësuar një çështje të caktuar në procesin e shqyrtimit, verifikuesi kërkon mbështetjen e një eksperti teknik.

3. Eksperti teknik ka kompetencën dhe ekspertizën e nevojshme për të mbështetur audituesin e MRVA-së dhe kryeaudituesin e MRVA-së, ose shqyrtuesin e pavarur, kur është e nevojshme, në mënyrë efektive për çështjen për të cilën nevojiten njohuritë dhe ekspertiza e tij. Gjithashtu, eksperti teknik ka një nivel të mjaftueshëm të kuptueshmërisë së çështjeve të përshkruara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 41, të kësaj rregulloreje.

4. Eksperti teknik kryen detyrat e përcaktuara nën drejtimin dhe përgjegjësinë e plotë të kryeaudituesit të MRVA-së të grupit të verifikimit në të cilin operon eksperti teknik ose të shqyrtuesit të pavarur.

Neni 44

Procedurat për veprimtaritë e verifikimit

1. Verifikuesi përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan një ose disa procedura për veprimtaritë e verifikimit, siç përshkruhet në kreun II të kësaj rregulloreje, si dhe procedurat e proceset e kërkuara nga shtojca II e kësaj rregulloreje. Gjatë përcaktimit dhe zbatimit të këtyre procedurave dhe proceseve, verifikuesi kryen veprimtaritë e renditura në shtojcën II të kësaj rregulloreje, në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në atë shtojcë.

2. Verifikuesi ngre, dokumenton, zbaton dhe ruan një sistem menaxhimi, në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje për të siguruar zhvillimin, zbatimin, përmirësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të procedurave dhe proceseve të përmendura në pikën 1 të këtij neni. Sistemi i menaxhimit përfshin të paktën elementet e mëposhtme:

- a) politikat dhe përgjegjësitë;
- b) rishikimin nga niveli drejtues;
- c) auditime të brendshme;
- ç) masat korrigjuese;
- d) masat për të adresuar rreziqet dhe mundësitë dhe për të ndërmarrë veprime parandaluese;
- dh) kontrollin e informacionit të dokumentuar.

Neni 45

Regjistrat e të dhënave dhe komunikimi

1. Verifikuesi mban dhe menaxhon regjistrat e të dhënave, duke përfshirë të dhënat mbi kompetencën dhe paanshmërinë e personelit, për të demonstruar përputhshmërinë me parashikimet e kësaj rregulloreje.

2. Verifikuesi u jep rregullisht informacion operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe palëve të tjera përkatëse, në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

3. Verifikuesi ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë verifikimit në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

Paanshmëria dhe pavarësia

1. Verifikuesi është i pavarur nga operatori i instalimit ose operatori i avionit dhe i paanshëm në kryerjen e veprimtarive të tij të verifikimit. Për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë, verifikuesi dhe çdo pjesë e të njëjtit person juridik nuk është operator instalimi ose operator avioni, pronar i një operatori instalimi ose operator avioni ose në pronësi të një operatori instalimi ose operator avioni, si dhe nuk ka marrëdhënie me operatorin e instalimit ose operatorin e avionit që mund të ndikojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Verifikuesi është gjithashtu i pavarur nga organet që tregtojnë kuotat e shkarkimeve në sistemin e Bashkimit Evropian për tregtimin e kuotave të shkarkimit të gazeve me efekt serrë, të krijuar sipas nenit 19 të direktivës 2003/87/KE.

2. Verifikuesi organizohet në mënyrë të tillë që të ruajë objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen kërkesat përkatëse për strukturën dhe organizimin e verifikuesit të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

3. Verifikuesi nuk kryen veprimtari verifikimi për një operator instalimi ose operator avioni që paraqet një rrezik të papranueshëm ndaj paanshmërisë së tij ose që krijon një konflikt interesi për të. Verifikuesi nuk përdor personel ose persona të kontraktuar në verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të një operatori instalimi ose operator avioni që përfshin një konflikt real ose të mundshëm interesi. Verifikuesi siguron gjithashtu që veprimtaritë e personelit ose organizatave të mos ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e verifikimit. Për këtë qëllim, verifikuesi monitoron rreziqet ndaj paanshmërisë dhe merr masat e duhura për të adresuar këto rreziqe. Konsiderohet se ka lindur një rrezik i papranueshëm ndaj paanshmërisë ose një konflikt interesi i përmendur më sipër në këtë pikë, në veçanti në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur një verifikues ose një pjesë e të njëjtit person juridik ofron shërbime konsulence për të zhvilluar një pjesë të procesit të monitorimit dhe raportimit që përshkruhet në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë zhvillimin e metodologjisë së monitorimit, hartimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe hartimin e planit të monitorimit;

b) Kur një verifikues ose një pjesë e të njëjtit person juridik ofron asistencë teknike për zhvillimin ose mirëmbajtjen e sistemit të zbatuar për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve dhe të efekteve në aviacion të palidhura me CO₂.

4. Konsiderohet se ka lindur një konflikt interesi për marrëdhëniet mes verifikuesit dhe operatorit të instalimit ose operatorit të avionit në veçanti në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur marrëdhënia ndërmjet verifikuesit dhe operatorit të instalimit ose operatorit të avionit bazohet në faktorë të tillë si pronësia e përbashkët, qeverisja e përbashkët, menaxhimi ose personeli i përbashkët, burimet e përbashkëta, financat e përbashkëta dhe kontratat ose marketingu i përbashkët;

b) Kur operatori i instalimit ose operatori i avionit ka marrë shërbime konsulence të llojit të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni, ose asistencë teknike të llojit të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni, nga një organ konsulence, një organ i asistencës teknike ose një organizatë tjetër që ka marrëdhënie me verifikuesin dhe që kërcënon paanshmërinë e verifikuesit.

5. Për qëllimet e shkronjës “b”, të pikës 4, të këtij neni, paanshmëria e verifikuesit konsiderohet e cenuar kur marrëdhënia ndërmjet verifikuesit dhe organit të konsulencës, organit të asistencës teknike ose një organizate tjetër bazohet në faktorë të tillë si pronësia e përbashkët, qeverisja e përbashkët, menaxhimi ose personeli i përbashkët, burimet e përbashkëta, financat e përbashkëta, kontratat ose marketingu i përbashkët, si dhe pagesa e komisionit për shitjet ose e bonuseve të tjera për referimin e klientëve të rinj.

6. Verifikuesi nuk ia delegon palëve të treta nëpërmjet nënkontraktimit mbylljen e marrëveshjes midis operatorit të instalimit ose operatorit të avionit dhe verifikuesit, shqyrtimin e pavarur ose nxjerrjen e raportit të verifikimit. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, gjatë

nënkontraktimit të veprimtarive të tjera të verifikimit, verifikuesi plotëson kriteret përkatëse të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje. Megjithatë, kontraktimi i individëve për kryerjen e veprimtarive të verifikimit nuk përbën nënkontraktim sipas specifikimeve të këtij neni nëse verifikuesi, gjatë kontraktimit të këtyre personave, merr përsipër përgjegjësinë e plotë për veprimtaritë e verifikimit të kryera nga personeli i kontraktuar. Kur kontraktin individë për kryerjen e veprimtarive të verifikimit, verifikuesi u kërkon këtyre individëve të nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për të konfirmuar respektimin e procedurave të verifikuesit dhe mungesën e konflikteve të interesit në kryerjen e veprimtarive të verifikimit.

7. Verifikuesi përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan një proces për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e vazhdueshme të verifikuesit, pjesëve të të njëjtit person juridik, organizatave të tjera të përmendura në pikën 4 të këtij neni dhe të të gjithë personelit dhe personave të kontraktuar të përfshirë në verifikim. Ky proces përfshin një mekanizëm për të ruajtur paanshmërinë dhe pavarësinë e verifikuesit dhe plotëson kriteret përkatëse të përcaktuara në standardin e harmonizuar, të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje. Kur verifikon të njëjtin operator instalimi ose operator avioni që ka verifikuar në vitin paraardhës, verifikuesi merr parasysh rrezikun ndaj paanshmërisë dhe merr masa për të reduktuar rrezikun ndaj paanshmërisë.

8. Nëse kryeaudituesi i MRVA-së ka kryer verifikime vjetore për një operator avioni të caktuar për gjashtë vjet, atëherë kryeaudituesi i MRVA-së merr një pushim të pandërprerë prej tre vjetësh nga ofrimi i shërbimeve të verifikimit për të njëjtin operator avioni. Periudha maksimale prej gjashtë vjetësh përfshin çdo verifikim të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të kryer për një operator avioni duke filluar nga kryerja e verifikimit të parë për operatorin e avionit.

9. Nëse kryeaudituesi i MRVA-së kryen verifikime vjetore për një periudhë prej pesë vjetësh për një instalim të caktuar, atëherë kryeaudituesi i MRVA-së merr një pushim të pandërprerë prej tre vjetësh nga ofrimi i shërbimeve të verifikimit për të njëjtin instalim. Periudha maksimale prej pesë vjetësh përfshin verifikimet MRVA të shkarkimeve të kryera nga instalimi, duke filluar nga kryerja e verifikimit të parë për operatorin e instalimit.

KREU IV VERIFIKIMI I RAPORTEVE TË SUBJEKTIT TË RREGULLUAR

Neni 47

Besueshmëria e verifikimit të raporteve të subjektit të rregulluar

1. Raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar është i besueshëm për përdoruesit kur është i verifikuar. Raporti i verifikuar pasqyron me besnikëri atë që pretendon të paraqesë ose atë që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të paraqesë.

2. Procesi i verifikimit të një raporti të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar duhet të jetë një instrument efektiv dhe i besueshëm në mbështetje të procedurave të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë, duke dhënë informacion ku subjekti i rregulluar mund të bazohet për të përmirësuar performancën në monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve.

Neni 48

Detyrimet e përgjithshme të verifikuesit

1. Verifikuesi kryen verifikimin dhe veprimtaritë e kërkuara nga ky kre, duke synuar të përgatisë një raport verifikimi që arrin në përfundimin, me një nivel të arsyeshëm sigurie, se raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar është i lirë nga pasaktësitë domethënëse.

2. Verifikuesi planifikon dhe kryen verifikimin me një qëndrim skepticizmi profesional, duke qenë i vetëdijshëm se mund të ekzistojnë rrethana që bëjnë që informacioni i paraqitur në raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar mund të përmbajë pasaktësi

domethënëse.

3. Verifikuesi duhet të kryejë verifikimin në interesin publik dhe të jetë i pavarur nga subjekti i rregulluar nga AKM-ja dhe nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

4. Gjatë verifikimit, verifikuesi vlerëson nëse:

a) raporti i subjektit të rregulluar është i plotë dhe i përmbush kërkesat e përcaktuara në shtojcat X dhe Xb të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) subjekti i rregulluar ka vepruar në përputhje me kërkesat e autorizimit për shkarkimet e gazeve serrë dhe të planit të monitorimit, të miratuar nga AKM-ja;

c) të dhënat në raportin e subjektit të rregulluar nuk përmbajnë pasaktësi domethënëse;

ç) mund të sigurohet informacion mbështetës lidhur me fluksin e të dhënave, sistemin e kontrollit dhe procedurat përkatëse të subjektit të rregulluar, në mënyrë që të përmirësohet performanca në monitorim dhe raportim.

5. Për qëllimet e shkronjës “c”, të pikës 4, të këtij neni, verifikuesi siguron prova të qarta dhe objektive nga subjekti i rregulluar për të mbështetur të dhënat mbi shkarkimet e konsoliduara (agreguara) të raportuara, duke marrë parasysh gjithë informacionin tjetër të dhënë në raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar.

6. Verifikuesi këshillon subjektin e rregulluar të marrë miratimin e nevojshëm nga AKM-ja kur:

a) plani i monitorimit nuk është miratuar nga AKM-ja, sipas parashikimeve të nenit 91, pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) plani i monitorimit është i paplotë;

c) janë bërë ndryshime të rëndësishme në përputhje me pikën 3, të nenit 94, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, gjatë periudhës së raportimit dhe ato nuk janë miratuar nga AKM-ja në përputhje me rregullat.

7. Pas miratimit nga AKM-ja, verifikuesi vazhdon, përsërit ose përshtat përkatësisht veprimtaritë e verifikimit. Nëse miratimi nuk është marrë përpara lëshimit të raportit të verifikimit, verifikuesi e raporton këtë rrethanë në raportin e verifikimit.

8. Nëse verifikuesi zbulon se një subjekt i rregulluar nuk është në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, kjo parregullsi përfshihet në raportin e verifikimit edhe nëse plani i monitorimit përkatës është miratuar nga AKM-ja.

1. Përpara se të pranojë një detyrë verifikimi, verifikuesi merr informacione të mjaftueshme rreth subjektit të rregulluar dhe vlerëson nëse mund ta kryejë detyrën e verifikimit. Për këtë qëllim verifikuesi duhet që të paktën:

a) të vlerësojë rreziqet e përfshira në kryerjen e verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar në përputhje me këtë rregullore;

b) të shqyrtojë informacionin e dhënë nga subjekti i rregulluar për të përcaktuar objektin dhe shtrirjen e verifikimit;

c) të vlerësojë nëse kjo detyrë është pjesë e fushës së tij të akreditimit;

ç) të vlerësojë nëse ka kompetencën, personelin dhe burimet e nevojshme për të përzgjedhur një grup verifikimi të aftë për të trajtuar kompleksitetin e aktiviteteve të subjektit të rregulluar, si dhe nëse është i aftë të përfundojë me sukses veprimtaritë e verifikimit brenda afatit kohor të kërkuar;

d) të vlerësojë nëse është në gjendje të garantojë se grupi i mundshëm i verifikimit që është në dispozicion të tij, zotëron të gjitha kompetencat dhe personat e nevojshëm për të kryer veprimtaritë e verifikimit për subjektin e rregulluar në fjalë;

dh) të përcaktojë, për çdo detyrë verifikimi të kërkuar, kohën e nevojshme të kryerjes së detyrës për të kryer siç duhet verifikimin.

2. Subjekti i rregulluar duhet t'i sigurojë verifikuesit të gjithë informacionin përkatës që i mundëson verifikuesit të kryejë veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 50

Përcaktimi i kohëzgjatjes së nevojshme të kryerjes së detyrës

1. Kur përcakton kohëzgjatjen e nevojshme për kryerjen e detyrës për një detyrë verifikimi të përmendur në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 49, të kësaj rregulloreje, verifikuesi merr parasysh të paktën:

a) kompleksitetin e subjektit të rregulluar;

b) nivelin e informacionit dhe kompleksitetin e planit të monitorimit të miratuar nga AKM;

c) prapun e rëndësisë të kërkuar;

ç) kompleksitetin dhe tërësinë e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe sistemin e kontrollit të subjektit të rregulluar;

d) vendndodhjen e informacionit dhe të të dhënave mbi shkarkimet e gazeve me efekt serrë.

2. Verifikuesi sigurohet që kontrata e verifikimit të parashikojë mundësinë e zgjatjes së kohës së nevojshme për kryerjen e detyrës, krahas kohëzgjatjes së rënë dakord në kontratë, kur një kohë e tillë shtesë është e nevojshme për analizën strategjike, analizën e rreziqut ose veprimtari të tjera verifikimi. Situatat në të cilat mund të nevojitet kohë shtesë përfshijnë të paktën rastet e mëposhtme:

a) Rastet kur, gjatë verifikimit, aktivitetet e fluksit të të dhënave, veprimtaritë e kontrollit apo logjistika e subjektit të rregulluar duket se janë më komplekse sesa ishte parashikuar fillimisht;

b) Rastet kur, gjatë verifikimit, verifikuesi identifikon pasaktësi, mospërputhshmëri, të dhëna të pamjaftueshme ose gabime në grupet e të dhënave.

3. Verifikuesi e dokumenton kohëzgjatjen e përcaktuar të punës në dokumentacion e brendshëm të verifikimit.

Neni 51

Informacion nga subjekti i rregulluar

1. Para kryerjes së analizës strategjike dhe gjatë fazave të tjera të procesit të verifikimit, subjekti i rregulluar pajis verifikuesin me të gjitha elementet në vijim:

a) Kopjen e autorizimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë të subjektit të rregulluar;

b) Versionin e fundit të planit të monitorimit të subjektit të rregulluar, si dhe të gjitha versionet e tjera përkatëse të planit të monitorimit të miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë provën e miratimit;

c) Një përshkrim të aktiviteteve të fluksit të të dhënave të subjektit të rregulluar;

ç) Vlerësimin e rrezikut të kryer nga subjekti i rregulluar, të parashikuar në nenin 66, pika 2, shkronja “a”, dhe nenin 116, pika 2, shkronja “a”, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, si dhe një përshkrim të sistemit të kontrollit në tërësi;

d) Procedurat e përmendura në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë procedurat për aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe veprimtaritë e kontrollit;

dh) Raportin vjetor të të dhënave të shkarkimeve GES të subjektit të rregulluar, përfshirë informacionin e raportuar të renditur në shtojcën Xb të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

e) Informacionin e renditur në shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, kur subjekti i rregulluar e ka marrë këtë informacion nga raporti i operatorit të instalimit, i operatorit të avionit ose i shoqërisë së transportit detar, në përputhje me pikën 2, të nenit 132, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

ë) kur subjekti i rregulluar e ka marrë informacionin e përmbajtur në raportin e të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, të operatorit të avionit ose të shoqërisë së transportit detar, në përputhje me shtojcën Xa të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, çdo vëzhgim ose gjetje që lidhet me atë subjekt të rregulluar dhe që është raportuar në raportin e verifikimit nga verifikuesi që ka verifikuar raportin e operatorit të instalimit, të operatorit të avionit ose të shoqërisë së transportit detar, në përputhje me nenin 27, pika 3, shkronjat “h”, “l”, “o” dhe “q” të kësaj rregulloreje;

f) kur është e zbatueshme, planin e marrjes së mostrave të subjektit të rregulluar sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 107 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, të miratuar nga AKM-ja;

g) nëse plani i monitorimit është ndryshuar gjatë periudhës së raportimit, një listë të të gjitha ndryshimeve përkatëse në përputhje me nenin 16, pika 4, dhe 95, pika 4, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe

procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

gj) kur është e zbatueshme raportet e përmendura në nenin 126 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

h) raportin e verifikimit të vitit të mëparshëm, nëse verifikuesi nuk e ka kryer vetë verifikimin për atë subjekt të rregulluar gjatë vitit të mëparshëm;

i) të gjithë korrespondencën përkatëse me AKM-në, në veçanti informacionin lidhur me njoftimin e ndryshimeve në planin e monitorimit, si dhe lidhur me korrigjimet në të dhënat e raportuara;

j) kur është e zbatueshme, miratimin e AKM-së për moskryerjen e vizitave në terren në përputhje me parashikimet e neneve 68 dhe 69 të kësaj rregulloreje;

k) provat e subjektit të rregulluar që tregojnë përputhshmërinë me pragjet e pasigurisë të shkallëve metodologjike të parashikuara në planin e monitorimit;

l) çdo informacion tjetër të nevojshëm dhe të vlefshëm për planifikimin dhe kryerjen e verifikimit.

2. Para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, subjekti i rregulluar duhet t’i japë verifikuesit raportin e të dhënave të shkarkimeve në variantin përfundimtar të autorizuar dhe të miratuar në nivel të brendshëm nga subjekti i rregulluar.

Neni 52

Analiza strategjike

1. Në fillim të verifikimit, verifikuesi vlerëson natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e mundshëm të detyrave të verifikimit, duke kryer një analizë strategjike të të gjitha veprimtarive të lidhura me subjektin e rregulluar.

2. Për të kuptuar veprimtaritë e kryera nga subjekti i rregulluar, verifikuesi mbledh dhe shqyrton informacionin e nevojshëm për të vlerësuar se grupi i verifikimit është mjaftueshëm kompetent për të kryer verifikimin, për të përcaktuar nëse kohëzgjatja e caktuar në kontratë është ajo e duhura, si dhe për të garantuar se është në gjendje të kryejë analizën e nevojshme të rrezikut. Informacioni përfshin, të paktën:

a) informacionin e përmendur në pikën 1, të nenit 51, të kësaj rregulloreje;

b) pragun e rëndësisë të përcaktuar;

c) informacionin e marrë nga verifikimet e viteve të mëparshme, nëse verifikuesi po kryen verifikimin për të njëjtin subjekt të rregulluar.

3. Kur shqyrton informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi vlerëson të paktën sa më poshtë:

a) Kategorinë e subjektit të rregulluar si dhe sektorët për të cilët subjekti i rregulluar hedh lëndë djegëse për konsum;

b) Kompleksitetin e zinxhirit të furnizimit me lëndë djegëse si dhe numrin e llojin e konsumatorëve të lëndëve djegëse;

c) Planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, si dhe specifikat e metodologjisë së monitorimit dhe faktorin e fushëveprimit, të përcaktuara në atë plan monitorimi, në përputhje me kreun VIII të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në

aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”;

ç) Natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rrymave të lëndëve djegëse, si dhe pajisjet, burimet e të dhënave dhe proceset e përdorura për të përcaktuar sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum, origjinën dhe zbatimin e faktorëve të llogaritjes, si dhe burime të tjera parësore të të dhënave;

d) Aktivitetet e fluksit të të dhënave, sistemin e kontrollit dhe mjedisin e kontrollit.

4. Kur kryen analizën strategjike, verifikuesi kontrollon sa më poshtë:

a) Nëse plani i monitorimit që i është dorëzuar nga subjekti i rregulluar, është versioni më i fundit dhe është miratuar nga AKM kur kërkohet;

b) Nëse janë bërë ndryshime në planin e monitorimit gjatë periudhës së raportimit;

c) Kur është e zbatueshme, nëse ndryshimet e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike i janë njoftuar AKM-së sipas nenit 15, pikat 1 dhe 2, nenit 94, pikat 1 dhe 2, ose nenit 100 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, apo nëse janë miratuar nga AKM-ja në përputhje me nenin 15, pika 2, dhe 94, pika 2, të vendimit të mësipërm.

Neni 53

Analiza e riskut

1. Për të projektuar, planifikuar dhe zbatuar një verifikim efektiv, verifikuesi identifikon dhe analizon elementet e mëposhtme:

a) Rreziqet e brendshme;

b) Veprimtaritë e kontrollit;

c) Nëse janë zbatuar veprimtaritë e kontrollit të përmendura në shkronjën “b”, të kësaj pike, rreziqet e kontrollit lidhur me efektivitetin e këtyre veprimtarive të kontrollit.

2. Kur identifikon dhe analizon elementet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi merr në konsideratë të paktën:

a) gjetjet nga analiza strategjike e përmendur në nenin 52, pika 1, të kësaj rregulloreje;

b) informacionin e përmendur në nenin 51 dhe nenin 52, pika 2, shkronja “c”, të kësaj rregulloreje;

c) prapun e rëndësisë të përmendur në nenin 52, pika 2, shkronja “b”, të kësaj rregulloreje.

3. Nëse verifikuesi përcakton se subjekti i rregulluar nuk ka identifikuar rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit përkatëse në vlerësimin e tij të rrezikut, atëherë verifikuesi informon subjektin e rregulluar rreth këtij fakti.

4. Nëse e gjykon të përshtatshme, bazuar në informacionin e marrë gjatë verifikimit, verifikuesi rishikon analizën e riskut dhe ndryshon ose përsërit veprimtaritë e verifikimit që duhen kryer.

Neni 54

Plani i verifikimit

1. Verifikuesi harton një plan verifikimi në përputhje me informacionin e marrë dhe rreziqet e identifikuara gjatë analizës strategjike dhe analizës së riskut, duke përfshirë të paktën:

a) një program verifikimi që përshkruan natyrën dhe shtrirjen e veprimtarive të verifikimit, si dhe kohën e mënyrën në të cilën duhet të kryhen këto veprimtari;

b) një plan testimi që përcakton objektin dhe metodat e testimit të veprimtarive të kontrollit, si dhe procedurat për veprimtaritë e kontrollit;

c) një plan për kampionimin e të dhënave që përcakton shtirjen dhe metodat e kampionimit të të dhënave në pikat e mbledhjes së të dhënave të cilat bazohen shkarkimet e konsoliduara (agreguara) të raportuara në raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar.

2. Verifikuesi e harton planin e testimit, të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, në një mënyrë të tillë që e lejon atë të përcaktojë masën në të cilën veprimtaritë përkatëse të kontrollit mund të përdoren për të vlerësuar pajtueshmërinë me kërkesat e përmendura në nenin 48, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj rregulloreje. Kur përcakton madhësinë e kampionimit dhe veprimtaritë e kampionimit për testimin e veprimtarive të kontrollit, verifikuesi merr në konsideratë elementet e mëposhtme:

- a) Rreziqet e brendshme;
- b) Mjedisin e kontrollit;
- c) Veprimtaritë përkatëse të kontrollit;
- ç) Kërkesën për dorëzimin e një opinioni verifikimi që ofron një nivel besueshmërie të arsyeshme.

3. Kur përcakton madhësinë e kampionimit dhe veprimtaritë e kampionimit për kampionimin e të dhënave të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, verifikuesi merr në konsideratë elementet e mëposhtme:

- a) Rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit;
- b) Rezultatet e procedurave analitike;
- c) Kërkesën e dorëzimit të një opinioni verifikimi me një nivel besueshmërie të arsyeshme;
- ç) Pragun e rëndësisë;
- d) Rëndësinë e kontributit që sjell një element specifik i të dhënave në kuadrin e të gjithë grupit të të dhënave.

4. Verifikuesi harton dhe zbaton planin e verifikimit në mënyrë të tillë që rreziku i verifikimit të ulët në një nivel të pranueshëm për të arritur sigurinë e arsyeshme se raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar nuk përmban pasaktësi domethënëse.

5. Verifikuesi përditëson analizën e riskut dhe planin e verifikimit, si dhe përshtat veprimtaritë e verifikimit gjatë verifikimit, kur konstaton rreziqe të tjera që duhen zvogëluar ose kur ka rrezik më të ulët nga sa ishte parashikuar fillimisht.

Neni 55

Veprimtaritë e verifikimit

1. Verifikuesi zbaton planin e verifikimit dhe, në bazë të analizës së riskut, kontrollon zbatimin e planit të monitorimit, të miratuar nga AKM-ja.

2. Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, verifikuesi kryen të paktën testime thelbësore që përbëhen nga procedura analitike, verifikimi i të dhënave dhe kontrolli i metodologjisë së monitorimit, si dhe kontrollon elementet e mëposhtme:

- a) Aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe sistemet e përdorura në fluksin e të dhënave, duke përfshirë sistemet e teknologjisë së informacionit;
- b) Nëse veprimtaritë e kontrollit të subjektit të rregulluar janë dokumentuar, zbatuar dhe ruajtur siç duhet, si dhe nëse janë efektive për të zbutur rreziqet e brendshme;
- c) Nëse procedurat e renditura në planin e monitorimit janë efektive për të zbutur rreziqet e brendshme dhe rreziqet e kontrollit dhe nëse procedurat janë zbatuar, janë dokumentuar në një masë të mjaftueshme dhe janë ruajtur siç duhet.

3. Për qëllime të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni, verifikuesi gjurmon fluksin e të dhënave, duke ndjekur rendin dhe ndërveprimin e aktiviteteve të fluksit të të dhënave që nga burimi fillestar i të dhënave deri në hartimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar.

Neni 56

Procedurat analitike

1. Verifikuesi përdor procedura analitike për të vlerësuar besueshmërinë dhe plotësinë e të dhënave, kur rreziku i brendshëm, rreziku i kontrollit dhe përshtatshmëria e veprimtarive të

kontrollit të subjektit të rregulluar tregojnë nevojën për përdorimin e procedurave të tilla analitike.

2. Gjatë kryerjes së procedurave analitike të përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi vlerëson të dhënat e raportuara për të identifikuar zonat e mundshme të rrezikut dhe, rrjedhimisht, për të validuar dhe përshtatur veprimtaritë e planifikuara të verifikimit. Verifikuesi duhet të paktën:

a) të vlerësojë besueshmërinë e luhatjeve dhe të tendencave të shfaqura me kalimin e kohës ose midis zërave të ngjashëm;

b) të identifikojë vlerat që janë qartësisht jonormale, të dhënat e paparashikuara dhe mangësitë në të dhëna.

3. Gjatë zbatimit të procedurave analitike të përmendura në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi zbaton procedurat e mëposhtme:

a) Procedurat paraprake analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara), përpara se të kryejë veprimtaritë e përmendura në nenin 55, të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të kuptohet natyra, kompleksiteti dhe rëndësia e të dhënave të raportuara;

b) Procedurat thelbësore analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara) dhe pikat e mbledhjes së të dhënave ku bazohen këto të dhëna, me qëllim identifikimin e gabimeve të mundshme strukturore dhe të vlerave që janë qartësisht jonormale;

c) Procedurat përfundimtare analitike për të dhënat e konsoliduara (agreguara) për të garantuar zgjidhjen e saktë të të gjitha gabimeve të identifikuar gjatë procesit të verifikimit.

4. Kur verifikuesi identifikon vlera që janë qartësisht jonormale, luhatje, tendenca, mangësi në të dhëna ose të dhëna që nuk janë në përputhje me informacionet e tjera të mbledhura, apo që ndryshojnë ndjeshëm nga shumat ose proporcionet numerike (*ratio*) të parashikuara, verifikuesi merr shpjegime nga subjekti i rregulluar, të mbështetura nga provat përkatëse shtesë. Bazuar në shpjegimet dhe provat shtesë të dorëzuara, verifikuesi vlerëson ndikimin e tyre në planin e verifikimit dhe te veprimtaritë e verifikimit që duhen kryer.

Neni 57

Verifikimi i të dhënave

1. Verifikuesi verifikon të dhënat në raportin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar, duke zbatuar testimin e detajuar të të dhënave, përfshirë gjurmimin e tyre deri në burimin fillestar, krahasimin me burimet e jashtme të të dhënave, rakordimin e të dhënave, kontrollin e kufijve lidhur me të dhënat e përshtatshme dhe rillogaritjet.

2. Në kuadër të verifikimit të të dhënave të përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe duke marrë parasysh planin e miratuar të monitorimit, duke përfshirë procedurat e përshkruara në atë plan, verifikuesi kontrollon:

a) kufijtë e monitorimit të subjektit të rregulluar, përfshirë vendndodhjen e pikave nga të cilat lënda djegëse hidhet në treg për konsumatorin;

b) përshkrimin në mënyrë të plotë të rrymave të lëndëve djegëse të hedhura për konsum, të renditura në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, si dhe sasitë përkatëse të këtyre lëndëve djegëse dhe të dhënat e shkarkimeve;

c) përputhshmërinë ndërmjet sasive të konsoliduara (agreguara) të lëndës djegëse të hedhur për konsum dhe të dhënave mbi lëndën djegëse të blerë nga subjekti i rregulluar ose të furnizuar në ndonjë mënyrë tjetër për subjektin të rregulluar;

ç) përputhshmërinë e të dhënave të konsoliduara (agreguara) të raportuara në raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar me të dhënat e përfituara nga burimet parësore;

d) besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave.

Neni 58

Verifikimi i zbatimit të duhur të metodologjisë së monitorimit

1. Verifikuesi kontrollon zbatimin e duhur të metodologjisë së monitorimit, të miratuar nga

AKM-ja në planin e monitorimit, përfshirë detajet specifike të kësaj metodologjie monitorimi.

2. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, verifikuesi kontrollon zbatimin e duhur të planit të marrjes së mostrave, të parashikuar në nenin 33 dhe nenin 107 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, që është miratuar nga AKM-ja.

3. Kur rregullorja e miratuar me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, kërkon që subjekti i rregulluar të dëshmojë përputhjen me pragjet e pasigurisë për të dhënat e aktivitetit dhe faktorët e llogaritjes, verifikuesi duhet të konfirmojë vlefshmërinë e informacionit të përdorur për të llogaritur nivelet e pasigurisë, siç përcaktohet në planin e monitorimit të miratuar.

4. Gjatë verifikimit të metodologjisë së monitorimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi kontrollon zbatimin dhe aplikimin e saktë të metodës për përcaktimin e faktorit të fushëveprimit, ashtu siç është përcaktuar në planin e monitorimit të miratuar nga AKM-ja, në përputhje me kreun VIII të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

5. Verifikuesi kontrollon provat e paraqitura nga subjekti i rregulluar që dëshmojnë nëse lënda djegëse është hedhur për konsum në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

6. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, verifikuesi, në kuadër të kontrollit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kontrollon provat vijuese:

a) provat e subjektit të rregulluar që dëshmojnë se lëndët djegëse të biomasës me normë zero janë në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për biokarburantet, biolëngjet dhe lëndët djegëse nga biomasa të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

b) provat e subjektit të rregulluar që dëshmojnë se lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike (“RFNBO”) apo lëndët djegëse të ricikluara me bazë karboni (“RCF”), me normë zero, janë në përputhje me kriteret e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë për lëndët djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike dhe lëndët djegëse me bazë karboni të ricikluara të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

c) provat e subjektit të rregulluar që dëshmojnë të gjitha aspektet në vijim:

i. përputhshmërinë e lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët, me normë zero, me pragun e reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;

ii. nëse përmbajtja e karbonit të lëndëve djegëse sintetike me karbon të ulët ka qenë subjekt i kryerjes paraprakisht të pagesës së detyrimeve të karbonit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ose, sipas rastit, i kryerjes paraprakisht të detyrimeve të raportimit të shkarkimeve kur pagesa e detyrimeve të karbonit nuk ka hyrë ende në fuqi.

7. Për të vlerësuar nëse lëndët djegëse të hedhura për konsum në sektorët e mbuluar nga shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, janë përdorur brenda të njëjtit vit raportimi dhe mund të zbriten në përputhje me pikën 4, të nenit 132, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me

efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi duhet të kontrollojë përputhshmërinë ndërmjet informacionit të përmendur në nenin 51, pika 1, shkronja “e”, të kësaj rregulloreje, dhe informacionit të përfshirë në raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar që i përket shtojcës Xb të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

Neni 59

Verifikimi i metodave të zbatuara për mangësitë e të dhënave

1. Kur metodat e përcaktuara në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, janë përdorur për të plotësuar të dhënat që mungojnë në përputhje me nenet 73 dhe 123 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi kontrollon nëse metodat e përdorura janë të përshtatshme për situatën specifike dhe nëse janë zbatuar siç duhet.

2. Nëse subjekti i rregulluar ka marrë miratimin nga AKM-ja për të përdorur metoda të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me nenet 73 dhe 123 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, verifikuesi kontrollon nëse qasja e miratuar është zbatuar siç duhet dhe dokumentuar në mënyrë të përshtatshme. Kur subjekti i rregulluar nuk ka mundur ta marrë në kohë këtë miratim nga AKM-ja, verifikuesi kontrollon nëse qasja e përdorur nga subjekti i rregulluar për të plotësuar të dhënat që mungojnë, siguron që shkarkimet të mos nënvlerësohen dhe që kjo qasje të mos rezultojë në pasaktësi domethënëse.

3. Verifikuesi kontrollon efektivitetin e veprimtarive të kontrollit të zbatuara nga subjekti i rregulluar për të parandaluar mungesën e të dhënave, të përmendura në nenet 73 dhe 123 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

Neni 60

Marrja e mostrave

1. Kur kontrollon përputhshmërinë e veprimtarive dhe procedurave të kontrollit, të përmendura në nenin 55, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj rregulloreje, ose kur kryen kontrollet e përmendura në nenet 56 dhe 57 të kësaj rregulloreje, verifikuesi mund të përdorë metoda për marrjen e mostrave që janë specifike për një subjekt të rregulluar, me kusht që marrja e mostrave të jetë e justifikuar, në bazë të analizës së rrezikut.

2. Kur gjatë marrjes së mostrave verifikuesi identifikon një mospërputhje ose një pasaktësi, i kërkon subjektit të rregulluar të shpjegojë shkaqet kryesore të mospërputhjes ose pasaktësisë për të vlerësuar ndikimin e mospërputhjes ose pasaktësisë në të dhënat e raportuara. Bazuar në rezultatin e këtij vlerësimi, verifikuesi përcakton nëse nevojiten veprimtari shtesë verifikimi, nëse madhësia e marrjes së mostrave duhet të rritet, si dhe pjesën e të dhënave që duhet të korrigjohet nga subjekti i rregulluar.

3. Verifikuesi dokumenton në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit rezultatin e kontrolleve të përmendura në nenet 55 deri në 58 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë detajet e marrjes së mostrave shtesë.

Neni 61

Trajtimi i pasaktësive, mospërputhjeve dhe papajtueshmërive

1. Nëse gjatë verifikimit, verifikuesi identifikon pasaktësi, mospërputhje ose papajtueshmëri me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ai informon në kohë subjektin e rregulluar rreth këtij fakti dhe kërkon korrigjimet përkatëse. Subjekti i rregulluar korrigjon çdo pasaktësi ose mospërputhje të njoftuar. Në këtë rast, subjekti i rregulluar njofton AKM-në për mospërputhjen e konstatuar dhe korrigjon mospërputhjen pa vonesë.

2. Verifikuesi dokumenton dhe shënon si të zgjidhura në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit të gjitha pasaktësitë, mospërputhjet ose papajtueshmëritë me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, të cilat janë korrigjuar nga subjekti i rregulluar gjatë verifikimit.

3. Nëse subjekti i rregulluar nuk korrigjon pasaktësitë ose mospërputhjet e njoftuara nga verifikuesi në përputhje me pikën 1 të këtij neni, para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, verifikuesi i kërkon subjektit të rregulluar të shpjegojë shkaqet kryesore të mospërputhjes ose pasaktësisë për të vlerësuar ndikimin e mospërputhjeve ose pasaktësive të të dhënave të raportuara.

4. Verifikuesi përcakton nëse pasaktësitë e pakorrigjuara, të konsideruara veçmas ose së bashku me pasaktësitë e tjera, kanë një ndikim domethënës të shkarkimet totale të raportuara. Gjatë vlerësimit të nivelit të rëndësisë së pasaktësisë, verifikuesi merr parasysh masën dhe natyrën e pasaktësive, si dhe rrethanat e veçanta në të cilat ndodhin pasaktësitë. Verifikuesi vlerëson gjithashtu nëse mospërputhjet e pakorrigjuara, të konsideruara veçmas ose bashkë me mospërputhje të tjera, ka ndikim të të dhënave të raportuara dhe nëse kjo çon në pasaktësi domethënëse.

5. Nëse subjekti i rregulluar nuk korrigjon mospërputhjen me parashikimet e vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, para se verifikuesi të nxjerrë raportin e verifikimit, atëherë verifikuesi vlerëson nëse mospërputhja e pakorrigjuar ka ndikim të të dhënave të raportuara dhe nëse kjo çon në pasaktësi domethënëse.

6. Verifikuesi mund të konsiderojë se pasaktësitë janë domethënëse edhe nëse ato pasaktësi, veçmas ose së bashku me pasaktësitë e tjera, janë nën pragun e rëndësisë së përcaktuar në nenin

62 të kësaj rregulloreje, kur një konsideratë e tillë justifikohet nga masa dhe natyra e pasaktësive dhe nga rrethanat e veçanta gjatë të cilave ndodhin këto pasaktësi.

Neni 62

Pragu i rëndësisë

1. Për qëllim të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, me shkarkime vjetore nga lëndët djegëse të hedhura për konsum, të barabarta ose më të ulëta se 500 000 (pesëqind mijë) tonë CO_{2e}, pragu i rëndësisë është 5 % e shkarkimeve totale të raportuara gjatë periudhës së raportimit që i nënshtrohet verifikimit.

2. Për qëllim të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, me shkarkime vjetore nga lëndët djegëse të hedhura për konsum më të larta se 500 000 (pesëqind mijë) tonë CO_{2e}, pragu i rëndësisë është 2% e shkarkimeve totale të raportuara gjatë periudhës së raportimit që i nënshtrohet verifikimit.

Neni 63

Përfundimi i verifikimit, shqyrtimi i pavarur dhe dokumentimi

1. Në periudhën e përfundimit të verifikimit dhe duke marrë në konsideratë informacionin e përfutur gjatë verifikimit, verifikuesi:

a) kontrollon të dhënat përfundimtare të marra nga subjekti i rregulluar, duke përfshirë të dhënat që janë korrigjuar në bazë të informacionit të marrë gjatë verifikimit;

b) shqyrton arsyet e subjektit të rregulluar për çdo ndryshim që ekziston ndërmjet të dhënave përfundimtare dhe të dhënave të dorëzuara më parë;

c) shqyrton rezultatin e vlerësimit për të përcaktuar nëse plani i monitorimit, i miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë procedurat e përshtatshme brenda planit, është zbatuar siç duhet;

ç) vlerëson nëse rreziku i verifikimit është brenda një niveli të ulët të pranueshëm për të arritur një siguri të arsyeshme;

d) siguron që janë mbledhur prova të mjaftueshme për të dhënë një opinion verifikimi me një nivel sigurie të arsyeshme se raporti nuk ka pasaktësi domethënëse;

dh) siguron që procesi i verifikimit është dokumentuar plotësisht në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit dhe që është e mundur të jepet një gjykim përfundimtar në raportin e verifikimit.

2. Verifikuesi kryen një shqyrtim të pavarur në përputhje me nenin 25 të kësaj rregulloreje.

3. Verifikuesi përgatit dhe përpilon dokumentacionin e brendshëm të verifikimit, që përmban të paktën:

a) rezultatet e veprimtarive të kryera të verifikimit;

b) analizën strategjike, analizën e riskut dhe planin e verifikimit;

c) informacion të mjaftueshëm për të mbështetur opinionin e verifikimit, duke përfshirë arsyetimet për gjykimet e bëra mbi faktin nëse pasaktësitë e identifikuara kanë ose jo një ndikim domethënës në shkarkimet e raportuara.

4. Për qëllim të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, zbatohet neni 26, pikat 2, 3 dhe 4, të kësaj rregulloreje.

Neni 64

Raporti i verifikimit

1. Në bazë të informacionit të mbledhur gjatë verifikimit, verifikuesi i dorëzon subjektit të rregulluar një raport verifikimi për çdo raport të të dhënave të shkarkimeve, të hartuar nga subjekti i rregulluar, që ka qenë subjekt verifikimi. Raporti i verifikimit përcakton nëse:

a) raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar verifikohet si i kënaqshëm;

b) raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar përmban pasaktësi domethënëse të cilat nuk janë korrigjuar para nxjerrjes së raportit të verifikimit;

c) objekti i verifikimit është shumë i kufizuar, sipas parashikimeve të nenit 65 të kësaj

rregulloreje dhe verifikuesi e kishte të pamundur të merrte prova të mjaftueshme për të nxjerrë një opinion verifikimi me një nivel sigurie të arsyeshme se raporti nuk ka pasaktësi domethënëse;

ç) mospërputhjet, të konsideruara veçmas ose bashkë me mospërputhje të tjera, nuk ofrojnë qartësi të mjaftueshme dhe pengojnë verifikuesin të deklarojë me siguri të arsyeshme se raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar nuk përmban pasaktësi domethënëse.

2. Për qëllimet e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, raporti i të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar mund të verifikohet si në përmbushje të kriterëve vetëm nëse nuk përmban pasaktësi domethënëse.

3. Subjekti i rregulluar ia dorëzon raportin e verifikimit AKM-së së bashku me raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar në fjalë.

4. Raporti i verifikimit përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) Emrin e subjektit të rregulluar që i është nënshtruar verifikimit;

b) Objektivat e verifikimit;

c) Shtrirjen e verifikimit;

ç) Referencën e raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar që është verifikuar;

d) Kriteret e përdorura për të verifikuar raportin e të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, duke përfshirë autorizimin për shkarkimet GES dhe versionet e planit të monitorimit, të miratuara nga AKM-ja, si dhe periudhën e vlefshmërisë për secilin version të planit;

dh) Shkarkimet e konsoliduara (agreguara) për lëndët djegëse që janë hedhur për konsum për veprimtaritë e përcaktuara në shtojcën II, pjesa D, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, si dhe shkarkimet e konsoliduara (agreguara) për çdo subjekt të rregulluar;

e) Periudhën e raportimit, objekt verifikimi;

ë) Përgjegjësitë e subjektit të rregulluar, të AKM-së dhe të verifikuesit;

f) deklaratën e opinionit të verifikimit;

g) Një përshkrim të pasaktësive dhe mospërputhjeve të identifikuara që nuk janë korrigjuar para nxjerrjes së raportit të verifikimit;

gj) Datat në të cilat janë kryer vizitat në terren dhe nga kush, si dhe datat e vizitave virtuale;

h) Informacion nëse nuk janë kryer vizita në terren dhe arsyet për moskryerjen e këtyre vizitave;

i) Informacion nëse është kryer një vizitë virtuale, si dhe arsyet për kryerjen e vizitave virtuale dhe, sipas rastit, datën e miratimit të AKM-së;

j) Konfirmimin se verifikuesi ka kryer kontrollin e përmendur në pikën 7, të nenit 58, të kësaj rregulloreje, dhe se informacioni i përmendur në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 51, të kësaj rregulloreje, është në përputhje me informacionin e përmbajtur në raportin e të dhënave të shkarkimeve që lidhet me shtojcën Xb të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

k) Çdo problem lidhur me mungesën e përputhshmërisë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe që është konstatuar gjatë verifikimit;

l) Nëse nuk mund të merret në kohë miratimi nga AKM-ja për të zbatuar metodën e përdorur për plotësimin e mangësisë së të dhënave sipas pikës 2, të nenit 59, të kësaj rregulloreje, një konfirmim nëse metoda e përdorur është konservative dhe nëse ajo çon ose jo në pasaktësi

domethënëse;

ll) Rekomandime për përmirësime, kur janë të zbatueshme;

m) Emrat e kryeaudituesit të MRVA-së, e shqyrtuesit të pavarur dhe, sipas rastit, të audituesit të MRVA-së dhe ekspertit teknik të përfshirë në verifikimin e raportit të subjektit të rregulluar;

n) Datën dhe nënshkrimin nga një person i autorizuar në emër të verifikuesit, duke përfshirë emrin e tij.

5. Verifikuesi përshkruan pasaktësitë, mospërputhshmëritë dhe papajtueshmëritë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, duke dhënë detaje të mjaftueshme në raportin e verifikimit për t’i mundësuar subjektit të rregulluar, si dhe AKM-së, që të kuptojnë sa më poshtë:

a) Shkallën dhe natyrën e pasaktësisë, mospërputhshmërisë ose papajtueshmërisë me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) Arsyen pse pasaktësia ka apo nuk ka ndikim domethënës;

c) Cilit element të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar i referohet pasaktësia ose cilit element të planit të monitorimit i referohet mospërputhja;

ç) Me cilin nen të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, lidhet papajtueshmëria.

Neni 65

Kufizimi i shtrirjes së verifikimit

Verifikuesi mund të dalë në përfundimin se shtrirja e verifikimit, e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 64, të kësaj rregulloreje, është tepër e kufizuar kur verifikohet një nga situatat e mëposhtme:

a) Kur mungojnë të dhëna që pengojnë verifikuesin të mbledhë provat e nevojshme për të ulur rrezikun e verifikimit në nivelin e duhur për të arritur një shkallë të arsyeshëm sigurie;

b) Kur plani i monitorimit nuk është i miratuar nga AKM-ja;

c) Kur plani i monitorimit nuk ka një shtrirje ose qartësi të mjaftueshme për të mundësuar arritjen e përfundimeve mbi verifikimin;

ç) Subjekti i rregulluar nuk ka vënë në dispozicion informacion të mjaftueshëm për t’i mundësuar verifikuesit të kryejë verifikimin.

Neni 66

Trajtimi i mospërputhjeve jodomethënëse të pazgjidhura

1. Verifikuesi vlerëson nëse subjekti i rregulluar ka korrigjuar mospërputhjet e identifikuar në raportin e verifikimit në lidhje me periudhën e mëparshme të monitorimit sipas kërkesave për subjektin e rregulluar të përcaktuara në pikën 6, të nenit 126, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe

subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", kur është rasti. Nëse subjekti i rregulluar nuk i ka korrigjuar këto mospërputhje sipas pikës 6, të nenit 126, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'", verifikuesi shqyrton nëse mosveprimi rrit ose mund të rrisë rrezikun e pasaktësive.

2. Verifikuesi raporton në raportin e verifikimit nëse këto mospërputhje janë zgjidhur nga subjekti i rregulluar.

3. Verifikuesi regjistron në dokumentacionin e brendshëm të verifikimit detaje mbi kohën se kur dhe mënyrën se si subjekti i rregulluar ka zgjidhur mospërputhjet e identifikuara gjatë verifikimit.

Neni 67

Përmirësimi i procesit të monitorimit dhe raportimit

1. Kur verifikuesi ka identifikuar fusha për përmirësim në performancën e subjektit të rregulluar në lidhje me elementet e parashikuara në shkronjat "a" deri në "ç" të kësaj pike, përfshin në raportin e verifikimit rekomandime për përmirësimin e performancës së subjektit të rregulluar në aspektet e mëposhtme:

- a) Vlerësimin e rrezikut të kryer nga subjekti i rregulluar;
- b) Zhvillimin, dokumentimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe veprimtarive të kontrollit, si dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit;
- c) Zhvillimin, dokumentimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e procedurave për aktivitetet e fluksit të të dhënave dhe veprimtaritë e kontrollit, si edhe të procedurave të tjera që subjekti i rregulluar duhet të ngrejë në përputhje me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregulloreve, 'Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar' dhe 'Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂'";
- ç) Monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, përfshirë në lidhje me arritjen shkallëve metodologjike më të larta, reduktimin e rreziqeve dhe rritjen e efikasitetit për monitorimin dhe raportimin e tyre.

2. Gjatë verifikimit, verifikuesi kontrollon nëse subjekti i rregulluar ka zbatuar rekomandimet për përmirësimet e nevojshme që janë dhënë në raportin e verifikimit të vitit të mëparshëm si dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Kur subjekti i rregulluar nuk i ka zbatuar këto rekomandime ose nuk i ka zbatuar ato siç duhet, verifikuesi vlerëson ndikimin që kjo ka në lidhje me rrezikun e pasaktësive dhe mospërputhjeve.

Neni 68

Vizitat në terren dhe verifikimi i thjeshtuar

1. Në momente të caktuara gjatë procesit të verifikimit, verifikuesi kryen një vizitë në terren për të vlerësuar funksionimin e pajisjeve matëse dhe sistemeve të monitorimit, për të kryer intervista, për të kryer veprimtaritë e kërkuara nga ky kre, si dhe për të mbledhur informacione dhe prova të mjaftueshme që i mundësojnë atij të dalë në përfundimin nëse raporti i subjektit të rregulluar nuk ka pasaktësi domethënëse. Gjatë kryerjes së vizitave në terren, verifikuesi

vlerëson gjithashtu nëse rrymat e lëndëve djegëse dhe sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum janë paraqitur në mënyrë të plotë nga subjekti i rregulluar.

2. Subjekti i rregulluar i siguron verifikuesit akses në vendndodhjet e tij.

3. Për qëllime të verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, verifikuesi, në bazë të analizës së rrezikut, vendos nëse nevojiten vizita në vendndodhje të tjera, duke përfshirë rastet kur pjesë përkatëse të aktiviteteve të fluksit të të dhënave dhe veprimtarive të kontrollit kryhen në vendndodhje të tjera, siç janë selia e shoqërisë dhe zyra të tjera jashtë vendndodhjes së instalimit.

4. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, verifikuesi mund të vendosë të mos kryejë vizita në terren të subjektet e rregulluara dhe në këto raste informon subjektin e rregulluar pa vonesa të paarsyeshme. Vendimi bazohet në elementet e mëposhtme:

a) Në rezultatin e analizës së rrezikut;

b) Në konfirmimin se të gjitha të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë nga verifikuesi;

c) Në konfirmimin se janë përmbushur kushtet për moskryerjen e vizitave në terren në përputhje me nenin 69 të kësaj rregulloreje;

ç) Në konfirmimin se vizitat e detyrueshme në terren, në përputhje me pikën 8 të këtij neni, nuk janë të zbatueshme për atë subjekt të rregulluar.

5. Subjekti i rregulluar paraqet pranë AKM-së një kërkesë që të miratojë vendimin e verifikuesit për të mos kryer vizitën në terren. Aplikimi përmban të paktën informacionet e mëposhtme:

a) Rezultatin e analizës së rrezikut;

b) Prova se të gjitha të dhënat përkatëse mund të aksesohen në distancë nga verifikuesi;

c) Prova se janë përmbushur kushtet për moskryerjen e vizitave në terren, në përputhje me nenin 69 të kësaj rregulloreje;

ç) Prova se vizitat e detyrueshme në terren, në përputhje me pikën 7 të këtij neni, nuk janë të zbatueshme për atë subjekt të rregulluar.

6. Nuk kërkohet miratimi i AKM-së për subjektet e rregulluara me shkarkime të ulëta, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 114, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”.

7. AKM-ja vendos nëse do ta miratojë ose jo vendimin e verifikuesit për të mos kryer vizitën në terren, duke shqyrtuar informacionin e dhënë nga subjekti i rregulluar, në përputhje me shkronjat “a” deri në “ç”, të pikës 5, të këtij neni. Në rast se AKM-ja nuk i është përgjigjur kërkesës së subjektit të rregulluar, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, brenda dy muajve nga marrja e saj, vendimi i verifikuesit konsiderohet i miratuar.

8. Verifikuesi kryen gjithmonë vizita në terren në situatat e mëposhtme:

a) Kur verifikuesi po verifikon për herë të parë raportin e të dhënave të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar;

b) Nëse në dy periudhat e raportimit menjëherë pararendëse të periudhës aktuale të raportimit asnjë verifikues nuk ka kryer një vizitë në terren të subjekti i rregulluar;

c) Nëse gjatë periudhës së raportimit janë bërë ndryshime të konsiderueshme në planin e monitorimit, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit 94, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”.

Kushtet për moskryerjen e vizitave në terren

1. Kushtet për moskryerjen e vizitave në terren parashikohen në pikat e mëposhtme të këtij neni.

2. Kur verifikohet raporti i të dhënave të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar të kategorisë A, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 98, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në rast se:

a) të gjitha rrymat e lëndëve djegëse të hedhura për konsum nga subjekti i rregulluar janë lëndë djegëse të standardit tregtar ose lëndë djegëse ekuivalente me standardin tregtar, në përputhje me pikën 7, të nenit 104, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

b) zbatohen vlerat standarde për faktorin e emetimit dhe faktorin e konvertimit të njësive;

c) zbatohet një vlerë standarde për fraksionin e biomasës, ose, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. Zbatohet shkalla metodologjike 3b për përcaktimin e fraksionit të biomasës të rrymës së lëndës djegëse, në përputhje me shtojcën IIa, seksioni 2.3, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

ii. Verifikuesit i sigurohet akses në të gjithë regjistrat përkatës mbi dokumentacionin e bilancit të masës, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, si dhe prova për përputhjen me kriteret e qëndrueshmërisë ose të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;

iii. Subjekti i rregulluar i siguron verifikuesit akses tek i gjithë personeli i tij për kryerjen e intervistave;

ç) për çdo rrymë lënde djegëse zbatohet faktori sektorial 1, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 110, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ose zbatohet një vlerë standarde për faktorin sektorial në përputhje me pikën 8, të nenit 110, të të njëjtit vendim.

3. Kur verifikohet raporti i të dhënave të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar me shkarkime të ulëta, siç përcaktohet në nenin 114, pika 1, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”.

4. Kur verifikohet raporti i të dhënave të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar të kategorisë A, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 98, të vendimit nr. 486, datë

26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ose të një subjekti të rregulluar të kategorisë B, siç përcaktohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 98, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, në rast se:

a) subjekti i rregulluar në fjalë ka detyrime raportimi sipas legjislacionit shqiptar për taksimin e produkteve energjetike dhe të energjisë elektrike dhe për akcizat, bazuar në metodat e matjes të përdorura për këtë qëllim, kur këto metoda bazohen në parashikimet e legjislacionit shqiptar për kontrollin metrologjik;

b) rrymat e lëndëve djegëse të mbuluara korrespondojnë me produkte energjetike që i nënshtrohen legjislacionit kombëtar në lidhje me taksimin e produkteve energjetike dhe të energjisë elektrike, bazuar në metodat e matjes, të përdorura për këtë qëllim, kur këto metoda bazohen në parashikimet e legjislacionit shqiptar për kontrollin metrologjik;

c) për faktorin e shkarkimit dhe për faktorin e konvertimit të njësisë zbatohen vlerat standarde;

ç) zbatohet vlera standarde për fraksionin e biomasës ose kur zbatohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. Zbatohet shkalla metodologjike 3b për përcaktimin e fraksionit të biomasës të rrymës së lëndës djegëse, në përputhje me shtojcën IIa, seksioni 2.3, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”;

ii. Verifikuesit i sigurohet akses në të gjithë regjistrat përkatës mbi dokumentacionin e bilancit të masës, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi verifikimin e përputhshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë dhe të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, si dhe prova për përputhjen me kriteret e qëndrueshmërisë ose të reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;

iii. Subjekti i rregulluar i siguron verifikuesit akses tek i gjithë personeli i tij për kryerjen e intervistave;

d) për çdo rrymë lënde djegëse zbatohet faktori sektorial 1, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 110, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, ose zbatohet një vlerë standarde për faktorin sektorial në përputhje me pikën 8, të nenit 110, të të njëjtit vendim.

Neni 70

Plani i verifikimit të thjeshtuar, vizitat virtuale në terren dhe verifikimi i thjeshtuar

1. Nenet 35 dhe 36 të kësaj rregulloreje zbatohen për verifikimin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar që mbulohen nga nenet 8, 9, 10 dhe shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar. Për këtë qëllim, çdo referencë e neneve 35 dhe 36 të kësaj rregulloreje ndaj operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit do të lexohet sikur t’i referohej

subjektit të rregulluar.

2. Me qëllim verifikimin e raportit të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar për periudhën e parë të raportimit, verifikuesi, në bazë të analizës së rrezikut, mund të vendosë të mos kryejë kontrolle mbi metodologjinë për përcaktimin e sasive të lëndës djegëse të hedhura për konsum, nëse sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum, të përfshira në raportin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar, përcaktohen në bazë të metodologjisë së përmendur në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 103, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, dhe plotësohet cildo nga kushtet e mëposhtme:

a) Ka prova të siguruara nga një burim i pavarur se sasitë e lëndës djegëse të përcaktuara me metodat e përmendura në nenin në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 103, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, përkohë me sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum të përfshira në raportin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar;

b) Sasitë e lëndës djegëse të hedhura për konsum, që përshkruhen në raportin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar, gjenerohen nga sistemi i kompjuterizuar i përdorur për lëvizjen dhe mbikëqyrjen e mallrave që i nënshtrohen akcizës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për akcizat, pa asnjë ndryshim nga subjekti i rregulluar.

3. Subjekti i rregulluar duhet t’i sigurojë verifikuesit akses në provat e përmendura në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe në provat e gjeneruara nga sistemi i kompjuterizuar, i përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, me qëllim kontrollin e kryqëzuar të sasive të lëndëve djegëse të evidentuara nga këto prova me sasitë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum që janë raportuar nga subjekti i rregulluar në raportin vjetor të shkarkimeve.

4. Parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 8, të nenit 68, të kësaj rregulloreje, nuk zbatohen nëse janë të zbatueshme kushtet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 69, të kësaj rregulloreje, dhe verifikuesi ka vendosur të mos kryejë kontrolle mbi metodologjinë për përcaktimin e sasive të lëndës djegëse të hedhura për konsum, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

5. Parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 8, të nenit 68, kësaj rregulloreje, nuk zbatohen nëse janë të zbatueshme kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 69, të kësaj rregulloreje.

Neni 71

Fushëveprimi i akreditimit

Verifikuesi lëshon raportin e verifikimit për subjektin e rregulluar vetëm në rastet kur ky i fundit kryen një aktivitet që mbulohet nga grupi i veprimtarive nr. 1c, siç përcaktohet në shtojcën I të kësaj rregulloreje, për të cilën verifikuesit i është dhënë akreditimi përkatës në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për akreditimin dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 72

Procedurat dhe dokumentimi nga verifikuesi

1. Verifikuesi përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan një ose disa procedura për veprimtaritë e verifikimit, siç përshkruhet në kreun IV të kësaj rregulloreje, si dhe procedurat dhe proceset e kërkuara nga shtojca II e kësaj rregulloreje. Gjatë përcaktimit dhe zbatimit të

këtyre procedurave dhe proceseve, verifikuesi kryen veprimtaritë e renditura në shtojcën II të kësaj rregulloreje në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në atë shtojcë.

2. Nenet 44, pika 2, dhe 45, pika 1, të kësaj rregulloreje zbatohen për verifikimin e shkarkimeve të subjektit të rregulluar që mbulohen nga nenet 8, 9, 10 dhe shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

3. Verifikuesi u jep rregullisht informacion subjektit të rregulluar dhe palëve të tjera përkatëse, në përputhje me standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

Neni 73

Paanshmëria dhe pavarësia

1. Verifikuesi është i pavarur nga subjekti i rregulluar dhe i paanshëm në kryerjen e veprimtarive të tij të verifikimit. Për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë, verifikuesi dhe çdo pjesë e të njëjtit person juridik nuk është subjekt i rregulluar, pronar i një subjekti të rregulluar ose në pronësi të një subjekti të rregulluar, si dhe nuk ka marrëdhënie me subjektin e rregulluar që mund të ndikojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Verifikuesi është gjithashtu i pavarur nga organet që tregtojnë kuotat e shkarkimeve në sistemin e Bashkimit Evropian për tregtimin e kuotave të shkarkimit të gazeve me efekt serrë, të krijuar sipas nenit 19 të direktivës 2003/87/KE.

2. Verifikuesi organizohet në mënyrë të tillë që të ruajë objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen kriteret përkatëse për strukturën dhe organizimin e verifikuesit, të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

3. Verifikuesi nuk kryen veprimtari verifikimi për një subjekt të rregulluar që paraqet një rrezik të papranueshëm ndaj paanshmërisë së tij ose që krijon një konflikt interesi për të. Verifikuesi nuk përdor personel ose persona të kontraktuar në verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar që përfshin një konflikt real ose të mundshëm interesi. Verifikuesi siguron gjithashtu që veprimtaritë e personelit ose organizatave të mos ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e verifikimit. Për këtë qëllim, verifikuesi monitoron rreziqet ndaj paanshmërisë dhe merr masat e duhura për të adresuar këto rreziqe. Konsiderohet se ka lindur një rrezik i papranueshëm ndaj paanshmërisë ose një konflikt interesi i përmendur në fjalinë e parë të kësaj pike, në veçanti në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur një verifikues ose një pjesë e të njëjtit person juridik ofron shërbime konsulence për të zhvilluar një pjesë të procesit të monitorimit dhe raportimit që përshkruhet në planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja, duke përfshirë zhvillimin e metodologjisë së monitorimit, hartimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar dhe hartimin e planit të monitorimit;

b) Kur një verifikues ose një pjesë e të njëjtit person juridik ofron asistencë teknike për zhvillimin ose mirëmbajtjen e sistemit të zbatuar për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve.

4. Konsiderohet se ka lindur një konflikt interesi për marrëdhëniet mes verifikuesit dhe subjektit të rregulluar në veçanti në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur marrëdhënia ndërmjet verifikuesit dhe subjektit të rregulluar bazohet në faktorë të tillë si pronësia e përbashkët, qeverisja e përbashkët, menaxhimi ose personeli i përbashkët, burimet e përbashkëta, financat e përbashkëta dhe kontratat ose marketingu i përbashkët;

b) Kur subjekti i rregulluar ka marrë shërbime konsulence të llojit të përmendur në pikën 3, shkronja “a”, ose asistencë teknike të llojit të përmendur në pikën 3, shkronja “b”, të këtij neni, nga një organ konsulence, një organ i asistencës teknike ose një organizatë tjetër që ka marrëdhënie me verifikuesin dhe që kërcënon paanshmërinë e verifikuesit.

5. Për qëllimet e shkronjës “b”, të pikës 4, të këtij neni, paanshmëria e verifikuesit konsiderohet e cenuar kur marrëdhënia ndërmjet verifikuesit dhe organit të konsulencës, organit të asistencës teknike ose një organizate tjetër bazohet në faktorë të tillë si pronësia e

përbashkët, qeverisja e përbashkët, menaxhimi ose personeli i përbashkët, burimet e përbashkëta, financat e përbashkëta, kontratat ose marketingu i përbashkët, si dhe pagesa e komisionit për shitjet ose e bonuseve të tjera për referimin e klientëve të rinj.

6. Verifikuesi nuk ia delegon palëve të treta nëpërmjet nënkontraktimit lidhjen e marrëveshjes midis subjektit të rregulluar dhe verifikuesit, shqyrtimin e pavarur ose nxjerrjen e raportit të verifikimit. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, gjatë nënkontraktimit të veprimtarive të tjera të verifikimit, verifikuesi plotëson kriteret përkatëse të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje. Megjithatë, kontraktimi i individëve për kryerjen e veprimtarive të verifikimit nuk përbën nënkontraktim sipas specifikimeve të kësaj pike nëse verifikuesi, gjatë kontraktimit të këtyre personave, merr përsipër përgjegjësinë e plotë për veprimtaritë e verifikimit të kryera nga personeli i kontraktuar. Kur kontraktin individë për kryerjen e veprimtarive të verifikimit, verifikuesi u kërkon këtyre individëve të nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për të konfirmuar respektimin e procedurave të verifikuesit dhe mungesën e konflikteve të interesit në kryerjen e veprimtarive të verifikimit.

7. Verifikuesi përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan një proces për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e vazhdueshme të verifikuesit, pjesëve të të njëjtit person juridik, organizatave të tjera të përmendura në pikën 4 të këtij neni dhe të të gjithë personelit dhe personave të kontraktuar të përfshirë në verifikim. Ky proces përfshin një mekanizëm për të ruajtur paanshmërinë dhe pavarësinë e verifikuesit dhe plotëson kriteret përkatëse të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën II të kësaj rregulloreje. Kur verifikon të njëjtin subjekt të rregulluar që ka verifikuar në vitin paraardhës, verifikuesi merr parasysh rrezikun ndaj paanshmërisë dhe merr masa për të reduktuar rrezikun ndaj paanshmërisë.

8. Nëse kryeaudituesi i MRVA-së kryen për pesë vjet rresht verifikimet vjetore të shkarkimeve të një subjekti të rregulluar për aktivitetet e mbuluara nga nenet 8, 9, 10 dhe shtojca II, pjesa D, e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, atëherë kryeaudituesi i MRVA-së merr një pushim të pandërprerë prej tre vjetësh nga ofrimi i shërbimeve të verifikimit për të njëjtin subjekt të rregulluar.

KREU V AKREDITIMI

Neni 74 **Akreditimi**

1. Verifikuesi që nxjerr një raport verifikimi për një operator instalimi, një operator avioni ose një subjekt të rregulluar duhet të jetë i akredituar për fushën e veprimtarive të përmendura në shtojcën I, për të cilat verifikuesi po kryen verifikimin e raportit të operatorit të instalimit, operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar.

2. Në përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, në rastet kur operatori i avionit hedh informacionin e tij të fluturimit, të dhënat për trajektoret e fluturimit apo karakteristikat e avionit në NEATS, ose në një mjet TIK të një pale të tretë të miratuar nga Komisioni Evropian në përputhje me pikat 7 e 8, të nenit 63, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 26.6.2026; dhe kur pjesa e mbetur e raportit për efektet e aviacionit jo të lidhura me CO₂ gjenerohet automatikisht nga NEATS ose mjeti TIK i palës së tretë përkatëse, në mënyrë të pavarur nga çdo e dhënë e paraqitur nga operatori i avionit dhe pa ndryshime nga ky operator, verifikuesi që kryen verifikimin e raportit për efektet në aviacion, të palidhura me CO₂ të këtij operatori të avionëve mund të jetë i akredituar për grupin e veprimtarive nr. 2a, të përmendur në shtojcën I të kësaj rregulloreje.

3. Certifikatat e akreditimit për verifikimin e raporteve të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të avionëve, të lëshuara në kuadër të grupit të veprimtarive nr. 12 sipas fushës së akreditimit, dhe që janë të vlefshme më 31 mars 2025, konsiderohen automatikisht të lëshuara për grupin e veprimtarive nr. 12a, sipas fushës së akreditimit.

Neni 75
Objektivat e akreditimit

Gjatë procesit të akreditimit dhe monitorimit të verifikuesve të akredituar, organizmi kombëtar i akreditimit vlerëson nëse verifikuesi dhe personeli i tij që kryen veprimtaritë e verifikimit:

- a) kanë kompetencën për të kryer verifikimin e raporteve të operatorit të avionit ose operatorit të instalimit ose të subjektit të rregulluar në përputhje me këtë rregullore;
- b) kryejnë verifikimin e raporteve të operatorit të avionit ose operatorit të instalimit ose të subjektit të rregulluar në përputhje me këtë rregullore;
- c) plotësojnë kërkesat e përmendura në kreun III të kësaj rregulloreje dhe, për rastet e verifikimit të raportit të të dhënave të shkarkimeve të subjektit të rregulluar, plotësojnë kërkesat e përmendura në nenet 71 deri në 73 të kësaj rregulloreje.

Neni 76
Kërkesë për akreditim

1. Çdo person juridik i themeluar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi mund të kërkojë të akreditohet pranë organizmit kombëtar të akreditimit, sipas ligjit në fuqi për akreditimin si dhe dispozitave të këtij kreu. Kërkesa për akreditim përmban informacionin e kërkuar në përputhje me standardin e harmonizuar përkatës të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

2. Përveç informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, subjekti që aplikon për akreditim, përpara fillimit të procesit të vlerësimit nga organizmi kombëtar i akreditimit, sipas nenit 75 të kësaj rregulloreje, vë në dispozicion të organizmit kombëtar të akreditimit sa më poshtë:

- a) të gjithë informacionin e kërkuar nga organizmi kombëtar i akreditimit në kuadër të procedurave të tij të vlerësimit;
- b) procedurat dhe informacionin në lidhje me proceset e përmendura në pikën 1, të nenit 44, dhe informacionin mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë të përmendur në pikën 2, të nenit 44, të kësaj rregulloreje;
- c) kriteret e kompetencave të përmendura në nenin 39, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj rregulloreje, rezultatet e procesit të verifikimit të kompetencave të përmendur në nenin 39 të kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacionin përkatës për kompetencat e të gjithë personelit të përfshirë në veprimtaritë e verifikimit;
- ç) informacion mbi procesin për sigurimin e paanshmërisë dhe pavarësisë së vazhdueshme të përmendur në pikën 7, të nenit 46, të kësaj rregulloreje, duke përfshirë dokumentacionin e regjistruar mbi paanshmërinë dhe pavarësinë e aplikuesit për akreditim dhe të personelit të tij;
- d) informacion mbi ekspertët teknikë dhe personelin kryesor të përfshirë në verifikimin e raporteve të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, të operatorit të avionit ose të subjektit të rregulluar;
- dh) sistemin dhe procesin për sigurimin e dokumentacionit të duhur të brendshëm të verifikimit;
- e) të dhëna të tjera të rëndësishme të përmendura në pikën 1, të nenit 45, të kësaj rregulloreje.

Neni 77
Përgatitja për vlerësim

1. Gjatë përgatitjes së vlerësimit të përmendur në nenin 75 të kësaj rregulloreje, organizmi kombëtar i akreditimit merr parasysh kompleksitetin e fushës për të cilën subjekti aplikues kërkon akreditimin, si dhe kompleksitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të përmendur në pikën 2, të nenit 44, procedurat dhe informacionin në lidhje me proceset e përmendura në pikën

1, të nenit 44, të kësaj rregulloreje, dhe zonat gjeografike në të cilat subjekti aplikues po kryen ose planifikon të kryejë verifikimin.

2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj rregulloreje, organizmi kombëtar i akreditimit plotëson kërkesat minimale të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 78 **Vlerësimi**

1. Ekipi i vlerësimit i përmendur në nenin 88 të kësaj rregulloreje, për qëllime të kryerjes së vlerësimit të përmendur në nenin 75 të kësaj rregulloreje, kryen të paktën veprimtaritë e mëposhtme:

a) Shqyrtimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave përkatëse të përmendura në nenin 76 të kësaj rregulloreje;

b) Një vizitë në mjediset e subjektit aplikues për të shqyrtuar një kampion përfaqësues të dokumentacionit të brendshëm të verifikimit dhe për të vlerësuar zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe procedurat ose proceset e përmendura në nenin 44 të kësaj rregulloreje;

c) Vëzhgimin e drejtpërdrejtë të një pjese përfaqësuese të fushës së kërkuar për akreditim, si dhe të performancës dhe kompetencës së një numri përfaqësues të stafit të subjektit aplikues të përfshirë në verifikimin e raportit të të dhënave të shkarkimeve të operatorit të instalimit, operatorit të avionit ose të subjektit të rregulluar, për të siguruar që stafi po vepron në përputhje me këtë rregullore.

2. Gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive, ekipi i vlerësimit plotëson kërkesat e përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

3. Ekipi i vlerësimit i raporton subjektit aplikues gjetjet dhe mospërputhjet bazuar në kërkesat e përcaktuara në standardin e harmonizuar, të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje, si dhe i kërkon atij të japë përgjigje në lidhje me gjetjet dhe mospërputhjet e raportuara në kundërshtim me këto dispozita.

4. Subjekti aplikues merr masa korrigjuese për të trajtuar mospërputhjet e raportuara sipas pikës 3 të këtij neni dhe cilëson në përgjigjen e tij ndaj gjetjeve dhe mospërputhjeve të raportuara nga ekipi i vlerësimit se cilat masa janë marrë ose planifikohen të merren brenda një periudhe kohore të caktuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për të zgjidhur mospërputhjet e identifikuara.

5. Organizmi kombëtar i akreditimit shqyrton përgjigjet e subjektit aplikues ndaj gjetjeve dhe mospërputhjeve të paraqitura sipas pikës 4 të këtij neni. Kur organizmi kombëtar i akreditimit e konsideron përgjigjen e subjektit aplikues të pamjaftueshme ose joefektive, ai kërkon informacion ose veprim të mëtejshëm nga subjekti aplikues. Organizmi kombëtar i akreditimit mund të kërkojë gjithashtu prova të zbatimit efektiv të masave të marra ose të kryejë një vlerësim të mëpasshëm për të vlerësuar zbatimin efektiv të masave korrigjuese.

Neni 79

Vendimi mbi akreditimin dhe certifikata e akreditimit

1. Organizmi kombëtar i akreditimit merr në konsideratë dhe zbaton kërkesat e përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje gjatë përgatitjes dhe marrjes së vendimit lidhur me dhënien, zgjatjen ose rinovimin e akreditimit të një subjekti aplikues.

2. Kur organizmi kombëtar i akreditimit merr vendim të japë, të zgjerojë fushën e akreditimit ose të rinovojë akreditimin e një subjekti aplikues, ai lëshon përkatësisht një certifikatë akreditimi për këtë qëllim.

3. Certifikata e akreditimit përmban të paktën informacionin e kërkuar sipas standardit të harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje. Certifikata e akreditimit është e vlefshme për 4 (katër) vjet.

Neni 80

Mbikëqyrja

1. Organizmi kombëtar i akreditimit kryen mbikëqyrjen vjetore të çdo verifikuesi të cilit i ka lëshuar një certifikatë akreditimi. Mbikëqyrja përfshin të paktën sa më poshtë:

a) një vizitë në ambientet e verifikuesit me qëllim kryerjen e veprimtarive, të përmendura në nenin 78, pika 1, shkronja “b”, të kësaj rregulloreje;

b) vëzhgimin e performancës dhe kompetencës së një numri përfaqësues të stafit të verifikuesit në përputhje me nenin 78, pika 1, shkronja “c” të kësaj rregulloreje.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit kryen mbikëqyrjen e parë të verifikuesit në përputhje me pikën 1 të këtij neni jo më vonë se 12 muaj pas datës në të cilën verifikuesi i është lëshuar certifikata e akreditimit.

3. Organizmi kombëtar i akreditimit përgatit planin e tij për mbikëqyrjen e secilit verifikues në një mënyrë që lejon vlerësimin e kampioneve përfaqësuese të fushës së akreditimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

4. Bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes së përmendur në pikën 1 të këtij neni, organizmi kombëtar i akreditimit vendos nëse do të konfirmojë vazhdimësinë e akreditimit.

5. Kur një verifikues i akredituar në Shqipëri kryen një verifikim në një shtet tjetër, organizmi kombëtar i akreditimit shqiptar që ka akredituar verifikuesin mund t'i kërkojë organizmit kombëtar të akreditimit të shtetit tjetër ku kryhet verifikimi të kryejë aktivitete mbikëqyrëse në emër dhe nën përgjegjësinë e tij.

6. Kur një verifikues i akredituar në një shtet tjetër kryen një verifikim në Shqipëri, organizmi kombëtar i akreditimit i shtetit që ka akredituar verifikuesin mund t'i kërkojë organizmit kombëtar të akreditimit shqiptar të kryejë aktivitete mbikëqyrëse në emër dhe nën përgjegjësinë e tij dhe organizmi kombëtar i akreditimit shqiptar merr përsipër kryerjen e këtyre aktiviteteve në përputhje me legjislacionin në fuqi për akreditimin.

Neni 81

Rivlerësimi

1. Përpara përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës së akreditimit, organizmi kombëtar i akreditimit kryen një rivlerësim të verifikuesit të cilit organizmi kombëtar i akreditimit i ka lëshuar një certifikatë akreditimi për të përcaktuar nëse vlefshmëria e certifikatës së akreditimit mund të zgjatet, në rast se verifikuesi paraqet kërkesë për këtë.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit përgatit planin e tij për rivlerësimin e secilit verifikues në një mënyrë që lejon vlerësimin e kampioneve përfaqësuese të fushës së akreditimit. Gjatë planifikimit dhe kryerjes së rivlerësimit, organizmi kombëtar i akreditimit plotëson kërkesat e përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 82

Vlerësimi i jashtëzakonshëm

1. Organizmi kombëtar i akreditimit mund të kryejë një vlerësim të jashtëzakonshëm të verifikuesit në çdo kohë për të siguruar që verifikuesi plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Me qëllim që t'i mundësojë organizmit kombëtar të akreditimit të vlerësojë nevojën për një vlerësim të jashtëzakonshëm, verifikuesi informon menjëherë organizmin kombëtar të akreditimit për çdo ndryshim të rëndësishëm që lidhet me akreditimin, statusin apo funksionimin e tij. Ndryshimet e rëndësishme përfshijnë ndryshimet e përmendura në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Zgjerimi i fushës së akreditimit

Organizmi kombëtar i akreditimit, në përgjigje të kërkesës nga një verifikues për një zgjerim të fushës së veprimit të akreditimit të dhënë, kryen të gjitha veprimet e nevojshme vlerësuese, për të përcaktuar nëse verifikuesi plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 75, për zgjerimin e kërkuar të fushës së veprimit të akreditimit të tij.

Masat administrative

1. Organizmi kombëtar i akreditimit mund të pezullojë, reduktojë ose tërheqë certifikatën e akreditimit të një verifikuesi nëse verifikuesi nuk plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit pezullon, redukton ose tërheq certifikatën e akreditimit të një verifikuesi nëse verifikuesi e kërkon këtë.

3. Organizmi kombëtar i akreditimit përcakton, dokumenton, zbaton dhe ruan një procedurë për pezullimin e akreditimit, tërheqjen e akreditimit dhe reduktimin e fushës së akreditimit.

4. Organizmi kombëtar i akreditimit pezullon një akreditim ose kufizon fushën e një akreditimi në rastet e parashikuara në ligjin në fuqi për akreditimin, si dhe në një nga rastet e mëposhtme:

- a) verifikuesi ka kryer shkelje të rëndë të kërkesave të kësaj rregulloreje;
- b) verifikuesi nuk ka plotësuar kërkesat e kësaj rregulloreje në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur;
- c) verifikuesi ka shkelur terma dhe kushte të tjera specifike të përcaktuara nga organizmi kombëtar i akreditimit.

5. Organizmi kombëtar i akreditimit tërheq certifikatën e akreditimit në rastet e parashikuara në ligjin në fuqi për akreditimin, si dhe në rastet e mëposhtme:

- a) verifikuesi nuk ka trajtuar shkaqet që çuan në vendimin për pezullimin e certifikatës së akreditimit;
- b) një anëtar i nivelit të lartë drejtues të verifikuesit ose një anëtar i stafit të verifikuesit i përfshirë në veprimtaritë e verifikimit sipas kësaj rregulloreje është shpallur fajtor për mashtrim;
- c) verifikuesi ka dhënë qëllimisht informacion të rremë ose ka fshehur informacion.

6. Vendimi i organizmit kombëtar të akreditimit për të pezulluar, tërhequr ose reduktuar fushën e akreditimit në përputhje me pikat 4 dhe 5 të këtij neni, i nënshtrohet procesit të apelimit në përputhje me parashikimet e ligjit në fuqi për akreditimin.

7. Vendimi i organizmit kombëtar të akreditimit për të pezulluar, tërhequr ose reduktuar fushën e akreditimit hyn në fuqi pas marrjes së tij dhe i njoftohet menjëherë verifikuesit.

8. Organizmi kombëtar i akreditimit anulon pezullimin e certifikatës së akreditimit kur merr informacion të mjaftueshëm dhe ka besim se verifikuesi plotëson kërkesat e legjislacionit të akreditimit dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

KREU VI**KRITERET NË LIDHJE ME ORGANIZMIN KOMBËTAR TË AKREDITIMIT PËR AKREDITIMIN E VERIFIKUESVE TË MRVA-së****Organizmi kombëtar i akreditimit**

1. Kompetencat e akreditimit në përputhje me këtë rregullore kryhen nga organizmi kombëtar i akreditimit i përcaktuar si organ i vetëm kombëtar i akreditimit, në bazë të ligjit në fuqi për akreditimin.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë, vepron si autoriteti i vetëm

kombëtar i akreditimit dhe mban përgjegjësi të plotë për menaxhimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të akreditimit për qëllimet e kësaj rregulloreje në përputhje me kërkesat, e përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 86

Akreditimi ndërkufitar

1. Akreditimi ndërkufitar realizohet në Republikën e Shqipërisë në përputhje me dispozitat, e ligjit në fuqi për akreditimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Një verifikues, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të kërkojë akreditim në një organizëm kombëtar akreditimi të një shteti tjetër, vetëm në rastet e parashikuara në ligjit në fuqi për akreditimin.

Neni 87

Pavarësia dhe paanshmëria

1. Organizmi kombëtar i akreditimit organizohet në mënyrë të tillë që të garantojë pavarësinë e tij të plotë nga verifikuesit që vlerëson dhe paanshmërinë e tij në kryerjen e veprimtarive të akreditimit.

2. Për këtë qëllim, organizmi kombëtar i akreditimit nuk ofron asnjë nga veprimtaritë ose shërbimet që ofron një verifikues dhe as nuk ofron shërbime konsulence, zotëron aksione ose ka interesa financiare ose menaxheriale te një verifikues.

3. Struktura, përgjegjësitë dhe kompetencat e organizmit kombëtar të akreditimit janë qartësisht të dallueshme nga ato të AKM-së dhe ato të autoriteteve të tjera kombëtare.

4. Organizmi kombëtar i akreditimit merr të gjitha vendimet përfundimtare lidhur me akreditimin e verifikuesve. Megjithatë, organizmi kombëtar i akreditimit mund të nënkontrakttojë veprimtari të caktuara, me kusht respektimin e kërkesave të përcaktuara në standardin e harmonizuar të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 88

Ekipi i vlerësimit

1. Organizmi kombëtar i akreditimit cakton një ekip vlerësimi për çdo vlerësim të veçantë.

2. Ekipi i vlerësimi përbëhet nga një kryevlerësues dhe, sipas rastit, një numër i përshtatshëm vlerësuesish ose ekspertësh teknikë për një fushë specifike të akreditimit.

3. Ekipi i vlerësimit përfshin të paktën një person me njohuri rreth monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, ose efekteve në aviacion të palidhura me CO₂, në përputhje me vendimin nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, që lidhen me fushën e akreditimit, si dhe me kompetencat dhe njohuritë e nevojshme për të vlerësuar veprimtaritë e verifikimit brenda instalimit, operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar për fushën përkatëse të akreditimit, si dhe të paktën një person me njohuri rreth legjislacionit dhe udhëzimeve përkatëse kombëtare.

Neni 89

Kompetencat e vlerësuesve

1. Vlerësuesi ka kompetencën për të kryer veprimtaritë e kërkuara sipas kreut V të kësaj rregulloreje gjatë procesit të vlerësimit të verifikuesit. Për këtë qëllim, vlerësuesi:

a) plotëson kriteret e përcaktuara në standardin e harmonizuar sipas ligjit në fuqi për

akreditimin, të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje;

b) ka njohuri mbi parashikimet e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, si dhe njohuri mbi këtë rregullore, standardet përkatëse, legjislacionin tjetër të lidhur, si dhe udhëzimet e zbatueshme;

c) ka njohuri mbi auditimin e të dhënave dhe informacionit të përmendur në nenin 48, pika 1, shkronja “b”, të kësaj rregulloreje, të marra përmes trajnimit ose qasjes të një person që ka njohuri dhe përvojë në këto të dhëna dhe informacione.

2. Kryevlerësuesi duhet të plotësojë kriteret e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe duhet të provojë se ka kompetenca për të udhëhequr një ekip vlerësimi dhe për të qenë përgjegjës për kryerjen e një vlerësimi në përputhje me këtë rregullore.

3. Shqyrtuesit e brendshëm dhe personat që marrin vendime për dhënien, zgjerimin e fushës së akreditimit ose rinovimin e akreditimit, krahas kompetencës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të kenë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të vlerësuar akreditimin.

Neni 90

Ekspertët teknikë

1. Organizmi kombëtar i akreditimit mund të përfshijë në ekipin e vlerësimit ekspertë teknikë për të ofruar njohuri dhe ekspertizë të detajuar për një çështje specifike, që është e nevojshme për të mbështetur kryevlerësuesin ose vlerësuesin në kryerjen e veprimtarive të vlerësimit.

2. Një ekspert teknik duhet të ketë kompetencën e nevojshme për të mbështetur kryevlerësuesin dhe vlerësuesin në mënyrë efektive për çështjen për të cilën nevojiten njohuritë dhe ekspertiza e tij. Gjithashtu, eksperti teknik plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka njohuri mbi parashikimet e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregulloreve, ‘Për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar’ dhe ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga operatori i instalimit, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂’”, si dhe njohuri mbi këtë rregullore, standardet përkatëse, legjislacionin tjetër të lidhur, si dhe udhëzimet e zbatueshme;

b) ka njohuri të mjaftueshme mbi veprimtaritë e verifikimit.

3. Një ekspert teknik kryen detyra të përcaktuara nën drejtimin dhe përgjegjësinë e plotë të kryevlerësuesit të ekipit të vlerësimit përkatës.

Neni 91

Procedurat

Organizmi kombëtar i akreditimit vepron në përputhje me ligjin në fuqi për akreditimin, dhe me kërkesat e përcaktuara dhe standardet përkatëse, të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 92

Ankesat

Kur organizmi kombëtar i akreditimit merr një ankesë në lidhje me verifikuesin nga AKM-ja, operatori i instalimit, operatori i avionit, subjekti i rregulluar ose palët e tjera të interesuara, organizmi kombëtar i akreditimit, brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se tre muaj nga data e marrjes së saj:

- a) vendos për vlefshmërinë e ankesës;
- b) siguron që verifikuesit në fjalë t'i jepet mundësia për të paraqitur pretendimet e tij;
- c) merr masat e duhura për të trajtuar ankesën;
- ç) regjistron ankesën dhe masat e marra; dhe
- dh) i kthen përgjigje ankuesit.

Neni 93

Të dhënat dhe dokumentacioni

1. Organizmi kombëtar i akreditimit mban të dhëna për çdo person të përfshirë në procesin e akreditimit. Këto të dhëna përfshijnë të dhëna në lidhje me kualifikimet përkatëse, trajnimin, përvojën, paanshmërinë dhe kompetencën e nevojshme për të demonstruar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit mban të dhënat e verifikuesit në përputhje me standardin e harmonizuar sipas ligjit në fuqi për akreditimin, të përmendur në shtojcën III të kësaj rregulloreje.

Neni 94

Akresi në informacion dhe konfidencialiteti

1. Organizmi kombëtar i akreditimit vë në dispozicion të publikut dhe përditëson rregullisht informacionin rreth organizmit kombëtar të akreditimit dhe veprimtarive të akreditimit të kryera prej tij.

2. Në përputhje me ligjin në fuqi për akreditimin, organizmi kombëtar i akreditimit merr masat e duhura për të ruajtur, sipas rastit, konfidencialitetin e informacionit të marrë.

Neni 95

Vlerësimi i ndërsjellë

1. Organizmi kombëtar i akreditimit i nënshtrohet rregullisht vlerësimit të ndërsjellë. Vlerësimi i ndërsjellë organizohet sipas ligjit në fuqi për akreditimin.

2. Gjatë procesit të vlerësimit të ndërsjellë zbatohen kriteret e përshtatshme të vlerësimit dhe një proces efektiv dhe i pavarur i vlerësimit të ndërsjellë, në mënyrë që të vlerësohet nëse:

a) organizmi kombëtar i akreditimit që i nënshtrohet vlerësimit të ndërsjellë ka kryer veprimtaritë e akreditimit në përputhje me kreun V të kësaj rregulloreje;

b) organizmi kombëtar i akreditimit që i nënshtrohet vlerësimit të ndërsjellë ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në këtë kre.

3. Organizmi kombëtar i akreditimit publikon rezultatin e vlerësimit të ndërsjellë dhe ia raporton atë autoriteteve kombëtare përgjegjëse për organizmin kombëtar të akreditimit dhe AKM-së.

4. Pa cenuar parashikimet e pikës 1 të këtij neni, kur organizmi kombëtar i akreditimit i është nënshtruar me sukses vlerësimit të ndërsjellë për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë rregullore, përpara hyrjes në fuqi të saj, organizmi kombëtar i akreditimit përjashtohet nga nënshtrimi i një vlerësimi të ndërsjellë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, nëse mund të provojë përputhshmërinë me këtë rregullore.

Neni 96

Masat korrigjuese

1. Ministria përgjegjëse për akreditimin monitoron organizmin kombëtar të akreditimit në intervale të rregullta për t'u siguruar që përmbush kërkesat e kësaj rregulloreje në mënyrë të

vazhdueshme, duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit të ndërsjellë, të kryer në përputhje me nenin 95 të kësaj rregulloreje.

2. Kur organizmi kombëtar i akreditimit nuk përmbush kërkesat ose detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore, ministria përgjegjëse për akreditimin merr masat e duhura korrigjuese ose garanton që janë marrë masat korrigjuese.

Neni 97

Njohja e ndërsjellë e verifikuesve

1. Në përputhje me parashikimet e ligjit në fuqi për akreditimin, organizmi kombëtar i akreditimit njeh barasvlerën e shërbimeve të kryera nga organizmat kombëtarë të akreditimi të shteteve të tjera që i janë nënshtruar me sukses një vlerësimi të ndërsjellë.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit pranon certifikatat e akreditimit të verifikuesve të akredituar nga këta organizma kombëtarë akreditimi dhe respektojnë të drejtën e verifikuesve për të kryer verifikime për fushën e tyre të akreditimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 98

Monitorimi i shërbimeve të ofruara

1. Kur organizmi kombëtar i akreditimit ka konstatuar se verifikuesi i akredituar nga një organizëm kombëtar akreditimi i një shteti tjetër, që ka kaluar me sukses vlerësimin e ndërsjellë sipas nenit 95 të kësaj rregulloreje, nuk po respekton këtë rregullore, njofton organizmin kombëtar të akreditimit të shtetit që ka akredituar verifikuesin.

2. Në rastin kur organizmi kombëtar i akreditimit merr njoftim se verifikuesi i akredituar prej tij nuk po respekton këtë rregullore, nga një organizëm kombëtar akreditimi i një shteti tjetër, që ka kaluar me sukses vlerësimin e ndërsjellë sipas nenit 95 të kësaj rregulloreje, e konsideron komunikimin e këtij informacioni si ankesë sipas kuptimit të nenit 92 të kësaj rregulloreje dhe merr masat e duhura dhe i përgjigjet autoritetit kompetent për MRVA-në ose organizmit kombëtar të akreditimit të shtetit tjetër, në përputhje me nenin 103, pika 3, të kësaj rregulloreje.

Neni 99

Shkëmbimi elektronik i të dhënave dhe përdorimi i sistemeve të automatizuara

1. Verifikuesit, për raportin e verifikimit, përdorin modele elektronike ose formate të standardizuara, në përputhje me parashikimet e nenit 81, pika 1 dhe 2 ose nenit 131 të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, të Këshillit të Ministrave.

2. Modelet elektronike ose formatet e standardizuara mund të vihen në dispozicion për lloje të tjera komunikimi midis operatorit të instalimit, operatorit të avionit, subjektit të rregulluar, verifikuesit, AKM-së dhe organizmit kombëtar të akreditimit në përputhje me nenin 81, pika 3 ose nenin 131, të vendimit nr. 486, datë 26.6.2026, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO₂”, të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 100
Shkëmbimi i informacionit

1. Organizmi kombëtar i akreditimit siguron shkëmbimin efektiv të informacionit të nevojshëm dhe bashkëpunimin efektiv midis tij dhe AKM-së.

2. Organizmi kombëtar i akreditimit siguron shkëmbimin efektiv të informacionit të nevojshëm dhe bashkëpunimin efektiv midis tij dhe ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Neni 101
Programi i punës së akreditimit dhe raporti i menaxhimit

1. Brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, organizmi kombëtar i akreditimit vë në dispozicion të AKM-së një program pune akreditimi që përmban listën e verifikuesve të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit dhe që e kanë njoftuar atë sipas nenit 107 të kësaj rregulloreje që synojnë të kryejnë verifikime në territorin e Republikës së Shqipërisë. Organizmi kombëtar i akreditimit e vendos këtë listë edhe në dispozicion të autoriteteve kompetente për MRVA-në të shteteve të tjera ku verifikuesi do të kryejë veprimtari verifikimi që i ka njoftuar sipas nenit 107 të kësaj rregulloreje. Programi i punës së akreditimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm në lidhje me secilin verifikues:

a) kohën dhe vendin e parashikuar të verifikimit, duke përfshirë nëse do të kryhet një vizitë virtuale ose fizike në terren;

b) informacion mbi veprimtaritë që organizmi kombëtar i akreditimit ka planifikuar për këtë verifikues, në veçanti veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe rivlerësimit;

c) datat e parashikuara të auditimeve me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë në terren që do të kryhen nga organizmi kombëtar i akreditimit për të vlerësuar verifikuesin, duke përfshirë adresën dhe detajet e kontaktit të operatorëve të instalimit ose operatorëve të avionit që do të vizitohen gjatë auditimit;

ç) informacion nëse organizmi kombëtar i akreditimit i ka kërkuar organizmit kombëtar të akreditimit të një shteti tjetër në të cilin verifikuesi po kryen verifikimin që të kryejë aktivitete mbikëqyrëse.

2. Kur ndodhin ndryshime në informacionin e përmendur në pikën 1 më sipër, organizmi kombëtar i akreditimit i paraqet AKM-së një program pune të përditësuar brenda datës 31 janar të çdo viti.

3. Pas paraqitjes së programit të punës së akreditimit në përputhje me pikën 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, AKM-ja pajis organizmin kombëtar të akreditimit me të gjithë informacionin e vlefshëm, duke përfshirë legjislacionin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse.

4. Brenda datës 1 qershor të çdo viti, organizmi kombëtar i akreditimit i vë në dispozicion AKM-së një raport menaxhimi. Raporti i menaxhimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm në lidhje me çdo verifikues që është akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit:

a) detajet e akreditimit të verifikuesve që janë akredituar rishtazi nga organizmi kombëtar i akreditimit, duke përfshirë fushën e akreditimit të këtyre verifikuesve;

b) çdo ndryshim të fushës së akreditimit të këtyre verifikuesve;

c) përmbledhjen e rezultateve të veprimtarive të mbikëqyrjes dhe rivlerësimit të kryera nga organizmi kombëtar i akreditimit;

ç) përmbledhjen e rezultateve të vlerësimeve të jashtëzakonshme që janë kryer, duke përfshirë arsyet për nisjen e vlerësimeve të jashtëzakonshme;

d) ankesat e paraqitura kundër verifikuesit që nga raporti i fundit i menaxhimit dhe masat e marra nga organizmi kombëtar i akreditimit;

dh) detajet e masave të marra nga organizmi kombëtar i akreditimit në përgjigje të informacionit të ndarë nga AKM, përveç rasteve kur organizmi kombëtar i akreditimit e ka konsideruar informacionin si ankesë sipas kuptimit të nenit 92 të kësaj rregulloreje.

Neni 102

Shkëmbimi i informacionit për masat administrative

1. Nëse organizmi kombëtar i akreditimit ka vendosur marrjen e masave administrative ndaj verifikuesit sipas nenit 84 të kësaj rregulloreje ose kur është anuluar pezullimi i akreditimit ose kur një vendim i marrë në kuadër të procedurës së ankimit ka anuluar vendimin e organizmit kombëtar të akreditimit për vendosjen e masave administrative të përmendura në nenin 84 të kësaj rregulloreje, organizmi kombëtar i akreditimit informon palët e mëposhtme:

- a) autoritetin kompetent për procedurat MRVA të shtetit ku është akredituar verifikuesi;
- b) autoritetin kompetent për procedurat MRVA dhe organizmin kombëtar të akreditimit të çdo shteti ku verifikuesi po kryen verifikimet.

Neni 103

Shkëmbimi i informacionit nga autoritetet kompetente të MRVA-së

1. AKM-ja i komunikon çdo vit organizmit kombëtar të akreditimit ose organizmit kombëtar të akreditimit të shtetit që ka akredituar verifikuesin të paktën sa më poshtë:

a) Rezultatet përkatëse nga kontrolli i raportit të operatorit të instalimit ose operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar dhe të raporteve përkatëse të verifikimit, në veçanti çdo rast të mospërputhjeve të identifikuar të veprimtarisë së verifikuesit me parashikimet e kësaj rregulloreje;

b) Rezultatet nga inspektimi i operatorit të instalimit, ose operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar kur këto rezultate janë të rëndësishme për organizmin kombëtar të akreditimit në lidhje me akreditimin dhe mbikëqyrjen e verifikuesit ose kur këto rezultate përfshijnë ndonjë mospërputhshmëri të identifikuar të veprimtarive të verifikuesit me këtë rregullore;

c) Rezultatet nga vlerësimi i dokumentacionit të brendshëm të verifikimit të verifikuesit, kur AKM ka vlerësuar dokumentacionin e brendshëm të verifikimit në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 4, të kësaj rregulloreje;

ç) Ankesat e marra nga AKM-ja në lidhje me verifikuesin.

2. Kur organizmi kombëtar i akreditimit merr informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni nga autoriteti kompetent për MRVA-në të një shteti tjetër ku një verifikues i akredituar në Shqipëri po kryen veprimtaritë e akreditimit, dhe ky informacion përmban prova se autoriteti kompetent për MRVA-në i shtetit tjetër ka identifikuar mospërputhshmëri të verifikuesit me këtë rregullore, organizmi kombëtar i akreditimit e konsideron komunikimin e këtij informacioni si ankesë të autoritetit kompetent për MRVA-në të shtetit tjetër në lidhje me verifikuesin, sipas kuptimit të nenit 92 të kësaj rregulloreje.

3. Në rastin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, organizmi kombëtar i akreditimit merr masat e duhura për të trajtuar këtë informacion dhe për t'iu përgjigjur autoritetit kompetent për MRVA-në të shtetit tjetër brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se tre muaj nga data e marrjes së tij. Në përgjigjen e tij, organizmi kombëtar i akreditimit informon autoritetin kompetent për MRVA-në të shtetit tjetër për masat e marra dhe sipas rastit, masat administrative të vendosura ndaj verifikuesit.

Neni 104

Shkëmbimi i informacionit për mbikëqyrjen

1. Kur organizmit kombëtar të akreditimit i është kërkuar, sipas nenit 80, pika 6, të kësaj rregulloreje, të kryejë aktivitete mbikëqyrëse të një verifikuesi të akredituar në një shtet tjetër, që po ushtron aktivitete verifikimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, organizmi kombëtar i akreditimit i raporton gjetjet e tij organizmit kombëtar të akreditimit që ka akredituar verifikuesin, përveç rasteve kur të dy organizmat kombëtarë të akreditimit bien dakord ndryshe.

2. Kur organizmi kombëtar i akreditimit i ka kërkuar organizmit kombëtar të akreditimit të një shtetit tjetër, të kryejë në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, aktivitete mbikëqyrëse të

verifikuesit të akredituar në Shqipëri që po kryen verifikime në atë shtet, sipas nenit 80, pika 5, të kësaj rregulloreje, organizmi kombëtar i akreditimit merr parasysh gjetjet e dërguara nga organizmi kombëtar i akreditimit të shtetit tjetër, gjatë procedurës së vlerësimit nëse verifikuesi i plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Kur gjetjet e përmendura në pikën 2, të këtij neni përmbajnë prova se verifikuesi i akredituar në Shqipëri nuk po respekton këtë rregullore, organizmi kombëtar i akreditimit merr masat e duhura në përputhje me këtë rregullore dhe informon organizmin kombëtar të akreditimit që ka kryer aktivitetet mbikëqyrëse mbi:

- a) masat e marra nga organizmi kombëtar i akreditimit;
- b) sipas rastit, mënyrën se si verifikuesi i ka dhënë zgjidhje problematikat e identifikuara në gjetjet e sipërpërmendura;
- c) sipas rastit, masat administrative që janë vendosur ndaj verifikuesit.

Neni 105

Marrja e informacionit nga organizmi kombëtar i akreditimit të një shteti tjetër

Kur një verifikues i themeluar në Shqipëri ka marrë akreditimin nga një organizëm kombëtar akreditimi i një shteti tjetër, AKM-ja merr nga organizmi kombëtar i akreditimit të shtetit tjetër programin e punës së akreditimit dhe raportin e menaxhimit të përmendur në nenin 101, të kësaj rregulloreje, si dhe informacioni i përmendur në nenin 102 të kësaj rregulloreje, dhe i ruan këto dokumente.

Neni 106

Bazat e të dhënave të verifikuesve të akredituar

1. Organizmi kombëtar i akreditimit krijon dhe menaxhon në format elektronik të dhënat e verifikuesve të akredituar dhe u lejon aksesin për këto të dhëna autoriteteve kombëtare, verifikuesve, operatorëve të instalimit, operatorëve të avionit, subjekteve të rregulluara dhe AKM-së.

2. Baza e të dhënave e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e secilit verifikues të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit;
- b) shtetet në të cilat verifikuesi po kryen verifikimin;
- c) fushën e akreditimit të secilit verifikues;
- ç) datën në të cilën është dhënë akreditimi dhe datën e mbarimit të akreditimit;
- d) informacion mbi masat administrative që kanë vendosur ndaj verifikuesit.

3. Informacioni i pikës 2 duhet të jetë publik.

Neni 107

Njoftimi nga verifikuesit

1. Me qëllim që t'i mundësojë organizmit kombëtar të akreditimit të hartojë programin e punës së akreditimit dhe raportin e menaxhimit të përmendur në nenin 101 të kësaj rregulloreje, verifikuesi, brenda datës 15 nëntor të çdo viti, i dërgon informacionin e mëposhtëm organizmit kombëtar të akreditimit që ka akredituar verifikuesin:

- a) kohën dhe vendin e planifikuar të verifikimeve që janë planifikuar të kryhen nga verifikuesi, duke përfshirë nëse do të kryhet një vizitë virtuale ose fizike në terren;
- b) adresën dhe të dhënat e kontaktit të operatorëve të instalimit ose operatorëve të avionëve, për të cilët do të verifikohen raportet e të dhënave të shkarkimeve ose, raportet për efektet në aviacion të palidhura me CO₂;
- c) adresën dhe të dhënat e kontaktit të subjekteve të rregulluara për të cilat do të verifikohen raportet e të dhënave të shkarkimeve
- ç) emrat e anëtarëve të ekipit të verifikimit dhe fushën e akreditimit që mbulon veprimtarinë e operatorit të instalimit, ose operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar që

do të verifikohet.

2. Kur ndodhin ndryshime në informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, verifikuesi njofton organizmin kombëtar të akreditimit për këto ndryshime brenda një afati kohor të rënë dakord me organizmin kombëtar të akreditimit.

SHTOJCA I FUSHA E AKREDITIMIT PËR VERIFIKUESIT

Fusha e akreditimit të verifikuesve përcaktohet në certifikatën e akreditimit duke përdorur grupet e mëposhtme të veprimtarive në përputhje me shtojcën II të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.

Grup - veprimtarinë nr.	Fushat e akreditimit
1a	Djegia e lëndëve djegëse në instalime, kur përdoren vetëm lëndë djegëse standarde tregtare, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 26.6.2026, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e posaçme të autorizimit për shkarkimet e gazeve me efekt serrë nga instalimet dhe subjektet e rregulluara dhe të rregullores ‘Për kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga instalimet, nga operatori i avionit dhe nga subjekti i rregulluar dhe të efekteve në aviacion të palidhura me shkarkimin e CO ₂ ”, ose kur përdoret gaz natyror në instalimet e kategorisë A ose B.
1b	Djegia e lëndëve djegëse në instalime, pa kufizime
1c	Verifikimi i shkarkimeve të mbuluara nga neni 8, 9, 10 dhe shtojca II, pjesa D e ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.
2	Rafinimi i naftës
3	- Prodhimi i koksit - Pjekja ose aglomerimi i xeherorëve metalikë (përfshirë xeherorët sulfidë), duke përfshirë peletizimin e tyre - Prodhimi i hekurit ose çelikut (shkrirje primare ose sekondare) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme
4	- Prodhimi ose përpunimi i metaleve ferroke (duke përfshirë i aliazheve metalike) - Prodhimi i aluminit sekondar - Prodhimi ose përpunimi i metaleve joferroke, duke përfshirë prodhimin e aliazheve
5	Prodhimi i aluminit primar ose i oksidit të aluminit (shkarkimet e CO ₂ dhe PFC)
6	- Prodhimi i klinkerit të çimentos - Prodhimi i gëlqeres, ose kalcinimi i dolomitit ose magnezit - Prodhimi i qelqit, duke përfshirë i fibrave të qelqit - Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes - Prodhimi i materialeve izoluese me bazë leshi mineral - Tharja ose kalcinimi i gipsit apo prodhimi i fletëve/pllakave/panelevë prej gipsi dhe materialeve të tjera prej gipsi
7	- Prodhimi i pulpës nga trungjet e drurit ose materiale të tjera fibroze - Prodhimi i letrës ose kartonit
8	- Prodhimi i katranit - Prodhimi i amoniakut - Prodhimi i kimikateve organike në sasi të mëdha përmes krekingut, reformimit, oksidimit të pjesshëm ose të plotë, apo përmes proceseve të ngjashme - Prodhimi i hidrogjenit (H ₂) dhe gazit të sintezës - Prodhimi i hirit të sodës (Na ₂ CO ₃) dhe bikarbonatit të sodës (NaHCO ₃)
9	- Prodhimi i acidit nitrik (shkarkimet e CO ₂ dhe N ₂ O) - Prodhimi i acidit adipik (shkarkimet e CO ₂ dhe N ₂ O) - Prodhimi i glioksal dhe acidit glioksilik (shkarkimet e CO ₂ dhe N ₂ O)
10	- Kapja e gazeve me efekt serrë nga instalimet e mbuluara nga ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, për qëllime të transportit dhe depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi; - Transporti i gazeve me efekt serrë për qëllime të depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të shkarkimeve që mbulohen nga një tjetër veprimtari e listuar në shtojcën II, pjesët A, B ose C të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar.
11	Depozitimi gjeologjik i gazeve me efekt serrë në një vend depozitimi të lejuar sipas legjislacionit në fuqi.
12a	Veprimtaritë e aviacionit (të dhënat e shkarkimeve)
12b	Veprimtaritë e aviacionit (efektet në aviacion të palidhura me CO ₂)
x	

SHTOJCA II KRITERET PËR VERIFIKUESIT

Për sa u përket kriterëve për verifikuesit, zbatohet standardi i harmonizuar sipas ligjit në fuqi për akreditimin, në lidhje me kërkesat për organet e vlerësimit të konformitetit që kryejnë validimin dhe verifikimin e gazeve me efekt serrë për përdorim në akreditim ose në forma të tjera të njohjes. Gjithashtu zbatohen procedurat, proceset dhe masat e mëposhtme të përmendura në nenin 44, pika 1, të kësaj rregulloreje:

- a) një proces dhe politikat për komunikimin mes operatorit të instalimit, ose operatorit të avionit, ose subjektit të rregulluar dhe palëve të tjera përkatëse;
- b) masa të përshtatshme për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë;
- c) një proces për trajtimin e apeliave;
- ç) një proces për trajtimin e ankesave (duke përfshirë afatet kohore indikative);
- d) një proces për nxjerrjen e raportit të rishikuar të verifikimit, kur pasi verifikuesi i ka paraqitur raportin e verifikimit operatorit të instalimit, operatorit të avionit ose subjektit të rregulluar, është identifikuar një gabim në raportin e verifikimit, në raportin e operatorit të instalimit, ose të operatorit të avionit, ose në raportin e subjektit të rregulluar, me qëllim për t'ia paraqitur më pas AKM-së raportin e verifikimit të rishikuar;
- dh) një procedurë ose proces për delegimin e veprimtarive të verifikimit tek organizata të tjera;
- e) një procedurë ose proces për të siguruar që verifikuesi të marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për veprimtaritë e verifikimit të kryera nga individët e kontraktuar;
- ë) procese që sigurojnë funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit të përmendur në nenin 44, pika 2, të kësaj rregulloreje, duke përfshirë:
 - i. procese për rishikimin e sistemit të menaxhimit të paktën një herë në vit, duke mos tejkaluar 15 muaj ndërmjet rishikimeve të menaxhimit;
 - ii. procese për kryerjen e auditimeve të brendshme të paktën një herë në vit, duke mos tejkaluar periudhën maksimale prej 15 muajsh ndërmjet auditimeve të brendshme;
 - iii. procese për identifikimin dhe menaxhimin e mospërputhjeve në veprimtaritë e verifikuesit dhe marrjen e masave korrigjuese për trajtimin e këtyre mospërputhjeve;
 - iv. procese për identifikimin e rreziqeve dhe mundësive në veprimtaritë e verifikuesit dhe marrjen e masave parandaluese për zbutjen e këtyre rreziqeve;
 - v. procese për kontrollin e informacionit të dokumentuar.

SHTOJCA III

KRITERET MINIMALE TË PROCESIT TË AKREDITIMIT DHE KRITERET PËR ORGANIZMAT E AKREDITIMIT

Për sa u përket kërkesave minimale për akreditim dhe kërkesave për organizmat e akreditimit, zbatohet standardi i harmonizuar sipas ligjit në fuqi për akreditimin, në lidhje me kërkesat e përgjithshme për organizmat e akreditimit që akreditojnë organet për vlerësimin e konformitetit.